

**KOMISIONI EVROPIAN**

Bruksel, më 16.10.2013  
SWD (2013) 414

**DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT**

**PROGRES RAPORTI 2013 PËR SHQIPËRINË**

*që shoqëron*

**KOMUNIKATËN E KOMISIONIT PËR PARLAMENTIN EUROPIAN  
DHE KËSHILLIN**

**Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për periudhën 2013-2014**

{COM(2013) 700}

## PASQYRA E LËNDËS

1.	HYRJE .....	4
1.1.	Parathënie .....	4
1.2.	Konteksti.....	4
1.3.	Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë.....	5
2.	KRITERI POLITIK.....	6
2.1.	Demokracia dhe shteti i së drejtës.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	12
2.3	Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare .....	14
3.	KRITERI EKONOMIK.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.1.	Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.2.	Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së...	15
4.	<i>AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT</i> .....	22
4.1.	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave .....	23
4.2.	Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve .....	24
4.3.	Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime .....	24
4.4.	Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit .....	25
4.5.	Kapitulli 5: Prokurimi publik .....	26
4.6.	Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare.....	27
4.7.	Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale .....	28
4.8.	Kapitulli 8: Politika e konkurrencës.....	28
4.9.	Kapitulli 9: Shërbimet financiare.....	30
4.10.	Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media .....	31
4.11.	Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural .....	32
4.12.	Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare .....	34

4.13.	Kapitulli 13: Peshkimi.....	35
4.14.	Kapitulli 14: Politikat e transportit.....	36
4.15.	Kapitulli 15: Energjia.....	37
4.16.	Kapitulli 16: Tatimet.....	39
4.17.	Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare.....	40
4.18.	Kapitulli 18: Statistikat.....	41
4.19.	Kapitulli 19: Politika sociale dhe Punësimi .....	41
4.20.	Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale.....	44
4.21.	Kapitulli 21: Rrjetet transeuropiane .....	44
4.22.	Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore.....	45
4.23.	Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore .....	46
4.24.	Kapitulli 24. Drejtësia, liria dhe siguria.....	57
4.25.	Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi .....	61
4.26.	Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura .....	61
4.27.	Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike .....	62
4.28.	Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit.....	64
4.29.	Kapitulli 29: Bashkimi doganor.....	66
4.30.	Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë .....	67
4.31.	Kapitulli 31: Politka e jashtme, sigurisë dhe e mbrojtjes.....	67
4.32.	Kapitulli 32: Kontrolli financiar.....	68
4.33.	Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore .....	69

## 1. HYRJE

### 1.1. Parathënie

Komisioni i raporton rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor drejt integritit evropian, duke vlerësuar përpjekjet e tyre për të përmbushur kriteret e Kopenhagenit dhe kushtëzimet e Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit.

Ky raport, për progresin e bërë nga Shqipëria në përgatitjet për anëtarësim në BE:

- përshkruan shkurt marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kriterit politik për anëtarësim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kriterit ekonomik për anëtarësim;
- shqyrton zhvillimet për sa i përket aftësisë së Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, domethënë *acquis* e shprehur në traktate, legjislacionin dytësor dhe politikat e Bashkimit Evropian.

Ky raport mbulon periudhën nga tetori i 2012-ës deri në shtator të 2013-ës. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merren parasysh. Kjo përjasje garanton trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, të Shteteve Anëtare të BE-së, raportet<sup>1</sup> e Parlamentit Evropian dhe informacionet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare e joqeveritare.

Bazuar në analizën teknike që përmban ky raport, Komisioni ka përpiluar përfundime të detajuara për Shqipërinë në komunikatën e zgjerimit<sup>2</sup>.

### 1.2. Konteksti

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009. Më 28 prill 2009, Shqipëria dorëzoi aplikimin për anëtarësim në BE. Me kërkesë të Këshillit, Komisioni dorëzoi Opinionin për aplikimin e Shqipërisë në nëntor të vitit 2010. Në dhjetor 2010, Këshilli vuri në dukje se hapja e negociatave për anëtarësim do të konsiderohet pasi Komisioni të ketë vlerësuar se vendi ka arritur shkallën e nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe, në veçanti, ka plotësuar prioritetet kyçe të përcaktuara në Opinionin e Komisionit.

Në funksion të progresit të bërë nga Shqipëria, Komisioni rekomandoi në tetor të vitit 2012 që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit me kusht që të plotësojë masat kyçe në fushat e drejtësisë dhe reformën e administratës publike, si edhe rishikimin e rregullores së procedurës së parlamentit. Në

---

<sup>1</sup> Deri më 17 shtator 2013, raportuesi për Shqipërinë ishte Z. Nikolaos Chountis. Raportuesi i tanishëm është Z. Nikola Vuljanic.

<sup>2</sup> Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për periudhën 2013-2014. (COM (2013) 700).

dhjetor të vitit 2012 me synimin për të vendosur nëse do t'i japë statusin e kandidatit, Këshilli ftoi Komisionin të raportojë në Këshill sa më shpejt përparimin e nevojshëm të arritur, duke marrë gjithashtu parasysh veprimet e mëtejshme të ndërmarra nga Shqipëria për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, përfshi hetimet proaktive dhe ndjekjet penale të rasteve të tilla. Lidhur me hapjen e negociatave, Këshilli theksoi se do të jetë i nevojshëm zbatimi i qëndrueshëm i reformave dhe përmbushja e të gjitha prioriteteve kyçe.

### **1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë**

Shqipëria merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asocimit**.

Në përgjithësi, Shqipëria i ka zbatuar mirë detyrimet e saj në kuadrin e **Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA)**. Është rënë dakord ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë për një Protokoll të MSA-së për të marrë parasysh pranimin e Kroacisë në BE. Protokollin është aktualisht nën ratifikim dhe janë marrë masat për zbatimin e tij të përkohshëm derisa procesi i ratifikimit të përfundojë në të dyja anët.

Shqipëria ka marrë pjesë në dialogun periodik politik dhe ekonomik me BE-në përmes strukturave të MSA-së. Mbledhjet e Komitetit dhe Këshillit të Stabilizim-Asocimit janë mbajtur përkatësisht në mars dhe maj të vitit 2013. Janë zhvilluar takimet e gjashtë nënkomiteteve dhe një takim i grupit të posaçëm për reformën e administratës publike. Shqipëria merr pjesë në dialogun ekonomik shumëpalësh me Komisionin dhe shtetet anëtare të BE-së për të përgatitur vendin për të marrë pjesë në mbikëqyrjen shumëpalëshe dhe koordinimin e politikave ekonomike në kuadër të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar të BE-së.

**Liberalizimi i vizave** për qytetarët e Shqipërisë që udhëtojnë në zonën Shengen ka qenë në fuqi që nga dhjetori 2010. Në kuadrin e krijimit të mekanizmit të monitorimit pas liberalizimit të vizave, Komisioni rregullisht vlerëson progresin e bërë nga vendi në zbatimin e reformave të ndërmarra sipas udhërrëfyesit të vizave. Këtu përfshihet edhe një mekanizëm alarmi i koordinuar nga Frontex për të parandaluar abuzimet. Në këtë kuadër, Komisioni Evropian ka dorëzuar rregullisht raportet e tij të monitorimit tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian. Raporti i ardhshëm do të paraqitet nga fundi i vitit 2013. **Marrëveshja e Ripranimit** midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë ka qenë në fuqi që nga viti 2005.

**Asistenca financiare** e para-anëtarësimit i jepet Shqipërisë përmes Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA). Shqipëria ka përfituar nga Komponenti IPA I - Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional dhe nga Komponenti IPA II – Bashkëpunimi ndërkufitar. Për periudhën 2007-2013, BE-ja i ka akorduar Shqipërisë përafërsisht 594 milion euro. Buxheti vjetor i Programit Kombëtar në kuadrin e Komponentit IPA I përfshin 81 milion euro për 2012 dhe 82 milion euro për 2013. Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) për periudhën 2011-2013 parashikon një përfaqje sektoriale me fokus te drejtësia dhe çështjet e brendshme, reforma e administratës publike, transporti, mjedisi dhe ndryshimet klimatike, zhvillimi social, bujqësia dhe zhvillimi rural. Asistenca IPA në kuadrin e këtij komponenti zbatohet nën mbikëqyrjen e Delegacionit të BE-së në Tiranë.

Në kuadrin e Komponentit IPA II - Bashkëpunimi Ndërkufitar, Shqipëria merr pjesë në menaxhimin dhe zbatimin e tre programeve në hapësirën e Ballkanit Perëndimor (me Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën<sup>3</sup>); në një program dypalësh bashkëpunimi ndërkufitar me një shtet anëtar të BE-së (Greqinë); në tre programe shumëpalëshe (përfshi Shtetet Anëtare të BE-së), d.m.th. në programet transkombëtare evropiane të “Evropës Juglindore” dhe “Mesdheut”, si edhe në programin rajonal IPA Adriatik.

Për periudhën 2014-2020, Qeveria e Shqipërisë dhe Komisioni janë duke diskutuar nevojat dhe kapacitetet për ndihmë në të ardhmen, në kuadër të Instrumentit e ri të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IAP II).

Shqipëria merr pjesë në programet e BE-së në vijim: “Programi i Shtatë Kuadër (FP7) për Kërkimin Shkencor”, “Programi për Sipërmarrjen dhe Novacionin” (EIP) i “Programit Kuadër për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin”, “Evropa në Veprim”, “Evropa për Qytetarët”, “Kultura” dhe “Dogana 2013”.

## **2. KRITERI POLITIK**

Kjo pjesë shqyrton përparimin që ka bërë Shqipëria në përmbushjen e kriterit politik të Kopenhagenit që kërkon stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu kjo pjesë monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet e zgjerimit dhe shtetet anëtare dhe përputhshmërinë me detyrimet ndërkombëtare.

### **2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës**

Me gjithë klimën e tendosur dhe shpesh të polarizuar politike në vigjilje të zgjedhjeve të përgjithshme në gjysmën e parë të 2013-ës, Shqipëria eci me përpjekjet e saj në reforma në të gjitha fushat e prioriteteve kyçe. Organizimi i zgjedhjeve të qershorit 2013, të cilat rezultuan në fitore të qartë të opozitës së koalicionit Aleanca për Shqipërinë Evropiane të drejtuar nga Partia Socialiste, u vlerësua pozitivisht nga misioni i vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve. Kryeministri në detyrë, në atë periudhë, e pranoi humbjen menjëherë duke hapur rrugën për një ndryshim të qetë të qeverisë.

#### *Zgjedhjet*

Klima e tensionuar dhe e polarizuar politike përpara zgjedhjeve të qershorit vuri në rrezik punën e institucioneve të administrimit të zgjedhjeve. Zgjedhjet në vetvete ishin konkurruese dhe të organizuara në një mënyrë të rregullt në përgjithësi. Pjesëmarrja e votuesve ishte 53.6%. Votimi dhe numërimi ecën mirë, me përjashtim të disa incidenteve të izoluara dhe parregullsive procedurale të cilat nuk ndikuan organizimin e qetë të përgjithshëm të zgjedhjeve. Në përgjithësi, zgjedhjet shënuan një progres të prekshëm në krahasim me praktikën e kaluar duke sjellë plotësimin e prioritetit kyç lidhur me organizimin e zgjedhjeve. Zgjerimi i mëtejshëm i pavarësisë së administratës zgjedhore në të gjitha nivelet, si dhe zbatimi i rekomandimeve të OSBE/ODIHR pas zgjedhjeve, janë të rëndësishme për përmirësimin e vazhdueshëm në zgjedhjet e ardhshme.

---

<sup>3</sup> Pa paragjykuar qëndrimet e shteteve mbi statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së si dhe me Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## *Parlamenti*

Gjatë sesionit parlamentar të vjeshtës 2012, u miratuan një numër i rëndësishëm aktesh parlamentare me mbështetje ndër-partiake. Në fund të majit, pas një periudhe të te zgjatur të debateve ndërpartiake, parlamenti miratoi masat kyçe të kërkuara për progresin e integritimit në BE, konkretisht Ligjin për Nëpunësin Civil, Ligjin për Gjykatën e Lartë dhe rregulloren e brendshme parlamentare. Rregullat e reja të procedurës do të kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e një funksionimi të rregullt parlamentar, duke konsoliduar progresin e kryer vitin e shkuar përmes adresimit të prioriteteve kyçe relevante.

Në dhjetor, ish kryetari i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Auditimit të Pasurive u votua në pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm me votat e shumicës drejtuese. Opozita, duke mos dhënë vlerësime për cilësitë e kandidatit, nuk votoi duke pohuar se mbarimi i mandatit të kreut të kaluar në detyrë në muajin nëntor ishte anti-kushtetues. Ish Prokurori i Përgjithshëm, që u shkarkua në vitin 2012, nuk është kthyer ende në pozicionin e saj të mëparshëm të gjyqtarës.

Transparenca e procesit legjislativ është rritur. Në faqen e uebit të parlamentit publikohen rregullisht procesverbalet e mbledhjeve të komiteteve dhe sesioneve parlamentare. Është përmirësuar përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin legjislativ. Lidhur me hartimin e legjislacionit, janë shtuar konsultimet me grupet e interesit. Afatet kohore për dhënien e komenteve përgjithësisht mbeten shumë të shkurtra dhe nuk ka rregulla të qarta për konsultimet publike. Një proces konsultimi më transparent dhe gjithëpërfshirës, që përfshin më tej shoqërinë civile dhe partnerët socialë, do të rriste besimin e publikut në hartimin e ligjeve. Projekt-ligjet nuk janë publikuar rregullisht në faqen e uebit të parlamentit dhe shumë prej tyre janë futur në kalendar me një njoftim të shkurtër pa konsultime të mjaftueshme me publikun apo kohë të mjaftueshme për shqyrtim nga anëtarët e parlamentit. Informimi i zgjedhësve nga anëtarët e parlamentit mbetet një fushë për t'u përmirësuar.

Roli mbikëqyrës i parlamentit ka qenë i kufizuar. Në veçanti, ai nuk ka ndjekur së bashku me qeverinë konstatimet e raporteve të institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Mbetet për t'u forcuar bashkëpunimi i Parlamentit me institucione të ndryshme të pavarura.

Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian ka monitoruar nga afër planin e rishikuar të veprimit për adresimin e prioriteteve kyçe të Opinionit të Komisionit. Ai gjithashtu ka ushtruar rolin e vet mbikëqyrës nëpërmjet seancave dëgjimore me Ministrin e Integritimit Evropian, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Integrimi evropian ka mbetur në fokusin e punës së parlamentit.

Kryeministri i ri është angazhuar për të përfshirë nga afër opozitën në procesin e Integritimit Evropian. Konsolidimi i dialogut politik mes mazhorancës dhe opozitës është i nevojshëm për të forcuar më tej funksionimin demokratik të parlamentit.

*Në tërësi*, është përmirësuar funksionimi i parlamentit. Është rritur transparenca e procesit legjislativ dhe përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Shqipëria ka nevojë të fokusojë përpjekjet e veta në një proces konsultimi më përfshirës dhe në forcimin e rolit mbikëqyrës të

parlamentit. Është e rëndësishme që bashkëpunimi mes qeverisë dhe opozitës të funksionojë mirë për të siguruar një bazë solide për reforma të mëtejshme.

### *Qeveria*

Qeveria ka vazhduar të përsërisë angazhimin e saj për integrimin në BE. Vazhdon zbatimi i planit të rishikuar të veprimit për adresimin e prioriteteve kyçe të Opinionit, megjithëse me një ritëm të ngadalshëm. Është shtyrë miratimi i dokumenteve të rëndësishme strategjike të tilla si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për vitet 2014-20 dhe Plani i përditësuar Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Ministria e Integritimit Evropian (MIE) ka konsoliduar rolin e saj si koordinatore kyçe për çështjet e BE-së; p.sh. ministritë e linjës kanë qenë të ngarkuara me përgjegjësi institucionale për përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së. Për të menaxhuar sfidat e reformave të ardhshme lidhur me BE-në, duhet të forcohet kapaciteti institucional i ministrisë. Funksionimi i 35 grupeve ndër-institucionale të punës nuk është përmirësuar dhe në masë të madhe ato mbeten grupe *ad hoc*.

Duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi ndërmjet MIE dhe ministrive të linjës, si edhe të respektohet sistematikisht roli koordinues i ministrisë.

Në prill u bë një riorganizim i qeverisë, pasi Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), partneri i koalicionit të Partisë Demokratike, u tërhoq nga koalicioni qeverisës dhe formoi një koalicion zgjedhor ('Aleanca për Integrimin Evropian') me Partinë Socialiste (PS). Pas zgjedhjeve të përgjithshme, një qeveri e re koalicioni e udhëhequr nga PS-ja dhe me pjesëmarrjen e LSI-së u emërua brenda javës së parë të legjislaturës së re në fillim të shtatorit. Kalimi në qeverisjen e re ishte i qetë. Integrimi evropian është një prioritet kyç i programit të qeverisë së re.

Për sa i përket *vetë-qeverisjes vendore*, reforma administrative territoriale dhe decentralizimi kanë evoluar pak. Ligji mbi Planifikimin Urban u miratua në prill me qëllim qartësimin e instrumenteve të planifikimit, kompetencat dhe procedurat përkatëse. Zbatimi i Ligjit mbi Planifikimin e Territorit është i ngadalshëm. Njësitë e qeverisjes vendore, veçanërisht ato me buxhete të ulëta dhe pak burime njerëzore, kanë vështirësi në zbatimin e legjislacionit përkatës dhe programet zhvillimore.

Të ardhurat e qeverisjes vendore kanë rënë me 21%. Burimet e qeverisjes vendore njerëzore, menaxhimi dhe kontrolli financiar mbetet i dobët. Mungesa e fondeve të orientuara strategjikisht dhe financimi qendror bazuar në transparencë mbetet një sfidë, ashtu siç mbetet përqindja e lartë e kontratave të përkohshme në administratën e qeverisjes vendore. Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për strukturën dhe organizimin e organeve publike" nuk është zbatuar në nivel vendor. Debati tepër i politizuar për përbërjen e disa autoriteteve rajonale dhe bashkiake ka penguar efektivitetin e tyre dhe ka kufizuar rolin e shoqatave të autoriteteve vendore në forcimin e koordinimit ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror. Autoritetet vendore duhet të zhvillojnë një dialog strategjik gjithëpërfshirës me shoqërinë civile.

*Në tërësi*, Qeveria ka vazhduar përpjekjet e saj për reforma politike dhe integruese në BE, në prag të zgjedhjeve, pas periudhës së zgjedhjeve dhe pasi qeveria e re mori detyrën. Ka vijuar zbatimi i planit të rishikuar të veprimit për të adresuar prioritetet kyçe të Opinionit, megjithëse me një ritëm të ngadalshëm. Qeveria e re do të duhet të përqendrohet menjëherë në forcimin e planifikimit



strategjik dhe buxhetimit dhe në përmirësimin e koordinimit në nivel qendror dhe/me nivelin vendor. Në kuadër të reformave që lidhen me BE-në, duhet të intensifikohet monitorimi i zbatimit, vazhdimi i mëtejshëm dhe veprimet korrigjuese.

Lidhur me qeverinë vendore, duhet të promovohet demokracia vendore dhe decentralizimi fiskal. Nevojiten përpjekje edhe më të mëdha për të forcuar efektivitetin, transparencën, gjithëpërfshirjen dhe planifikimin strategjik, luftën kundër politizimit dhe korrupsionit. Është i nevojshëm koordinimi i ngushtë mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore, përfshi forcimin e rolit të shoqatave të qeverisjes vendore.

### *Administrata Publike*

Reforma e administratës publike është një tjetër prioritet kyç i Opinionit. Miratimi në maj i Ligjit të Shërbimit Civil, një nga masat e kërkuara për marrjen e statusit të vendit kandidat ishte një hap i madh drejt depolitizimit të administratës publike. Ligji, që ka hyrë në fuqi në tetor, është thelbësor për ndërtimin e një administratë publike profesionale, efektive dhe të bazuar në merita. Ai synon të krijojë një kornizë të qëndrueshme ligjore përbërë nga administrata shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Ai siguron një klasifikim të qartë të nëpunësve civilë, përcakton formalisht një trupë menaxhuese të nivelit të lartë të nëpunësit civil dhe siguron bazën për një rekrutim transparent dhe sistemin e gradimit. Ligji shfuqizon legjislacionin ekzistues pa ofruar dispozitat e nevojshme kalimtare deri në hyrjen në fuqi të zbatimit të këtij legjislacioni; në shtator 2013 qeveria miratoi ndryshimet teknike për të shmangur këtë vakum ligjor. Është thelbësor miratimi në kohë i akteve nënligjore në përputhje me parimet e ligjit dhe zbatimit të tij. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative është ende në pritje.

Zbatimi i Ligjit për Gjykatat Administrative u shty në pritje të hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën e Lartë, një nga tre ligjet e nevojshme për të marrë statusin e kandidatit. Duhet të forcohet zbatimi i Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Publike. Zbatimi i Ligjit mbi inspektimet ka përparuar me miratimin, në shkurt, të dispozitave që synojnë zvogëlimin e kohëzgjatjes dhe kostos së inspektimeve. Gjithashtu, është miratuar legjislacioni dytësor për strukturën, organizimin dhe kodin e etikës së personelit të Inspektoratit të Përgjithshëm. Numri i inspektorateve u zvogëlua nga 36 në 11.

Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për strukturën dhe organizimin e institucioneve publike" është zbatuar në nivel qendror. Me synimin për përmbushjen e objektivit të synuar 2.5% në vitin 2010, përqindja e kontratave të përkohshme në organet shtetërore u reduktua edhe më tej në, aktualisht, 4,8%. Departamenti i Administratës Publike nuk është plotësisht në gjendje të zbatojë vendimet e veta apo të koordinohet në mënyrë efektive me institucionet e tjera, pjesërisht për shkak të kufizimeve buxhetore. Sistemi Informativ Menaxherial i Burimeve Njerëzore nuk është plotësisht funksional; faza e dytë pilot është përballur me vonesa të konsiderueshme.

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike e ka realizuar planin vjetor të trajnimit, pavarësisht kufizimeve financiare. Në shkurt u miratua një vendim për të ngritur një shkollë të administratës publike. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme që shkolla të punojë si duhet, duke përfshirë sigurimin e fondeve të nevojshme.

Shkalla e zbatimit të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil mbetet e ulët. Sipas Ligjit të ri për Shërbimin Civil, Komisioni do të zëvendësohet nga një Komisioner i Shërbimit Civil, i cili do të

mbajë detyrat e veta monitoruese. Institucioni i ri duhet të funksionojë plotësisht dhe të demonstrojë pavarësinë e tij.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka përmirësuar performancën e tij duke miratuar manualin e ri për auditimin dhe kryerjen e më shumë detyrave të auditimit. Ai paraqiti një raport vjetor për punën e tij në parlament në muajin mars. Ai ka zhvilluar 177 auditime dhe dëmet ekonomike shkaktuar nga funksionimi jo i duhur i institucioneve shtetërore raportohet të jetë 97.300.000 € nga € 50 milion në vitin 2011. Ai ka paraqitur në zyrën e prokurorisë 40 kërkesa për hetime penale (që përfshijnë 125 punonjës), dy herë më shumë se gjatë tre viteve të kaluara së bashku, duke theksuar në veçanti abuzimin e pronës publike nga administratorë publikë të rangut të lartë. Më shumë se dy të tretat e rekomandimeve nga ana e institucionit janë zbatuar. Ndryshimet në Ligjin e Auditimit të Institucioneve Shtetëror janë në pritje dhe nevojitet përfshirja e një performace të qëndrueshme auditimi.

Kapacitetet e dobëta analitike dhe qarkullimi i stafit të lartë në ministritë e linjës, së bashku me transparencën e pamjaftueshme dhe konsultimin me palët e interesuara vazhdojnë të pengojnë procesin e hartimit legjislativ. Duhet të përmirësohet vlerësimi i impaktit rregullator si edhe zbatimi dhe monitorimi i legjislacionit të miratuar.

*Në tërësi*, ka pasur përparime në reformën e administratës publike dhe është ndërmarrë një hap i madh në këtë prioritet kyç me miratimin e Ligjit për Shërbimin Civil. Tani ekziston një nevojë urgjente për zbatimin e tij në praktikë dhe të bazuar në merita. Duhet të përshpejtohet zbatimi i legjislacionit ekzistues dhe akteve administrative. Departamenti i Administratës Publike duhet të forcohet. Institucionet e pavarura duhet të përmirësohen dhe rekomandimet e tyre të merren në konsideratë. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për depolitizimin e administratës publike, për të siguruar vazhdimësinë, për të luftuar korrupsionin, për të forcuar meritokracinë në emërimet, promovimet dhe shkarkimet, për të rritur eficientësinë e saj dhe qëndrueshmërinë financiare.

#### *Avokati i Popullit*

Avokati i Popullit ka ndërmarrë një sërë nismash mjaft pozitive. Ai ka promovuar aktivisht të drejtat e njeriut, në veçanti ato nga grupet më të rrezikuara, dhe ka bashkëpunuar intensivisht me shoqërinë civile. Ai ka dërguar një raport vjetor në parlament mbi situatën e grupeve specifike të rrezikuara në shoqëri dhe ka bërë rekomandime për të luftuar përjashtimin e tyre. Ndjekja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit shënon përmirësime. Për shembull, shumica e rekomandimeve për keqtrajtimin në qendrat e paraburgimit- një çështje e përfshirë në prioritetet kyç- është adresuar nga burgjet dhe nga Policia e Shtetit. Raportimet e veçanta të Avokatit të Popullit në parlament nuk janë përfshirë në rendin e ditës të parlamentit, kështu që ato nuk mund të publikohen dhe nuk janë njohur zyrtarisht. Avokati i Popullit nuk ka qenë i informuar dhe konsultuar siç duhet me qeverinë në hartimin e legjislacionit dhe reformave. Buxheti i alokuar për zyrën e Avokatit të Popullit mbetet i pamjaftueshëm dhe institucioni ka nevojë për mbështetje të mëtejshme financiare dhe politike nga të dyja anët si parlamenti edhe qeverisa që të vazhdojë të kryejë detyrat e veta.

#### *Shoqëria civile*

Organizatat e shoqërisë civile mbeten të fragmentuara dhe tepër të varura nga fondet e donatorëve të huaj. Kuadri tatimor për organizatat e shoqërisë civile ende përfshin dispozita që minojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare, veçanërisht për rimbursimin e TVSH-së. Ligji për organizatat jofitimprurëse është ndryshuar duke ju kërkuar organizatave të tilla të raportojnë të gjitha burimet e tyre financiare në administratën tatimore, për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile mbetet i dobët veçanërisht në nivel komunal. Një nga sfidat kryesore për autoritetet shqiptare është të bëjë konsultime më sistematike, transparente dhe në kohë me shoqërinë civile. Kjo vlen edhe për zhvillimin e politikave, hartimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij. Duhet të forcohet kapaciteti i këtyre organizatave për të marrë pjesë në vendim-marrje publike, veçanërisht në zonat rurale. Pushtetit vendor i mungojnë kapacitetet e duhura për të siguruar bashkëpunimin e duhur dhe financimin e shoqërisë civile. Nevojiten përpjekje të mëtejshme substanciale për të zhvilluar shërbime bazuar në komunitet.

Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile përfundoi thirrjen e saj të katërt për propozime në prill dhe bëri shpërndarjen e granteve.

#### *Sistemi gjyqësor*

Strategjia 2011-13 e reformës gjyqësore, një prioritet kyç i Opinionit, është duke u zbatuar. Janë miratuar Ligji për Gjykatën e Lartë, një prej masave kryesore në këtë fushë, si edhe ndryshimet në Kodin Penal, Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile. Ligji për Administratën Gjyqësore u miratua për të siguruar një kuadër ligjor për punën e gjykatave dhe stafit të gjykatës; pavarësia e kancelarëve të gjykatave mbetet një çështje shqetësuese. Ligji për Konferencën Kombëtare Gjyqësore dhe Ligji për Profesionin e Avokatit ka filluar të zbatohet. Memorandumi i mirëkuptimit për inspektimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili synon të reduktojë rrezikun e mbivendosjes së përgjegjësive ka vazhduar të zbatohet. Mbeten ende për t'u miratuar apo finalizuar ndryshimet kushtetuese dhe legjislacioni thelbësor për të siguruar pavarësinë, transparencën dhe efikasitetin e gjyqësorit. Procedura e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë duhet të ndryshohet. Nevojitet organizim efikas i gjykatave, ndarje e qartë dhe efektive e buxhetit, procedura gjyqësore të unifikuara, të shpejta dhe transparente dhe një sistem i emërimit të gjyqtarëve bazuar në një vlerësim të shëndoshë të performancës së kandidatëve. Heqja e imunitetit të gjyqtarëve si pjesë e luftës kundër korrupsionit nuk ka çuar ende në raste të veçanta me hyrjen në fuqi të dispozitave të reja kushtetuese.

Për një analizë të detajuar të zhvillimeve në sistemin gjyqësor, shih Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

#### *Politika anti-korrupsion*

Ka pasur përmirësime në luftën kundër korrupsionit, si një prioritet kyç i Opinionit. Të gjitha rekomandimet e raundit të tretë të vlerësimit të GRECO-s kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme. Kjo ka prekur sidomos financimin partive politike. Të dhënat fillestare të rezultateve mbulojnë një shumëllojshmëri të sektorëve dhe niveleve, duke përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë dhe tregojnë një rritje në dënime. Disa nga masat e marra në sektorët kyç dëshmojnë për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj korrupsionit, një përmirësim të përgjithshëm organizimi dhe një

bashkëpunim më të efektshëm standardizues ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit. Ofrimi i shërbimeve publike në internet dhe masat ndërgjegjësuese në sektorë të ndryshëm kanë krijuar kushte për më shumë transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike. Korrupsioni mbetet një problem serioz dhe është i përhapur në shumë fusha, përfshi institucionet e zbatimit të ligjit. Ka ende boshllëqe serioze, p.sh. në monitorimin e korrupsionit të qeverive vendore. Duhet të ndërmerret një vlerësim edhe në lidhje me rolin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse dhe koordinimin e tyre për të forcuar më tej organizimin e përgjithshëm anti-korrupsion. Duhet të caktohet një koordinator anti - korrupsion me një mandat të fortë për të kryer këtë . Ekziston gjithashtu një nevojë për të përmirësuar bashkëpunimin me organet e pavarura të kontrollit si Kontrolli i Lartë i Shtetit. Pas ndryshimeve kushtetuese për kufizimin e imunitetit të gjyqtarëve dhe zyrtarëve të lartë janë të nevojshme masat për të sqaruar procedurat hetimore. Sfida afatshkurtër është që të ngrihen hetime proaktive bazuar në vlerësimin sistematik të rrezikut, si parakusht për vijueshmërinë e rezultateve të ndjekjes efektive penale në të gjitha nivelet, veçanërisht në ato fusha ku ekziston një perceptim i fortë publik për korrupsion.

Për një analizë të detajuar të zhvillimeve në fushën e politikës anti-korrupsion, *shih Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore.*

### *Lufta kundër krimit të organizuar*

Progres është bërë në luftën kundër krimit të organizuar, një prioritet kyç i Opinionit. Është miratuar një strategji e re dhe plani i veprimit mbi krimin e organizuar. Është forcuar bashkëpunimi me policinë ndërkombëtare. Është rritur numri i hetimeve të pasurisë, konfiskimet dhe rastet e dërguara në gjykata. Është rritur analiza e rrezikut dhe përdorimi i inteligjencës kriminale, pjesërisht nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar. Konfiskimet e drogës janë rritur. Janë zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme strukturat operacionale për mbrojtjen e dëshmitarëve. Rekomandimet e MONEYVAL lidhur me luftën kundër pastrimit të parave janë adresuar në mënyrë adekuate. Ndryshimet në Kodin Penal kanë adresuar çështjen e trafikimit të brendshëm të qenieve njerëzore, dhe kanë përfshirë kriminalizimin e përdorimit të shërbimeve të viktimave të trafikimit. Është rritur bashkëpunimi ndërmjet zyrtarëve të prokurorisë, policisë dhe gjyqësorit lidhur me trafikimin. Është ngritur një njësi e policisë për të luftuar krimin kibernetik. Janë organizuar trajnime të përbashkëta për oficerët e policisë dhe zyrtarë të prokurorisë në çështjet që përfshijnë konfiskimet e pasurive dhe krimin kibernetik. Krimi i organizuar mbetet një shqetësim serioz dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme të rëndësishme për të përmirësuar vijimësinë e të dhënave të Shqipërisë. Mbeten në pritje ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale. Numri i konfiskimeve të pasurive kriminale dhe dënimeve për pastrimin e parave mbetet i ulët. Duhet të intensifikohen ndjeshëm hetimet proaktive për pasuri të fituara nëpërmjet aktivitetit kriminal jashtë, por të investuara në Shqipëri. Shqipëria mbetet një vend burimi për trafikimin e të rriturve dhe të miturve, përfshi lypjen e detyruar nga fëmijët. Kjo çështje kërkon koordinim më të mirë mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale. Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit mbetet një kërcënim serioz.

Për një analizë të detajuar të zhvillimeve në luftën kundër krimit të organizuar, *shih Kapitullin 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria.*

## **2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve**

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa konkretë për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për të zbatuar efektivisht politikat anti-diskriminuese – të dyja fushat janë ndër prioritetet kyçe. Kjo paraqet një tablo të përzierë lidhur me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Liria e tubimit dhe e organizimit, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë kanë qenë përgjithësisht të respektuara.

Për sa i përket lirisë së shprehjes, është bërë progres. Ligji për mediat audiovizive është miratuar në mars, duke përmirësuar në thelb kuadrin legjislativ për mediat audiovizive në Shqipëri. Gjithsesi, ligji nuk arrin të sigurojë një procedurë të përzgjedhjes për organet drejtuese të autoritetit rregullator dhe transmetuesit publik që garanton pavarësinë e tyre. Hapa të mëtejshëm nevojiten për dekriminalizimin e plotë të shpifjes. Ndërhyrja në media nga interesat politike dhe ekonomike duhet të jetë e kufizuar.

Ekziston legjislacioni në fushën e politikave anti-diskriminuese - p.sh. lidhur me të drejtat e personave **lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë** (LGBTI) - dhe mungon p.sh. legjislacion në lidhje me komunitetin rom. Autoritetet shqiptare duhet të zbatojnë edhe legjislacionin ekzistues edhe të hartojnë legjislacion të ri në fushën e anti-diskriminimit. Janë ndërmarrë një numër hapash konkretë. Ekziston një plan veprimi LGBTI , si dhe është ndryshuar Kodi Penal që merr parasysh rrethanat rënduese për shkeljet me bazë gjinie, race, etnie, identiteti gjinor, orientimi seksual, besimi fetar, feje, statusi shëndetësor, predispozite gjenetike apo aftësie të kufizuar.

Në përputhje me planin e veprimit kombëtar për “Dekadën e romëve”, Shqipëria duhet të përmirësojë me shpejtësi kushtet e jetesës së romëve; koordinimi mes pushtetit qendror dhe lokal është thelbësor në këtë kontekst. Një tjetër fushë kyçe për t’u përqëndruar menjëherë është aksesimi në arsim dhe përfshirja e fëmijëve romë në sistemin arsimor - nga niveli parashkollor deri në arsimin e lartë.

Ndërgjegjësimi i publikut për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mekanizmi i ankesës mbetet i ulët. Zbatimi i ligjit duhet të forcohet; viktimat e diskriminimit duhet të inkurajohen të parashtrajnë ankesa për të krijuar praktika gjyqësor solide. Rolet e zyrave të Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit Kundër Diskriminimit duhet të qartësohen për t’u bërë më efektive.

Kuadri ligjor për të drejtat ekonomike dhe sociale është përmirësuar, por zbatimi tij është i ngadalshëm, veçanërisht në lidhje me njerëzit me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në rrezik të abuzimit. Nevojiten përpjekje të mëdha dhe sistematike për të adresuar problemet e vazhdueshme në fushën e të drejtave pronësore. Kthimi i pronave, kompensimi dhe ndërtimet e paligjshme janë çështje që duhet të trajtohen. Shqipëria duhet të miratojë dhe të komunikojë një plan të besueshëm për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të drejtat pronësore. Të drejtat e punës dhe të bashkimit në sindikata janë respektuar në përgjithësi.

Për një analizë të detajuar të zhvillimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave, *shih Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore*. Për zhvillimet në fushat e të drejtave të bashkimit në sindikata, anti-diskriminimit dhe mundësive të barabarta, *shih gjithashtu Kapitullin 19 - politikat sociale dhe punësimi*.

### 2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Shqipëria ka ende një marrëveshje dypalëshe të vitit 2003 me Shtetet e Bashkuara të Amerikës që siguron përjashtimin nga juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Kjo nuk është në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së mbi integritetin e Statutit të Romës apo me parime të tjera udhëzuese të BE-së lidhur me marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Vendi ka nevojë të përshtatet me pozicionimin e BE-së.

**Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore** vazhdojnë të jenë një pikë e fortë për politikën rajonale të Shqipërisë. Shqipëria ka vazhduar të luajë një rol aktiv në nismat rajonale, përfshi Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Jug Lindore, Bashkëpunimin Rajonal, Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal. Nismën e Evropës Qendrore, Nismën e vendeve të Adriatikut dhe Jonit (IAJ), Nismën e Migracionit, Azilit dhe Refugjatëve Rajonalë, Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Shqipëria në vitin 2012 mbajti kryesimin e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) dhe bashkëkryesoi aktivitetet në kuadër të Komitetit Investues të Evropës Jug Lindore. Që nga qershori Shqipëria mban kryesimin një vjeçar të (IAJ) II

Shqipëria ka vazhduar të luajë rolin e saj si një partner konstruktiv në rajon duke zhvilluar më tej **marrëdhëniet dypalëshe me shtetet e tjera të zgjerimit dhe shtetet fqinje anëtare të BE-së.**

Rritja e retorikës nacionalistë që zgjati për një kohë të shkurtër në fund të vitit 2012 dhe në fillim të vitit 2013 shkaktoi shqetësime përreth fqinjëve dhe partnerëve të tjerë, por që më pas u qetësua. Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi dhe Kroacia firmosën një marrëveshje mirëkuptimi për mbështetjen dhe bashkëpunimin si në projektin e Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) ashtu edhe projektit të Gazsjellësit Jonian Adriatik (IAP). Nuk është nënshkruar ende një marrëveshje dypalëshe mbi bashkëpunimin rajonal sipas Nenit 12 të MSA-së as me Serbinë dhe as me Malin e Zi.

Është firmosur një protokoll bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë të Shqipërisë dhe *Bosnjë-Hercegovinës*, duke mundësuar një shkëmbim më të mirë informacioni lidhur me çështjet ligjore dhe zbatimin e reformave ligjore.

Është firmosur një marrëveshje dypalëshe me *ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë* mbi njohjen e ndërsjellë të patentave të makinave dhe është hapur një pikë e re e përbashkët kufitare.

Janë firmosur marrëveshje në fusha të ndryshme me Malin e Zi, përfshi mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, arsim dhe shkëmbim elektronik të të dhënave doganore. Në dhjetor, parlamenti ratifikoi një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Malit të Zi për ngritjen e hekurudhës ndërkufitare.

Ministri i jashtëm i Serbisë vizitoi Tiranën në tetor 2012 duke shënuar vizitën e parë të tillë në tetë vite. Marrëdhëniet dypalëshe kanë qenë herë-herë të tensionuara, ku secila palë fajësonte palën tjetër për deklarata apo veprime që ngrinin tensionet.

Shqipëria vazhdoi të mbajë marrëdhënie shumë të mira me *Kosovën*, me të cilën ka firmosur marrëveshje për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, mbi asistencën juridike në çështjet penale, për ekstradimin, për transferimin e personave të dënuar dhe mbi bashkëpunimin e taksimit dhe luftën kundër evazionit tatimor.

Shqipëria vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me *Turqinë*.

Në shkurt, *Shqipëria, Italia dhe Greqia* firmosën një marrëveshje ndërqeveritare duke konfirmuar mbështetjen e tyre për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik.

*Në tërësi*, Shqipëria ka vazhduar të luajë rol konstruktiv në kontribuimin e stabilitetit të rajonit. Në këtë këndvështrim, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë kushtet e Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit.

### **3. KRITERI EKONOMIK**

Për shqyrtimin e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, Komisioni është orientuar nga përfundimet e Këshillit Evropian në Kopenhagën në qershor të 1993-it, sipas të cilave anëtarësimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe aftësinë për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian.

#### **3.1. Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale**

##### *Bazat e politikës ekonomike*

Partitë kryesore janë dakord për bazat e ekonomisë së tregut, pavarësisht ambientit të tensionuar politik. Stabiliteti makroekonomik është ruajtur gjerësisht, por ka ende dobësi. Deficiti buxhetor e tejkaloi objektivin në vitin 2012. Kjo çoi në shkeljen dhe shfuqizimin e tavanit ligjor të borxhit prej 60% të PBB-së që ishte i parashikuar në ligjin për buxhetin. Procesi i privatizimit ka pësuar disa sprapsje. Shqipëria dorëzoi Programin e saj të shtatë Ekonomik dhe Fiskal për periudhën 2013-2015, në janar. Skenari makroekonomik afatmesëm i programit është optimist. Mbulimi i rreziqeve nga pikëpamja makroekonomike dhe buxhetore është i pamjaftueshëm, dhe qasjes për adresimin e pengesave strukturore kundrejt rritjes i mungon strategjia e qartë dhe masat për politikën e synuara. *Në tërësi*, është ruajtur konsensusi mbi parimet kryesore të një ekonomie tregu.

##### *Stabiliteti makroekonomik*

Sipas të dhënave paraprake, rritja ekonomike u zvogëluar në 1.6% në vitin 2012 nga ajo 3.1% e një viti më parë. Vështirësitë financiare, besimi i ulët mes konsumatorëve dhe investitorëve, dhe gjendja e varfër e kapacitetit prodhues penguan konsumin privat dhe shpenzimet në investime. Formimi bruto i kapitalit fiks u ul me rreth 5% në vitin 2012 krahasuar me atë të vitit të kaluar. Remitancat e emigrantëve u rritën lehtë, me rreth 1.6% në vitin 2012, por ranë me 33% në vlerë vjetore në muajt e parë të vitit 2013. Konsumi privat qëndroi në nivele të ulëta. Eksportet neto ishin kontribuuesit kryesorë të rritjes ekonomike, me ruajtjen e shitjeve të huaja ndërkohë që importet ranë. Pas rënies në katër tremujorë të njëpasnjëshëm, treguesit e ndjesisë ekonomike filluan të rriten në fund të vitit 2012 dhe në fillim të vitit 2013, por PBB-ja reale u rrit me vetëm 1.7% në tremujorin e parë të vitit 2013 në terma vjetore, duke reflektuar sërish shpenzime të ngadalshme të ekonomisë së brendshme. Kërkesa e huaj vazhdoi të kontribuojë pozitivisht në rritje. PBB për frymë në standardin e fuqisë blerëse është vlerësuar në 30% të mesatares së BE-27 në vitin 2012, nuk ka pësuar luhataje nga viti 2011. *Në tërësi*, ndërkohë që rritja mbeti pozitive, Shqipëria përjetoi një ngadalësim në vitin 2012 si rrjedhojë e shpenzimit të brendshëm të ulët, gjë që u shtri edhe në tremujorin e parë të vitit 2013.

Deficiti me jashtë u përmirësua pasi eksportet rezultuan të qëndrueshme ndërkohë që kërkesa e brendshme e dobët krijoi ulje në importe. Deficiti i llogarisë korrente në 2012-ën u ngushtua nga 13% në vitin e kaluar në 10,5% të PBB-së, si pasojë e deficitit tregtar të kontraktuar (por ende të lartë). Në krahasim me vitin e mëparshëm, importet ranë me 5.2%. Eksportet u rritën në një nivel marginal prej 0.9%, rritja në 8.5% e eksportit të mallrave është kompensuar gjerësisht nga rënia drastike e eksportit të shërbimeve. Efekti i përmirësimit të performancës tregtare ishte më i madh se ndryshimet negative, në balancat e të ardhurave dhe të transfertave korrente. Tendenca drejt një deficitit tregtar shtrëngues vazhdoi gjatë 7-mujorit të parë të 2013-ës: eksportet e mallrave, të tërhequra nga gjallërimi i sektorit energjetik, patën një rritje në terma vjetorë prej 18.4%, ndërkohë që importi i mallrave u ul në masën 5%. Deficiti i llogarisë korrente qëndroi stabil në 10.1% të PBB-së, gjatë katër tremujorëve deri në qershor 2013.

Në 2012-ën, fluksi hyrës i IHD-së neto qëndroi në të njëjtin nivel të 2011-ës dhe mbuloi rreth 70% të deficitit të llogarisë korrente, duke shënuar një rritje nga 60% të vitit të mëparshëm. Fluksi hyrës i përgjithshëm i llogarive kapitale në bazë vjetore ra në 11.3% në 2012-ën, por bilanci i përgjithshëm i pagesave ishte pozitiv dhe stoku i rezervave valutore u rrit në masën 4.2%, duke mbuluar rreth 4.5 muaj importe. Në gjashtëmujorin e parë të 2013-ës, flukset hyrëse të IHD-së u rritën me rreth 12.3% në terma vjetorë. *Në tërësi*, deficiti i llogarisë korrente ka ardhur duke u ngushtuar por vazhdon të mbetet një burim cenimi, sidomos duke pasur parasysh ndikimin potencial negativ të mjedisit të jashtëm të paqëndrueshëm mbi fluksin hyrës të IHD-ve dhe remitancat e emigrantëve.

Kushtet e tregut të punës u përmirësuan disi gjatë vitit 2012, por shkalla e papunësisë së regjistruar mbeti e lartë në një mesatare 13%, me një ulje të lehtë nga 13.4% në vitin 2011. Punësimi u rrit me 2.8% për shkak të rritjes së numrit të vendeve të punës në sektorin privat jo-bujqësor dhe nga numri më i lartë i vlerësuar i punëmarrësve në sektorin bujqësor. Në gjysmën e parë të vitit 2013, papunësia ishte e qëndrueshme në 12.8%. Papunësia afatgjatë përbën rreth dy të tretat e punëkërkesve, duke reflektuar natyrën e saj strukturore. Statistikat e tregut të punës vijuan të mbeten të dobëta dhe të pasakta nga një sektor i madh informal. *Në tërësi*, ka pasur një përmirësim të lehtë në tregun e punës, por sektori informal mbetet i madh dhe papunësia është ende e lartë.

Stabiliteti makroekonomik vijoi të përmirësohet nga një politikë e qëndrueshme monetare, e cila ishte e suksesshme në mbajtjen ulët të inflacionit dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste. Norma mesatare e inflacionit u ul nga 3.5% në vitin 2011 në 2% në vitin 2012, që korrespondon me nivelin më të ulët të objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 2-4%. Inflacioni i ulët reflektoi hapësirë negative të prodhimit, mbajtjen nën kontroll të pritjeve inflacioniste dhe mungesën e luhatjeve në ofertë. Nxitur kryesisht nga luhatjet e çmimeve të ushqimeve, inflacioni vjetor u ngadalësua nga 2.5% në tremujorin e parë të vitit 2013 në 2.2% në tremujorin e dytë. Në mungesë të presioneve inflacioniste dhe në një përpjekje për të nxitur rritjen, BSH ndërmoi disa ulje në normën bazë të interesit duke e sjellë atë në pikën më të ulët historike në fillim me 3.75% në janar dhe në vijim në 3.5% në korrik. Ulja e normës u reflektua me shpejtësi në normat e interesit ndërbankar, tregu kryesor për letrat me vlerë të qeverisë dhe gjithashtu, në normat e depozitave. Megjithatë, efekti në uljen e normave të interesit të huave është i kufizuar për shkak të rritjes së primeve të rrezikut dhe të normës në rritje të kredive të këqija.

Niveli i euroizimit të sistemit financiar ka rënë pak, por vazhdon të jetë i lartë. Huat në valutë, kryesisht ato në euro, në korrik kanë qëndruar në nivelin 61% të tepricës totale të kredisë, pra më të ulëta se në vitin e mëparshëm ku niveli ishte rreth 64%. Pjesa e depozitave në monedhë të huaj



për të njëjtën periudhë, ka rënë nga 49%, në 47% të stokut të depozitave totale. Një euroizim i tillë pengon efektivitetin e politikës monetare dhe rrezikon t'i ekspozojë bankat ndaj mospërputhjes valutore ose risqeve indirekte të kredisë; duke përbërë një burim potencial paqëndrueshmërie për sistemin financiar.

Shqipëria ka një nivel të qëndrueshëm të luhatjes së kursit të këmbimit, i pandryshuar që prej vitit 1992. Monedha shqiptare Lek vazhdoi të jetë e qëndrueshme në 2012-ën, duke shënuar një vlerësim të lehtë prej 0.9% ndaj euros. Në tremujorin e dytë të 2013-ës, monedha shqiptare shënoi një zhvlerësim të lehtë ndaj euros me rreth 1% krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Në tërësi, politika monetare mbeti e qëndrueshme, inflacioni u ngadalësua dhe u ruajt niveli i kursit të këmbimit.

Deficiti publik arriti në 3.4% të PBB në 2012-ën, duke tejkaluar nivelin 3% të planifikuar në buxhetin fillestar, por gjithsesi qëndroi më i ulët se ai i vitit 2011, që arriti në nivelin 3.5%. Performancat zhgënjyese e mbledhjes së të ardhurave dëshmojnë se duhen caktuar objektiva të reja buxhetore në Aktin Normativ të nëntorit. Në tërësi, të ardhurat kanë performuar rreth 7% më pak në 2012-ën krahasuar me planifikimin e buxhetit fillestar, pasi zërat kryesore të buxhetit, si TVSH-ja dhe të ardhurat nga akcizat kanë rënë në mënyrë domethënëse krahasuar me objektivat fillestarë, duke pasqyruar një kërkesë të brendshme në rënie. Luhatjet e të ardhurave u kompensuan vetëm pjesërisht në anën e shpenzimeve, ku shkurtimet më të mëdha kanë prekur shpenzimet kapitale, që ranë me rreth 12% krahasuar me objektivat fillestare dhe po aq krahasuar edhe me 2011-ën. Për shkak të nivelit të ulët të mbledhjes së të ardhurave, raporti i të ardhurave totale mbi PBB-së ra në 24.5% nga 25% në 2011, ndërsa raporti i shpenzimeve totale mbi PBB-në ra në 28.0% në 2012 nga 28.6% një vit më parë. Shpenzimet kapitale publike përbëjnë vetëm 4.6% të PBB-së krahasuar me 5.4% në 2011-ën.

Politika fiskale në 2013 është më ekspansioniste. Buxheti i 2013-ës parashikon një deficit prej 3.5% të PBB-së, bazuar në një objektiv optimist të rritjes ekonomike prej 3.1%. Në shtatëmuajorin e parë, deficiti fiskal (pa llogaritur të ardhurat nga privatizimi i tre hidrocentraleve) ka qenë pothuajse 130% më i lartë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në rreth 98% të objektivit vjetor. Në periudhën janar-korrik, të ardhurat nga tatimet indirekte kanë rënë ndjeshëm, duke reflektuar një kërkesë të brendshme ende të brishtë, importe më të ulëta dhe efektet e përjashtimit nga TVSH-ja. Niveli i shpenzimeve ka qenë 10.4%, më i lartë se ai i të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, kryesisht për shkak të rritjes së shpejtë të shpenzimeve kapitale. Në tërësi, planifikimi i buxhetit vazhdon të jetë i dobët, duke pasqyruar parashikime optimiste të të ardhurave dhe duke çuar në nevojën për ribalancimin e buxhetit.

Borxhi publik u rrit nga 59.4% i PBB-së në 2011-ën, në 62.9% deri në fund të 2012-ës, duke tejkaluar tavanin ligjor prej 60%, i cili u shfuqizua në muajin dhjetor. Rreth tre e pesta e borxhit publik është e brendshme, por vazhdon të ketë një tendencë afatshkurtër (rreth gjysma e tij ka një kohëzgjatje prej një viti ose më pak), duke kërkuar rifinancim të vazhdueshëm. Përqindja e bonove të thesarit të blera nga familjet është në rritje, por pjesa më e madhe e borxhit të brendshëm vazhdon të mbahet nga bankat, gjë që mund të shkaktojë probleme nëse bankat vendosin të ulin stokun e huas publike dhe gjithashtu i ekspozon bankat ndaj riskut sovran. Megjithëse, *yield*-i i ponderuar mesatar i borxhit të brendshëm është ulur në mënyrë progresive; duke qenë në një nivel kaq të lartë, borxhi publik vazhdon të përbëjë një burim rreziku makro-financiar. Shuma e madhe e vlerësuar e borxhit të prapambetur të sektorit publik vazhdon të paraqesë detyrime shtesë të qeverisë, duke shkaktuar vështirësi financiare përgjatë ciklit të kreditimit dhe duke

kontribuar në nivelin e lartë të kredive të këqija. Në tërësi, borxhi publik relativisht i lartë dhe në rritje dhe karakteri i tij afatshkurtër përbëjnë shqetësim, sepse përfaqësojnë një burim rreziku makro-financiar, veçanërisht pas shfuqizimit të tavanit ligjor të borxhit. Akumulimi i borxheve publike të prapambetura pasqyron dobësi serioze në administrimin e financave publike.

Në fushën e administrimit të taksave janë bërë përmirësime për sa i përket pagesës elektronike të taksave dhe sistemit të arkivimit të taksave, por efektet mbi grumbullimin e taksave mbeten për t'u parë. Janë miratuar masa për përjashtimin nga TVSH-ja të makinerive, pajisjeve dhe lëndëve të para të përdorura për investime të caktuara dhe për vendosjen e një limiti të të ardhurave të patatueshme në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale. Vonesat në procedurën e rimbursimit të TVSH-së vazhdojnë të jenë një barrë shtesë për biznesin (*shih gjithashtu Kapitullin 16 – Tatimet*).

Në tërësi, Shqipëria ka ruajtur stabilitetin makroekonomik. Inflacioni i ulët dhe ankorimi i pritjeve inflacioniste krijuan hapësirë për lehtësimin e politikës monetare, por efektet në ekonomi mbeten të kufizuara. Politika buxhetore për 2013-ën është ekspansioniste duke kontribuar në një rritje të mëtejshme të nivelit të relativisht të lartë të borxhit publik që mbetet ende një burim rreziku makrofinanciar. Planifikimi dhe parashikueshmëria fiskale mbeten shqetësuese, sidomos mbas shfuqizimit të kufirit ligjor të borxhit. Papunësia mbetet e lartë. Disekuilibrat e jashtëm janë ngushtuar, por janë ende të larta dhe pasqyrojnë dobësi strukturore të qëndrueshme.

#### *Ndërveprimi i forcave të tregut*

Sektori privat vazhdon të mbizotërojë dhe të përbëjë rreth 80% të PPB-së. Procesi i privatizimeve pati frenime për shkak të dështimit të shitjes së Albpetrol-it, kompani shtetërore e naftës, dhe të kuotave publike të mbetura në Albtelecom, kompani telekomunikacioni pjesërisht e privatizuar. Nuk ka përparuar privatizimi i INSIG-ut, kompania shtetërore e sigurimeve. Shpërndarësi energjisë elektrike CEZ Shpërndarje, i privatizuar më parë, u rikthye në administrim shtetëror pasi Enti Rregullator i Energjisë i tërhoqi licencën e shpërndarjes dhe emëroi një administrator, me arsyetimin se kompania çeke që e kishte në pronësi, nuk i përmbushi detyrimet kontraktuale. Mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar.

Ka pasur disa përparime për sa i përket tërheqjes së investimeve *greenfield* në sektorin e energjetikës dhe në 2012-ën janë nënshkruar 11 marrëveshje të reja për ndërtimin dhe administrimin e hidrocentraleve (HEC). Prodhimi i HEC-ve të vogla në pronësi private është rritur me 76% në 2012-ën krahasuar me një vit më parë, duke rritur edhe pjesën e tyre të prodhimit total të energjisë elektrike nga 3.4% të një viti më parë, në 5.6% në 2012-ën. Në shkurt u kompletua privatizimi i tre hidrocentraleve të vogla, për një total prej 109.500.000 euro. Në tërësi, përfshirja e shtetit në ekonomi vazhdon të jetë e kufizuar dhe përqendrohet kryesisht në furnizimin me ujë, transportin dhe energjinë elektrike.

#### *Hyrja dhe dalja nga tregu*

Regjistrimi dhe licencimi i biznesit vazhdoi të kryhet mirë nëpërmjet rrjetit të krijuar *one-stop-shop*. Disa përmirësime u bënë në sistemin e regjistrimit të biznesit, përmes zbatimit të Regjistrimit Tregtar Elektronik për bashkimet dhe përqendrimit e shoqërive tregtare, si dhe për ndarjet dhe përthithjet. Në 2012-ën numri i bizneseve të reja të regjistruar u rrit me 8% nga një vit më parë; këto përbëjnë 12% të të gjitha sipërmarrjeve aktive.

Është themeluar regjistri i administratorëve të falimentimit të certifikuar dhe 23 administratorë të falimentimit u licencuan deri në prill. Megjithatë, koha dhe procedurat për daljen nga tregu vazhdojnë të jenë të ngadalta. Në 2012-ën kërkesat për mbyllje vullnetare të biznesit u rritën me rreth 14% nga një vit më parë. Në tërësi, Shqipëria ka bërë përparime graduale në procedurat mirë-funksionuese të fillimit të biznesit. Procedurat për daljen nga tregu mbeten të ngadalta.

### *Sistemi juridik*

Në fushën e të drejtave të pronësisë është miratuar kuadri ligjor për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Megjithatë, regjistrimi fillestar i pronës nuk është përfunduar akoma. Përpjekje të tjera janë të nevojshme në fushën e kthimit dhe kompensimit dhe në legalizimin e ndërtimeve pa leje. Në prill janë miratuar disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile për lehtësimin e rikuperimit të kolateralit. Në 2012-ën janë rritur ndjeshëm rastet e rikuperimit të kolateralit, së bashku me numrin e zyrave të shërbimit përmbarrimor privat. Megjithatë, ndikimi i plotë i masave të reja ligjore mbetet ende për t'u vlerësuar. Në tërësi, ka pasur disa përparime në sistemin juridik, por duhet të garantohet zbatimi i duhur. Pasiguritë mbi pronësinë e pronave të paluajtshme, vonesat në procedurat gjyqësore dhe dobësitë në zbatimin e ligjit vazhdojnë të dëmtojnë mjedisin e biznesit.

### *Zhvillimi i sektorit financiar*

Sistemi financiar mbetet i dominuar nga sektori bankar që kontribuon me rreth 93.6% të të gjitha aktiveve të sistemit financiar dhe me 87.9% të PBB-së (3 pikë përqindjeje më lart se në 2011-ën). Mbizotëron kapitali i huaj dhe ka përqendrim të lartë, ku 5 bankat më të mëdha zotërojnë rreth 68% të portofolit të kredive dhe 74% të depozitave totale. Kredia totale për ekonominë është rreth 41% e PBB-së, çka do të thotë se ka mjaft hapësira për zhvillimin e ndërmjetësimit financiar. Rritja e kredisë ra në 7.4% në 2012-ën, nga 11.7% në 2011-ën, me rënie më të shpejtë në periudhën e fundit, duke bërë që rritja e kreditimit vjetor të jetë 1.6% në tremujorin e parë të 2013-ës dhe vetëm 0.7% në tremujorin e dytë.

Dobësimi i kreditimit, që godet si familjet ashtu edhe investitorët, pasqyron ashpërsimin e kërkesave të aplikuara prej bankave për shkak të rritjes së kredive të këqija dhe rënies së kërkesës për hua nisur nga pasiguritë ekonomike. Në përpjekje për t'i dhënë hov kreditimit, Banka e Shqipërisë miratoi ndryshime specifike rregullatore në mars, me qëllim çlirimin e burimeve financiare për bankat dhe kanalizimin e tyre drejt kreditimit të sektorit privat, por deri tani rritja e kreditimit nuk e ka marrë veten.

Në përgjithësi, sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet. Në 2012, rezultatet neto të sistemit bankar arritën vlerën 26.71 milion euro, çka pasqyron një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.

Koeficienti i mjaftueshmërisë së kapitalit është rritur në 16.7% në maj, nga 15.6% në fund të 2011-ës, ku të gjitha bankat qëndruan sipër nivelit minimal rregullator prej 12%. Raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra nga fundi i dhjetorit 2012 është rritur në nivelin 36.7%, duke tejkaluar ndjeshëm nivelin minimal të kërkuar prej 25%.

Depozitat kanë qenë burimi kryesor i financimit dhe linjat e kreditimit nga bankat mëmë kanë qenë më të ulëta se në fund të 2011-ës, duke forcuar rezistencën e sistemit bankar ndaj goditjeve të

jashtme. Megjithatë, është rritur rreziku i ekspozimit të bankave ndaj kredive të këqija, pasi përqindja e kredive me probleme u rrit në 2.4% në tremujorin e dytë të 2013, kundrejt 21.2% të një vit më parë. Kjo ka shkaktuar rritjen e provigjioneve për humbjet e kredive, me rritje në qershor me 24.3% mbi baza vjetore.

Totali i aktiviteteve të sektorit financiar jobankar ka qenë sa 2.8% e PBB-së. Në 2012-ën, tregu i sigurimeve i cili është 50% me kapital i huaj, ka rritur të ardhurat bruto nga primet në nivelin 9% në 2012, po si përqindje e PBB-së vazhdon të jetë i ulët.

Tregu i letrave me vlerë u fokusua në bonot e qeverisë dhe u krijuan dy fonde të reja investimi. Tregu i pensioneve vullnetare u rrit me 83% në 2012-ën nga një bazë shumë e ulët, por është ende në fazë të hershme zhvillimit.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar forcimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës. Ka miratuar rregulloret mbi parimet bazë të administrimit bankar dhe të degëve të bankave të huaja; për licencimin e institucioneve financiare jo-bankare; për menaxhimin e riskut të institucioneve financiare jo-bankare, si edhe instrumentet e pagesave elektronike.

*Në tërësi*, sektori bankar vazhdon të jetë i mirëkapitalizuar dhe me likuiditet. Megjithatë, niveli i lartë i kredive me probleme përbën shqetësim, ndërkohë që ngadalësimi i fortë i rritjes së kredisë e dëmton ekonominë.

### **3.2. Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së**

#### *Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale*

Shqipëria e ka ruajtur stabilitetin makroekonomik. Ngadalësimi ekonomik rezultoi në tkurrje të deficitit të llogarisë korrente, por imbalancat e jashtme janë ende të mëdha, gjë që pasqyron bazën prodhuese të ngushtë. Inflacioni i ulët pasqyron mungesën e presioneve inflacioniste si edhe pritshmëri inflacioni të mirankoruar. Politika fiskale mbetet e shtrënguar nga borxhi publik që është relativisht i lartë dhe në rritje, pjesa më e madhe e të cilit është afatshkurtër dhe kjo e rrit vulnerabilitetin. Planifikimi fiskal vazhdon të jetë i dobët dhe parashikueshmëria e tij është përkeqësuar pas shfuqizimit të tavanit të borxhit.

Pengesat strukturore përbëjnë pengesë për rritjen ekonomike. Pavarësisht disa përparimeve, dobësitë në të drejtat e pronës dhe zbatimin e ligjit vazhdojnë të dëmtojnë klimën e biznesit. Tregu i punës karakterizohet nga papunësi vazhdimisht e lartë. Procesi i privatizimeve ka avancuar, por ende nuk është përfunduar. Diversifikimi dhe konkurrueshmëria e ekonomisë janë ende në nivele të ulëta. *Në tërësi*, dhe pse janë bërë disa përparime në krijimin e një ekonomie tregu funksionale, Shqipëria duhet të konsolidojë financat publike dhe të ulë nivelin relativisht të lartë të borxhit publik, të forcojë më tej qeverisjen, të përmirësojë performancën e tregut të punës, të mbrojë të drejtat e pronës dhe të forcojë shtetin e së drejtës si edhe luftën kundër korrupsionit.

#### *Kapitali njerëzor dhe fizik*

Shpenzimet publike në arsim vlerësohet të ishin rreth 3,2% e PBB-së në 2012-ën dhe pritet të qëndrojnë të pandryshuara edhe në buxhetin 2013. Në arsimin e mesëm janë futur standarde dhe

programe të reja mësimore. Shpenzimet publike për kërkim-zhvillimin mbetën në nivele të ulëta, në 0.03% të PBB-së në vitin 2012 dhe 2013. Numri i laboratorëve shkencorë u rrit në 2012. Niveli i bashkëpunimit midis industrisë dhe universiteteve është i dobët.

Shpenzimet kapitale publike mbajtën barrën e rebalancimit të buxhetit dhe u tkurrën me 12.8% në 2012, duke përbërë vetëm 4.6% të PBB-së krahasuar me 5.4% në 2011. Parashikimi është që për vitin 2013, të përbëjnë 5% të PBB-së. Autoritetet përcaktuan arsimin, kujdesin shëndetësor, infrastrukturën dhe bujqësinë si fusha prioritare, por planet e shpenzimeve parashikojnë rënie të investimeve publike në këta sektorë në 2013. Infrastruktura rrugore mbetet sektori që përfiton më shumë investime publike. Sipas llogaritjeve, investimet totale në ekonomi ranë me rreth 5% në 2012 dhe u ulën si përqindje e PBB-së nga 32% në 29.3%.

Shqipëria vazhdon të ketë varësi të lartë nga burimet hidroenergjetike për të qenë në gjendje të garantojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Nuk ka pasur përparime në rritjen e kapacitetit të interkonjeksionit me vendet e tjera. Përgatitjet për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit me Kosovën rifilluan në janar. Shqipëria arriti të eksportojë energji elektrike në fillim të vitit 2013, për shkak të kushteve të favorshme të motit, por vazhdon të jetë importues neto i energjisë elektrike. Është rritur numri i koncesioneve të nënshkruara në sektorin energjetik, ndërkohë që Kontrolli i Lartë i Shtetit evidentoi disa parregullsi në procedurat e koncesionit.

*Në tërësi*, ekziston hapësirë e madhe për ri-orientimin e investimeve drejt fushave që nxitin rritjen ekonomike si telekomunikacioni dhe kapitali njerëzor, si edhe për fokusimin më të mirë të politikave për nxitjen e nismave të novacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet sektorit të arsimit dhe industrisë.

#### *Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve*

Ekonomia shqiptare vazhdon të mbizotërohet nga sektori i shërbimeve, me rreth 60% të vlerës së shtuar bruto (GVA) në 2012, i ndjekur nga bujqësia që dha rreth 1/5 të GVA dhe industria (11%) që përfshin si industrinë nxjerrëse edhe atë përpunuese. Industria përpunuese mbështetet më së shumti në industritë e tekstilit, fasonëve dhe lëkurës me vlerë të shtuar të ulët. Pas një kontraktimi të fortë me rreth 13% në 2012, kontributi i sektorit të ndërtimit në GVA ra në nën 9%. Bujqësia vazhdon të ofrojë një numër të madh vendesh pune (rreth 50%), çka sugjeron se ka ende hapësira të mëdha për rritjen e prodhueshmërisë nga zhvendosjet e punësimit ndërmjet sektorëve.

Struktura sektoriale e eksportit të mallrave mbeti tejet e përqendruar në 2012, ku 84% të eksporteve totale e përbënin mineralet, karburantet dhe energjia elektrike (36%), tekstilet dhe veshjet e këmbës (29%) dhe materialet e ndërtimit dhe metalet (19%). Mineralet, karburantet dhe sektori i energjisë elektrike rritën shitjet me jashtë me rreth 31% kundrejt 2011.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) luajnë rol të rëndësishëm në ekonomi, duke përbërë 71% të punësimit zyrtar, megjithëse vazhdon të ketë dobësi në mjedisin e funksionimit të tyre. Në sektorin jobujqësor, NVM-të japin 47% të eksporteve dhe 68% të vlerës së shtuar.

Sektori i energjisë elektrike vazhdon të ketë dobësi të mëdha, si: mungesa e rentabilitetit financiar, nivelet e larta të humbjeve në rrjetin e energjisë dhe të shpërndarjes, norma të ulëta arkëtimi dhe tarifa nën nivelin e rikuperimit të kostos. Varësia ndaj energjisë hidrike vazhdon të përbëjë rrezik substancial për furnizimin me energji elektrike të vendit.

Sektori informal i konsiderueshëm vazhdon të jetë problem substancial dhe i dëmshëm për klimën e biznesit. Është rritur numri i pajisjeve fiskale (kasave) të instaluara nga bizneset, por duhet të forcohet sistemi i monitorimit të përdorimit të tyre në praktikë. Është rritur numri i rasteve të dyshuara të korrupsionit të denoncuara në prokurori nga njësitë e hetimit doganor dhe tatimor. Në tërësi, struktura e ekonomisë mbeti i pandryshuar. Baza prodhuese e Shqipërisë nuk ka diversifikim, për sa i përket sektorëve dhe tregjeve të eksportit, duke e lënë ekonominë të cënueshme nga tronditjet specifike të industrisë. Vazhdojnë keqfunksionimet në sektorin e energjisë elektrike. Përmasat e sektorit informal mbeten sfidë.

#### *Ndikimi i Shtetit në konkurrueshmëri*

Raporti i ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u rrit në 1.6% në 2012, nga 1.3% në vitin pararendës, me më pak ndihmë horizontale shtrebnëruese (d.m.th. jo specifike për disa sektorë) si pjesë e totalit të ndihmës shtetërore të dhënë. Ashtu si në vitin pararendës, qeveria i dha një garanci bankare shoqërisë shtetërore KESH për ta ndihmuar t'iu bëjë ballë vështirësive financiare në fund të vitit 2012 dhe në fillim të 2013. Problemet e pazgjdhura të sektorit të energjisë elektrike po i bjerrin vazhdimisht burimet publike.

#### *Integrimi ekonomik me BE-në*

Hapja e ekonomisë shqiptare ndaj tregjeve u ul disi në 2012-ën, sepse shumata e totalit të importeve dhe eksporteve përbënte 87% të PBB-së kundrejt 92% në 2011, kryesisht për shkak të tkurrjes së eksporteve prej ngadalësimit të ekonomisë. BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Eksportet e mallrave drejt BE-së u rritën me 13.4% kundrejt 2011, duke zënë rreth 75% të eksportit të përgjithshëm të mallrave, ndërsa importi i mallrave nga BE-ja ra me 5.1% duke përbërë 62% të totalit të importeve. Nga janari në korrik, vazhdoi trendi i ngushtimit të deficitit tregtar me BE-në, pasi eksporti i mallrave drejt BE-së u rrit me 18.8% kundrejt vitit pararendës, ndërsa në po të njëjtën periudhë, importi i mallrave nga BE-ja pësoi rënie të lehtë. Italia mbetet partneri tregtar më i rëndësishëm, duke tërhequr mbi gjysmën e eksportit të mallrave shqiptare dhe duke përbërë 1/3 e totalit të importeve në Shqipëri. BE-ja mbetet burimi kryesor i investimeve në Shqipëri, megjithëse përqindja e BE-së në stokun e përgjithshëm të IHD-ve ka pësuar rënie në katër vitet e fundit. Rritja e tregtisë me vendet CEFTA pësoi ngadalësim, nga 27% në 2011 në rreth 3% në 2012, duke pasqyruar uljen e përgjithshme të rritjes së aktivitetit ekonomik në rajon. Vendet CEFTA marrin 13% të eksportit të mallrave shqiptare dhe përbëjnë 8% të importeve në Shqipëri.

Trendi pozitiv në eksportet neto u mbështet nga ndryshimet e fundit në kursin efektiv të këmbimit (REER), me zhvlerësimin e moderuar të lekut si në tremujorin e fundit të 2012 (me 0.91%) edhe në tremujorin e parë të 2013 (me 0.55%). Në tërësi, BE-ja vazhdoi të jetë partneri kryesor tregtar dhe i investimeve në Shqipëri. Ritmi i integritit tregtar me vendet CEFTA pësoi ngadalësim.

#### **4. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT**

Ky seksion analizon aftësinë e Shqipërisë të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, që do të thotë ato të *acquis* siç shprehet në Traktate, në legjislacionin dytësor dhe në politikat e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, analizon kapacitetet administrative të Shqipërisë për të zbatuar *acquis*. Analiza është strukturuar sipas 33 kapitujve të *acquis*. Në çdo fushë, Komisioni vlerëson

përparimin e arritur gjatë periudhës raportuese dhe bën një përmbledhje të nivelit të përgjithshëm të përgatitjeve.

#### 4.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Në fushën e **masave horizontale**, Shqipëria ka nivel të mirë përgatitjeje.

Në fushën e *standardizimit*, vazhdoi miratimi i Standardeve Evropiane (EN) dhe Shqipëria miratoi edhe 1158 të tillë, shumica me metodën e “faqes së parë” pa përkthim.

Në mars, Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) u bë anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI). Është ngritur një komision teknik për sistemet e komunikimit analog dhe numerik, por standardet e ETSI-t ende nuk janë miratuar. DPS e ka përmirësuar databazën ku bëhet regjistrimi dhe përditësimi i standardeve të publikuara. Ende nuk ka një strategji kombëtare për standardizimin.

Në fushën e *vlerësimit të konformitetit*, janë miratuar rregullore teknike për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit për pajisjet mjekësore.

Struktura e re organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) u miratua në tetor 2012. Numri i trupave të akredituar për vlerësimin e konformitetit u rrit në 24. U akredituan laboratorë që kryejnë teste të ajrit, ujit dhe zhurmave, si edhe laboratorë që testojnë matësit elektrikë. Laboratori që analizon pompat e karburanteve në fushën e metrologjisë ligjore ka aplikuar për akreditim. DPA miratoi një dokument politikash të ri për gjurmueshmërinë, me udhëzime për zbatimin, me synimin që të plotësojë parakushtet për anëtarësimin e plotë në Bashkëpunimin Evropian për Akreditimin (EA). Shqipëria ende nuk është anëtare me të drejta të plota e EA-së. Miratimi i projektligjit për Akreditimin e Trupave të Vlerësimit të Konformitetit - që synon të përafrojë legjislacionin me *acquis* - ka mbetur pezull.

Drejtorja e Përgjithshme e *Metrologjisë* (DPM) miratoi një strategji komunikimi për metrologjinë në shtator 2012. DPM u zhvendos në ambientet e reja dhe laboratorët u pajisën me pajisje të reja për presionin, lagështinë dhe vëllimin. Kapacitetet kalibruese dhe matëse të DPM-së u pranuan për matje të masave në Databazën Krahasimore të Byrosë Ndërkombëtare për Peshat dhe Matjet. Shqipëria e përafroi legjislacionin me Direktivën për Instrumentet Matëse Joautomatike. Ende nuk është bërë përafrimi me Direktivën e Instrumenteve Matës, ndërsa përafrimi i Ligjit për Metrologjinë me *acquis* është në fazë të hershme.

Janë miratuar aktet nënligjore të Ligjit për Inspektimet dhe të Ligjit për Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut. Janë hartuar procedurat standarde të punës për mbikëqyrjen e tregut për zbatimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore. Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut ende nuk është funksional.

Për sa i përket **legjislacionit të produkteve të “Përqsjes së Vjetër”**, në fushën e plehrave kimike është miratuar legjislacioni për kërkesat e prodhimit, etiketimin, ambalazhimit, procedurat e hyrjes në treg dhe kriteret për ngritjen e laboratorëve të referencës për analiza.

Në fushën e **legjislacionit të produkteve të “Përqasjes së Re dhe Globale”**, janë miratuar rregulloret për etiketimin energjetik të pajisjeve shtëpiake dhe për sigurinë e lodrave, të përafuara me *acquis*.

Në fushën e **masave procedurale**, legjislacioni për kthimin e objekteve kulturore ende nuk është miratuar. Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me armët e zjarrit.

### *Përfundim*

Janë bërë disa përpertime në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, sidomos për standardizimin. Nevojitet mbikëqyrje efektive e tregut dhe kërkohen përpjekje të mëtejshme për ta përafuar legjislacionin me *acquis*. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

## **4.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve**

Për sa i përket **aksesit në tregun e punës**, në mars u miratuan ndryshimet në ligjin “Për të huajt”, që synojnë të lehtësojnë aksesin e qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës dhe të garantojnë trajtimin e barabartë.

Krijimi i portalit elektronik që përfshin databazat për punëkërkuesit dhe punëdhënësit e regjistruar në 12 zyrat rajonale të punësimit dhe 24 zyrat vendore të punësimit shënon përpertime në funksion të pjesëmarrjes në të ardhmen në rrjetin EURES (Shërbimet Evropiane të Punësimit).

Për sa i përket **koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore**, kanë vazhduar negociatat për marrëveshje dypalëshe me Hungarinë, Republikën Çeke, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Rumaninë. Kanë nisur negociatat me Luksemburgun.

*Përfundim* Janë bërë disa përpertime në fushën e lirisë së lëvizjes të punëtorëve, konkretisht në përmirësimin e aksesit të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës. Në tërësi, përgatitjet në fushën e lirisë së lëvizjes së punëtorëve janë në një fazë të hershme.

## **4.3. Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime**

Në fushën e të **drejtës së vendosjes**, janë bërë hapa në lidhje me përgatitjet për thjeshtësimin e procedurave dhe shkurtimin e procesit të marrjes së lejeve të ndërtimit.

Për sa i përket **lirisë së ofrimit të shërbimeve ndërkufitare**, është ngritur një grup pune ndërministror dhe në prill është miratuar udhërrëfyese për përafrimin e legjislacionit për shërbimet ndërkufitare me Direktivën e Shërbimeve. Për sa i përket Direktivës së Shërbimeve, duhet të fuqizohen kapacitetet njerëzve të institucioneve përgjegjëse.

Në fushën e **shërbimeve postare**, Strategjia Kombëtare e Shërbimit Postar u miratua në korrik. Liberalizimi i shërbimeve postare avancoi me reduktimin e zonës së rezervuar postare nga 100 g. në 50 gr. në gusht. Finalizimi i Projektligjit për Postën, që përcakton tarifat dhe peshat, si edhe struktura e re organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare kanë mbetur pezull.



Në fushën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**, janë miratuar akte nënligjore që heqin detyrimin e dhënies së provimit shtetëror për personat e profesioneve të rregulluara, të cilët kanë marrë me sukses provimin shtetëror në një nga shtetet anëtare të BE-së, vendet EFTA, SHBA ose në një sërë vendesh të tjera. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për ta përafuar plotësisht me *acquis* legjislacionin për profesionet e rregulluara.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përpjekje në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, veçanërisht në shërbimet postare. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për ta përafuar legjislacionin në këtë fushë me *acquis* përkatëse. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### **4.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit**

Në fushën e **lëvizjes së kapitalit dhe pagesave**, ende nuk janë hequr kufizimet për blerjen e pronës së paluajtshme nga të huajt.

Ligji për **Sistemin e Pagesave** u miratua në prill me qëllim liberalizimin e tregut dhe sigurimin e stabilitetit dhe efijencës. U miratuan disa ndryshime në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile për ta bërë më të lehtë ekzekutimin e kolateralit. Ligji për Barrët Siguruese u ndryshua në prill. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve që kalojnë përmes Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare u rritën përkatësisht me 2.4% dhe 65% në 2012 dhe ky trend vazhdoi edhe në tremujorin e parë të 2013. Për sa i përket Sistemit të Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH), vëllimi i pagesave ra me 7%, ndërsa vlera e transaksioneve përmes këtij sistemi u rrit me 5% në 2012 dhe në gjysmën e parë të 2013. Ministria e Financave vazhdon të jetë përdoruesi kryesor i klerimit të pagesave.

Për sa i përket **luftës kundër pastrimit të parasë**, janë miratuar aktet nënligjore të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, që është ndryshuar më herët në 2012. Janë miratuar udhëzimet për metodat dhe procedurat e raportimit, përfshi raportimin nga ushtruesit e profesioneve të lira jofinanciare. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parasë i ka forcuar kapacitetet me punësimin e tre specialistëve shtesë, duke arritur totalin e 28 punonjësve. Kjo Drejtoria ka vazhduar të japë trajnime për stafin e vet dhe institucione të tjera si banka, pika këmbimi valutor, noterë, shoqëri ndërtimi, ekspertë kontabël, avokatë dhe tregtarë automjetesh. Numri i inspektimeve të kryera që nga fundi i vitit 2012 ishte 347, nga të cilat 18% ishin inspektime në vend, kryesisht në pika këmbimi valutor dhe sheshe ndërtimi. Janë marrë 22 masa administrative, por vetëm 30% e gjobave janë arkëtuar, pasi vendimet e tjera u ankimuan në gjykatë. Ky trend vazhdoi edhe në gjysmën e parë të 2013, me 139 inspektime dhe 13 masa administrative, nga të cilat janë arkëtuar 38%. Janë raportuar 556 raste transaksionesh të dyshimta në 2012, ose 44% më shumë se në 2011. Për herë të parë kanë dorëzuar raporte transaksionesh të dyshimta edhe shoqëritë e lisingut dhe avokatët. Rreth 36% e rasteve i janë përcjellë ose prokurorisë, ose policisë. Shumica e raportimeve kanë ardhur nga bankat ose nga zyrat e transfertave dhe këmbimit të parasë. Ka pasur rritje të ndjeshme të numrit të raportimeve nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përparime në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, me miratimin e Ligjit për Sistemet e Pagesave si edhe me masat e mëtejshme legislative dhe masat raportuese që janë marrë në luftën kundër pastrimit të parasë. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### 4.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik

Për sa i përket **parimeve të përgjithshme**, janë bërë përmirësime në sistemin e ankimimit të prokurimeve publike si edhe është miratuar legjislacioni për koncesionet.

Në fushën e **dhënies së kontratave publike**, Ligji për Prokurimin Publik u ndryshua në dhjetor për ta përafuar më tej me *acquis*. Ai përfshin dispozita për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, furnizimit dhe shërbimeve, dhe tani mbulon edhe sektorin utilitar. Aktet nënligjore të miratuara në gjysmën e parë të 2013 përcaktojnë procedurat e prokurimit publik, përkufizimet e blerjeve të vogla dhe ofertave anormale, si edhe procedurat që duhet të ndiqen nga autoritet kontraktuese. Gjobat dhe ndëshkimet administrative për shkeljet e ligjit janë ri-përkufizuar, me qëllim që t'iu jepet më shumë përgjegjësi anëtarëve të komisioneve të tenderëve. Numri i prokurimeve me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është rritur lehtë në 2012, duke përbërë 26.4% të të gjitha procedurave dhe 14% të vlerës totale të tenderëve. Ky trend vazhdoi edhe gjatë gjysmës së parë të 2013. Kjo rritje i atribuohet vonesave në lëvrimin e fondeve të prokurimit të autoritetet kontraktuese, si edhe afateve të ngjeshura dhe planifikimit të dobët.

I rëndësishëm ishte miratimi i Ligjit të ri për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në prill, i ndjekur nga miratimi i akteve nënligjore dhe i një strategjie për koncesionet në qershor. Koncesionet për hidrocentralet u përjashtuan nga ligji për një periudhë kalimtare prej katër vitesh.

Agjencia e Prokurimit Publik mori masa të mëtejshme për të garantuar transparencën e procedurave të prokurimit publik. Prokurimi elektronik vazhdoi të funksionojë mirë. Aktet nënligjore për prokurimin elektronik u ndryshuan për ta shtrirë fushën e veprimit në kontratat mbi 72 euro dhe për t'ua kufizuar autoriteteve kontraktuese hapësirën për interpretim. Numri i masave disiplinore të marra nga agjencia ndaj autoriteteve kontraktuese u rrit nga 27 në 55 dhe numri i vërejtjeve nga 3 në 15 gjatë vitit 2012 kundrejt 2011, ndërsa numri i gjobave ra nga 40 në 29. Në gjysmën e parë të 2013, u vendosën 26 masa disiplinore dhe tetë gjoba. Gjysma e këtyre rasteve janë ekzekutuar nga agjencia pas raporteve përkatëse të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Agjencia filloi të ushtrojë monitorim më tërësor të procedurave të prokurimit. Prokurimet publike dhe koncesionet janë akoma sektori ku institucioni i auditit ka gjetur më shumë shkelje financiare. Në mars, KLSH raportoi se shkeljet e autoriteteve qendrore dhe vendore në fushën e prokurimeve publike i kanë shkaktuar shtetit një dëm prej 3.1 milion euro gjatë periudhës 2008-2011. Agjencia ka vazhduar masat sensibilizuese dhe trajnimet mbi ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik. Stafi i saj u rrit nga 20 në 23, përfshi këtu punësimin e dy specialistëve që merren me koncesionet. Kapacitetet e Agjencisë dhe të autoriteteve kontraktuese duhet të forcohen për të garantuar zbatim efektiv të legjislacionit të miratuar rishtas.

Në fushën e **masave korrigjuese**, ndryshimet në Ligjin për Prokurimin Publik e shfuqizuan zyrën e Avokatit të Prokurimit Publik, duke e lënë Komisionin e Prokurimit Publik të trajtojë dhe të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë. Kjo ka ndihmuar në qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe pritet të standardizojë procedurat. Kapacitetet administrative u forcuan nga 18 në 20 punonjës. Komisioni mori 270 ankesa dhe mori 214 vendime. Pavarësia e tij profesionale duhet të garantohet.

## *Përfundim*

Ka pasur përparim të mirë në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me *acquis*, për prokurimin publik, koncesionet dhe partneritet publik privat. Mekanizmat e shqyrtimit të ankesave janë standardizuar. Nevojitet punë e mëtejshme për të përmirësuar profesionalizmin e autoriteteve kontraktuese dhe për të pakësuar shkeljet financiare në këtë sektor. Në tërësi, përgatitjet në fushën e prokurimit publik anë avancuar në masë të moderuar.

### **4.6. Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare**

Në fushën e **të drejtës së shoqërive tregtare**, Ligji për Bashkimet Ndërkufitare të Shoqërive Tregtare i përafrohet me *acquis* u miratua në nëntor. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka zbatuar ligjin në lidhje me regjistrimin e shoqërive me pronësi private. Përgatitjet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* për sa i përket kërkesave të raportimit dhe dokumentacionit për bashkimet dhe ndarjet e shoqërive janë në rrugën e duhur.

Janë bërë disa përparime për sa i përket ngritjes së infrastrukturës teknike për nënshkrimin elektronik. Në janar, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit u akreditua nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik që t'i lëshojë administratës publike certifikata që mundësojnë përpunimin e dokumenteve elektronike duke filluar nga shtatori. Po përgatitet aplikacioni i parë që do të përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Është në proces licencimi i një operatori të dytë privat që ofron certifikim elektronik. Numri i bizneseve që kanë marrë certifikim elektronik ka shkuar në rreth 500. Aplikimi i nënshkrimit elektronik nga autoritetet shtetërore mbetet për t'u verifikuar.

Në fushën e **kontabilitetit**, kanë filluar përgatitjet për përafrimin e legjislacionit mbi kontabilitetin dhe standardet kombëtare të kontabilitetit me *acquis*. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit e ka shtuar punën për të forcuar kapacitetet me trajnime të stafit dhe hartimin e një sërë rregulloresh të brendshme. Anëtarësia e bordit të Këshillit ndryshoi në maj.

Në fushën e **auditimit**, Bordi i Mbikëqyrjes Publike vazhdoi aktivitetin e tij monitorues dhe u përfshi në një shqyrtim direkt të cilësisë së auditimit të ndërmarrjeve me interes publik. Udhërrëfyesi i reformës në fushën e kontabilitetit dhe auditimit për periudhën 2013-2015 u miratua në gusht. Pavarësia e Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe financimi i tij mbeten për t'u adresuar në kuadër të reformës.

## *Përfundim*

Janë bërë disa përparime në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare, me miratimin e legjislacionit për bashkimet ndërkufitare. Disa përparime janë bërë edhe në fushat e kontabilitetit dhe auditimit, por legjislacioni duhet të përafrohet me *acquis*. Bordi i Mbikëqyrjes Publike duhet të forcohet. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### 4.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

Në fushën e **të drejtës së autorit dhe të drejtave që lidhen me të**, ligji i ri “Për të drejtën e autorit” nuk është miratuar ende. Janë miratuar disa ndryshime në ligjin aktual “Për të drejtën e autorit”, përfshi rritjen e kufijve të gjobave administrative për shkeljet e së drejtës së autorit, si edhe është përkufizuar statusi juridik i agjencive të menaxhimit kolektiv.

Në fushën e **të drejtave të pronësisë industriale**, Ligji për Pronësinë Industriale u ndryshua në shkurt për ngritjen e Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut që nuk është krijuar ende. Miratimi i ndryshimeve të mëtejshme të ligjit ka mbetur pezull. Në prill, Shqipëria miratoi Ligjin për aderimin në Marrëveshjen e Londrës për Zbatimin e Nenit 65 të Konventës për Patentat Evropiane. Legjislacioni shqiptar ende nuk është i përafëruar me *acquis* për sa i përket mbrojtjes së topografive të qarqeve të integruara.

Për sa i përket **ekzekutimit**, norma e arkëtimit të gjobave për shkelje të së drejtës së autorit mbetet shumë e ulët. Raportohet se nuk u janë paguar komisionet mjaft mbajtësve të të drejtave. Grupi Ndërinstitucional i Monitorimit i ngritur për të zbatuar Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale ka zhvilluar vetëm një mbledhje. Në mars, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave miratoi strategjinë e vet sektoriale për të drejtat e pronësisë intelektuale. Ajo miratoi më shumë kërkesa për marrjen e masave në mbrojtje të markave tregtare ndaj falsifikimit, piraterisë dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të pronësisë intelektuale në 2012 kundrejt 2011, dhe numri ishte edhe më i madh në 2013. Megjithatë, produktet e falsifikuara janë ende të pranishme në treg (*Shih Kapitullin 29 – Bashkimi doganor*). Bizneset ankohen për zbatim të dobët të legjislacionit për të drejtat e pronësisë intelektuale. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) rekomandoi pezullimin e licencave për dy agjenci të menaxhimit kolektiv sepse nuk kanë respektuar detyrimet. Qeveria ende nuk ka marrë vendim. Janë përmirësuar kapacitetet administrative, kryesisht përmes trajnimit të stafit të ZSHDA-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DSHPM). Problemet e supozuara në menaxhimin e ZSHDA çuan në dorëheqjen ose zëvendësimin e punonjësve kryesorë të institucionit. DSHPM hartoi një manual për rastet e shkeljes së pronësisë intelektuale dhe e përmirësojë sistemin e vet TI. Janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe trajnime me mbajtësit e të drejtave, gjyqtarët, nëpunësit tatimorë dhe doganorë, akademikët, policinë dhe nëpunës të prokurorisë. Niveli i njohurive dhe ndërgjegjësimit për dispozitat juridike për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, sidomos për sistemet e menaxhimit kolektiv, vazhdon të jetë i ulët, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët.

##### *Përfundime*

Pak përparim është bërë në fushën e pronësisë intelektuale. Janë bërë hapa për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të të drejtave të pronësisë industriale me *acquis*. Ligji për të Drejtat e Autorit duhet të miratohet. Nevojiten përpjekje për garantimin efektiv të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale, si dhe për ngritjen e Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut. Duhet të zgjidhen mangësitë e theksuara në pagimin e komisioneve për mbajtësit e të drejtave. Shqipëria nuk i ka përmbushur detyrimet e saj në kuadrin e MSA-së. Në tërësi, përgatitjet nuk kanë avancuar shumë.

#### 4.8. Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Në fushën **antikartel dhe bashkimet**, Autoriteti i Konkurrencës (AK) miratoi pesë akte nënligjore, të përafuara me *acquis*. Në shtator 2012, AK pothuaj e përgjysmoi tarifën e depozitimit të akteve për bizneset e vogla me xhiro vjetore nga 1,4 milion deri në 7.1 milion Euro.

Autoriteti miratoi gjashtë vendime për marrëveshjet e ndaluara dhe dy për abuzim me pozitën dominuese, si edhe autorizoi 14 bashkime dhe përthithje. AK mori 19 ankesa, pesë më tepër sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar, për shkak se është rritur niveli i ekzekutimit dhe ndërgjegjësimit.

AK-ja përfundoi hetimet në fushën e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për palët e treta dhe gjobiti tetë shoqëri sigurimesh për fiksime të çmimeve të tregut. Pas kryerjes së hetimeve, AK-ja doli në përfundimin se nuk është kufizuar konkurrenca në transportin detar në portin e Vlorës, në importet e sheqerit e orizit, si edhe në tregtimin e vajit vegjetal. Gjithashtu, AK-ja nisi një hetim të thelluar për abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese në tregun e vajrave, çimentos, telefonisë celulare dhe shërbimeve të transportit rrugor në Tiranë.

Autoriteti e rriti numrin e gjobave nga një në 2011, në shtatë në 2012; po kështu edhe numrin e vendimeve të dhëna nga 43 në 2011 në 48 në 2012. Për sa i përket çështjeve të ankimuar, AK-ja fitoi 15 nga 26 çështjet e ankimuar në Gjykatën e Shkallës së Parë si edhe 11 nga 18 që shkuan në Gjykatën e Apelit në 2012. Në gjysmën e parë të 2013, AK-ja fitoi dy dhe humbi një çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë. Shumë vendime gjyqësore ende nuk janë marrë, çka ka rezultuar në vonesa të konsiderueshme në arkëtimin e 73% të gjobave të vëna. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të shtuar njohuritë e gjyqësorit mbi legjislacionin në fushën e konkurrencës.

Struktura e re e AK-së pret miratimin në parlament. Kapacitetet administrative u forcuan me punësimin e dy specialistëve, duke e çuar numrin e punonjësve në 36, nga të cilët 24 janë specialistë. Nëpunësit e AK-së janë trajnuar në fusha të ndryshme të legjislacionit të konkurrencës. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të shtuar njohuritë e nëpunësve mbi analizën ekonometrike dhe përdorimin e TIK-ut.

Për sa i përket **ndihmës shtetërore**, në vitin 2012 u dhanë si ndihmë shtetërore 15.34 milion euro, ose 30% më shumë se në 2011. Në shtator 2012, Komisioni i Ndhmës Shtetërore autorizoi një skemë ndihme "de minimis" për një periudhë 3-vjeçare për krijimin e një fondi të novacionit. Komisioni shqyrtoi aktin normativ të dhjetorit 2011 në lidhje me huan bankare që iu dha KESH-it dhe konkludoi në shtator 2012 se kjo masë nuk përbënte ndihmë shtetërore. Numri i njoftimeve nga qeveria mbetet shumë i ulët, dhe nuk ka pasur njoftime nga autoritetet rajonale dhe vendore. Raporti i Ndhmës Shtetërore 2012 u miratua në korrik. Sektorit të Ndhmës Shtetërore pranë Ministrisë së Ekonomisë ende i mungojnë kapacitetet e nevojshme administrative për imponimin e rregullave të ndihmës shtetërore.

Disa përparime janë bërë në plotësimin e akteve nënligjore për kontrollin e ndihmës shtetërore, për ta sjellë në përputhje me *acquis*. Nuk ka përparim në konfirmimin e pavarësisë operationale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore dhe të Sektorit të Ndhmës Shtetërore.

## *Përfundim*

Shqipëria ka bërë përparim të kufizuar në fushën e konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës e përmirësoi performancën e përgjithshme dhe i forcoi kapacitetet administrative. Pavarësia dhe kapacitetet administrative të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe Sektorit të Ndihmës Shtetërore duhet të forcohen. Në tërësi, përgatitjet për rishikimin e legjislacionit për ndihmën shtetërore janë në një fazë të hershme.

### **4.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare**

Në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**, Banka e Shqipërisë (BSH) miratoi në nëntor rregulloren mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre. Në janar u miratua rregullorja për instrumentet elektronike të pagesave dhe në korrik u miratua rregullorja për mjaftueshmërinë e kapitalit, për administrimin e rrezikut të kredisë si edhe për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Në mars, BSH miratoi strategjinë e re 2013-2015 që parashikon mbikëqyrje bankare në përputhje me parimet e Bazel I, II dhe III si edhe me Direktivat e BE-së. Departamenti i Mbikëqyrjes i BSH-së forcoi kapacitetet me punësimin e tre specialistëve. Katër nga 50 pozicione pune mbeten vakante.

Për sa i përket fushës së **sektorit jobankar**, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) miratoi në dhjetor akte për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jobankare dhe për licencimin dhe ushtrimin e aktiviteteve të tyre, si edhe për organizimin dhe funksionimin e platformës shumëpalëshe të tregtimit. Numri i institucioneve jobankare mbeti 21. Kapacitetet administrative të AMF-së u forcuan lehtë me rekrutimin e dy punonjësve duke e çuar numrin e stafit në 52. Nevojitet të garantohet pavarësia e tij operacionale dhe financiare.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve të punës**, Autoriteti i Konkurrencës miratoi në mars një rregullore për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke promovuar vendosjen e çmimeve të primeve të sigurimeve mbi baza individuale. Në korrik u miratuan ndryshimet në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit, ndërsa Ligji për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit ende nuk është miratuar. Tregu i sigurimeve mbetet i vogël. Sigurimet e jo-jetës vazhduan të dominojnë tregun e sigurimeve dhe raporti i dëmshpërblimeve kundrejt primeve është ulur në 34.6% në gjysmën e parë të 2013, krahasuar me 37% në të njëjtën periudhë të 2012. Shumica e kërkesave për dëmshpërblim kanë qenë për sigurimin e mjeteve motorike. AMF licençoi disa agjentë në tregun e sigurimeve jo-jetës. Në shtator u miratuan rregullore për dispozitat teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, si edhe për përlllogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit vullnetar dhe afatet e publikimit të informacionit. AMF mori masa të mëtejshme për ndalimin e përdorimit të lirë të aktiveve të shoqërive të sigurimit. Databaza e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike është plotësisht funksionale. Është instaluar edhe një sistem i gjobave elektronike.

Për sa i përket **infrastrukturës së tregut financiar**, ligji “Për sistemet e pagesave” u miratua në prill dhe një rregullore për licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë u miratua në qershor.

Në fushën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit**, AMF mori masa për të forcuar mbikëqyrjen dhe menaxhimin e tregut të letrave me vlerë dhe sipërmarrjet kolektive të investimeve.

Numri i operatorëve të licencuar në tregun e letrave me vlerë u rrit në 10. Në fushën e shërbimeve të investimit, AMF miratoi një vendim për ngritjen e një fondi kompensimi për shoqëritë e sigurimit në 2013. Gjithashtu, u licencua një fond i ri investimesh, që përbën një alternativë investimi në monedhë të huaj. AMF miratoi prospektusin për lëshimin e bonove të ofruara përmes alokimit direkt.

### *Përfundim*

Janë bërë disa përparime në shërbimet financiare, në fushën e bankave. Nevojiten përpjekje shtesë për përafrimin e legjislacionit me *acquis* në fushat e sigurimit dhe pensioneve të punës, infrastrukturës së tregut financiar, tregut të investimeve dhe shërbimeve të investimit. Kapacitetet mbikëqyrëse duhet të forcohen. *Në tërësi*, përgatitjen kanë avancuar në masë të moderuar.

## **4.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media**

Përafrimi në fushën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK)** ka avancuar; ndryshimet në Ligjin për Komunikimet Elektronike u miratuan në tetor 2012. Konkurrenca është rritur me uljen e tarifave që shoqëritë paguajnë për të zhvilluar aktivitetin tregtar. Agjencia për Komunikimet Elektronike dhe Postare (AKEP) përfundoi raundin e tretë të uljes së tarifave për rrjetet celulare. Përparim i mëtejshëm është bërë në zbatimin e garancive për konkurrencën: mbartja (portabiliteti) i numrave fiks u fut në shtator 2012 dhe në fillim të 2013 AKEP publikoi ofertën referencë me shumicë për aksesin me brez të gjerë. Në fund të 2012 u dha licenca e tretë UMTS/3G.

Projektligji “Për të drejtën e kalimit” pret të miratohet në parlament. Numri i emergjencave 112 nuk është vendosur për shkak të mungesës së fondeve për krijimin e një modeli të integruar për numrin 112 dhe pikat e përgjigjes ndaj publikut. Kapacitetet administrative dhe burimet e AKEP-it mbeten të dobëta.

Përdorimi i celularit është në nivele të larta, me penetrimin e abonimeve deri në 119% në korrik, ndërsa brezi i gjerë celular është në fazën fillestare të zhvillimit. Penetrimi i telefonisë fikse dhe brezit të gjerë është ndër më të ulët në rajon. Penetrimi i brezit të gjerë fiks për popullatën arriti

7.6% sipas të dhënave të fundit.

Në fushën e **shërbimeve të shoqërisë së informacionit**, infrastruktura e rrjetit GovNet është zgjeruar dhe është krijuar infrastruktura “*public key*” që mundëson komunikim të besuar ndërmjet sistemeve dhe përdoruesve shtetërore. Janë miratuar ndryshime në Ligjin për Tregtinë Elektronike për ta përafuar më tej me Direktivën e Tregtisë Elektronike. Ka avancuar përafrimi me *acquis* në aksesin e kushtëzuar, me miratimin e ligjit për shërbimet mediatike audiovizuale në mars 2013. Plani kombëtar për brezin e gjerë u miratua në maj. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit i ka përmirësuar kapacitetet teknike duke krijuar një databazë publike dhe një portal *e-government* si edhe një platformë interoperabiliteti që ndihmon në ofrimin e shërbimeve *e-government* për qytetarët dhe bizneset. Menaxhimi i identitetit elektronik për bizneset ende nuk është standardizuar, por është i ndryshëm për çdo shërbim elektronik (p.sh. prokurimet, tatimet), duke penguar kështu zhvillimin e shërbimeve elektronike.

Në fushën e **politikës audiovizive**, në mars u miratua Ligji për Shërbimet e Medias Audiovizive që synon përafrimin e kuadrit ligjor të medias me *acquis*. Procedura e emërimit të anëtarëve të autoritetit rregullator të medias, Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA), që është e parashikuar në ligj, nuk garanton plotësisht pavarësinë e tyre. Zbatimi i strategjisë për kalimin në transmetim numerik ka ndaluar, për shkak të një padie gjyqësore të operatorëve transmetues. Duhet të bëhen përpjekje për të mundësuar zbatimin në kohë të strategjisë për kalimin në transmetimin numerik, që planifikohet të përfundonte në qershor 2015. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të çliruar frekuencat që përdoren në mënyrë të paligjshme. AMA-s vazhdon të mos ketë kapacitete të mjaftueshme dhe ka ende shqetësime për pavarësinë e saj. Pavarësia editoriale e transmetuesit publik dhe sistemi i arkëtimit të tarifës nuk janë përmirësuar.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përparime në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias, sidomos me përafrimin e legjislacionit për shërbimet e medias audiovizive dhe komunikimet elektronike me *acquis*, si edhe me forcimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike. Pasiguria juridike mbi regjimin e të drejtës së kalimit vazhdon të ekzistojë. Pavarësia e medias dhe e autoritetit të saj rregullator vazhdojnë të ngjallin shqetësime, ndërkohë që kalimi në transmetimin numerik është vonuar edhe më shumë, duke vënë në rrezik zbatimin në afat të procesit. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### **4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural**

Për sa i përket **çështjeve horizontale**, qeveria akordoi rreth 6.8 milion euro në 2013 për mbështetjen e drejtpërdrejtë dhe skemat kombëtare të investimit në bujqësi dhe agropërpunim. Prodhimi bujqësor në 2012 pati rritje të lehtë, kryesisht për shkak të përmirësimit të prodhimit të frutorëve dhe ullinjve. Rritja i atribuohet pjesërisht edhe skemave të mbështetjes së drejtpërdrejtë



të qeverisë, të cilat nxitën mbjelljen e pemëve të reja. Eksportet patën rritje, ndërsa bilanci tregtar u përmirësua fare lehtë. Nuk ka pasur përparim në statistikat bujqësore. INSTAT është përgjegjës për statistikat bujqësore që në fillim të 2013. Censusi për Njësitë Ekonomike Bujqësore u realizua në tetor 2012. Sipas rezultateve paraprake, numri total i njësive ekonomike bujqësore është 324 013, krahasuar me 350 654 në 2010. Numri i njësive që mbajnë gjë të gjallë ra nga 84% në 2010, në 71% në 2012. Puna për ngritjen e një kadastre toke funksionale po vazhdon me shumë ngadalësi. Në zbatim të Ligjit për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, janë regjistruar kooperativa të reja për prodhimin e vajit, drithërave dhe perimeve. Puna për krijimin e një sistemi elektronik bujqësor (regjistri i fermave, regjistri i kafshëve, etj.) duhet të intensifikohet, me qëllim që të krijohet një bazë për menaxhimin e shëndoshë financiar të asistencës kombëtare dhe asistencës së BE-së.

Në fushën e **organizimit të tregut të përbashkët**, parlamenti miratoi ligjin për vajin e ullirit, që synon përafrimin me *acquis* në standardet e tregtimit.

Miratimi i Strategjisë për Bujqësinë dhe **Zhvillimin Rural** 2014-2020 ka mbetur pezull. Kanë vazhduar përgatitjet për të menaxhuar dhe kontrolluar fondet e zhvillimit rural në kuadrin e komponentit IPARD. Ftesa e parë për projekt-propozime nga skema IPARD-like u zhvillua në dhjetor-shkurt, e pasuar nga një ftesë e dytë e shpallur në prill. Rezultatet e pritshme të projektit duhet të monitorohen me kujdes.

Në mars u realizua vlerësimi për gatishmërisë e strukturave operuese IPARD (Agjencia e Pagesave dhe Autoriteti i Menaxhimit në Ministrinë e Bujqësisë, bashkë me organet e tjera përkatëse si Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO) dhe Fondi Kombëtar pranë Ministrisë së Financave) për menaxhimin e fondeve të Komponentit V të IPA-s. Ndër dobësitë e konstatuara ishte mungesa e progresit nga ZKA dhe Fondi Kombëtar në menaxhimin e asistencës së para-anëtarësimin në bujqësi, mungesa në Agjencinë e Pagesave të zyrave dhe pajisjeve të mjaftueshme, përfshi aparatet e kontrollit, si edhe mungesa e një politike të qartë për të mbajtur stafin e trajnuar si në Autoritetin e Menaxhimit, ashtu edhe në Agjencinë e Pagesave. Nevojiten përpjekje për të trajnuar më tej stafin mbi procedurat e përshtatshme, me qëllim që të forcohen kapacitetet administrative të të gjitha strukturave të përfshira në procesin e akreditimit.

Në fushën e **politikës së cilësisë**, ende nuk janë miratuar ndryshimet në Ligjin për Pronësinë Industriale në lidhje me treguesit gjeografikë.

Për sa i përket **bujqësisë organike**, janë dhënë subvencione përmes skemave të drejtpërdrejta si edhe trajnime mbi prodhimin organik. Ende nuk ka një ligj për bujqësinë organike.

### *Përfundim*

Përparimi ka qenë i kufizuar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Statistikat bujqësore janë përmirësuar. Ndërkohë që strukturat administrative për zbatimin e skemave IPARD janë ngritur në Ministrinë e Bujqësisë, të gjithë elementët e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit duhet të

forcohen ndjeshëm, që të realizojnë funksionet e tyre, sidomos ZKA dhe Fondi Kombëtar. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë nuk janë shumë të avancuara.

#### 4.12. Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare

Në fushën e **sigurisë së përgjithshme ushqimore**, kapacitetet e vlerësimit të riskut ende nuk janë ngritur, pavarësisht se është hedhur hapi i parë me Vendimin e Ministrisë së Bujqësisë për ngritjen e një Komiteti Shkencor të posaçëm. Kuadri rregullator në lidhje me Komitetin Shkencor duhet të plotësohet me rregulla të qarta dhe rregullore të brendshme që disiplinojnë aktivitetin e këtij organi, përfshi marrëdhëniet e tij me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, komunikimin e riskut, metodologjinë e vlerësimit të riskut, si edhe akordimin e buxhetit adekuat. Cilësia e inspektimit të stabilimenteve ushqimore është përmirësuar gradualisht. Megjithatë, kuadri organizativ dhe administrativ i sistemit të inspektimit nuk ka procedura dhe plane inspektimi të përshtatshme, përfshi ato për kontrollin e importeve.

Për sa i përket **politikës veterinare**, është bërë përparim me identifikimin dhe regjistrimin e bagëtive të imëta. Veterinerëve zyrtarë në nivel rajonal u është dhënë roli i menaxherëve të të dhënave. Matrikulimi dhe futja e të dhënave në databazën e kafshëve është pranë përfundimit. Janë zhvilluar dy vaksinime masive kundër brucelozës në bagëtitë e imëta, në përputhje me standardet e kërkuara, përfshi këtu përdorimin e vaksinave të certifikuara, zinxhirin e ftohtë të vaksinës të kontrolluar plotësisht, rritjen e fushatave sensibilizuese si dhe të monitorimit të procesit. Vaksinimi ndaj murtajës klasike të derrave ka filluar. Shumica e të dhënave mbi vaksinimin e kafshëve janë hedhur në sistemin informatik të kafshëve.

Punonjësit epidemiologjikë të terrenit janë pajisur me përshkrime pune dhe manuale pune. Sidoqoftë, për shkak të fragmentimit ndër-institucional dhe brenda-institucional të shërbimit veterinar, mungon përcaktimi i qartë i kompetencave, përgjegjësi, procedurave dhe komunikimi. Nivelet e stafit në zyrat qendrore veterinare mbeten të pamjaftueshme. Roli i Kryeveterinerit është thjesht teknik. Edhe pse ekziston një sistemi i mirë informatik për kafshët, nuk është bërë asnjë hap për menaxhimin e mbetjeve shtazore apo për përmirësimin e infrastrukturës fizike në tregjet e gjësë së gjallë.

Në fushën e **hedhjes në treg të ushqimit për kafshët dhe njerëzit dhe të nënprodukteve shtazore**, përparimi ka ecur me ritëm të ngadaltë, me përjashtim të përditësimit dhe certifikimit të databazës së stabilimenteve ushqimore (AKUnet) që tani ka të regjistruara 17 800 njësi. Nuk ka përparim në garantimin e gjurmueshmërisë së ushqimit, për shkak se mungon imponimi i rregullave, raportimi në kohë dhe informacioni i përditësuar i lëvizjeve të kafshëve. Burimet për monitorimin e agjentëve ndotës, hormoneve, ilaçeve veterinare, mbetjeve pesticide, etj. janë të pamjaftueshme. Është e nevojshme të garantohet realizimi i planeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve në përputhje me procedurat. Futja e procedurave dhe standardeve të reja me qëllim përafrimin me *acquis*, duhet të shoqërohet me fushata intensive sensibilizuese dhe informuese për

operatorët agro-ushqimorë.

Për sa i përket **rregullave të sigurisë ushqimore**, ekziston nevoja e përafrimit gradual me *acquis* të legjislacionit për kriteret bakteriologjike të qumështit të papërpunuar.

Ka pasur disa zhvillime domethënëse në fushën e **politikës fitosanitare**. Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i janë ngarkuar detyra inspektimi. Seksioni i Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë do të jetë përgjegjës për hartimin e legjislacionit, ndërsa stafi rajonal do të ketë funksion këshillues.

#### *Përfundim*

Përparimi ka qenë i pakët në fushat e sigurisë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare. Kapacitetet e sistemit të inspektimit duhet të forcohen dhe duhet të miratohen plane inspektimi sistematik. Mbeten për t'u krijuar kapacitetet e vlerësimit të riskut, ndërsa kuadri rregullator për Komitetin Shkencor duhet të miratohet. *Në tërësi*, përgatitjet mbeten në fazë të hershme.

#### **4.13. Kapitulli 13: Peshkimi**

Ndryshimet në Ligjin për "Për peshkimin" u miratuan në dhjetor, duke detyruar anijet e peshkimit mbi 12 metra gjatësi të instalojnë një transmetues siç e kërkon Rregullorja e Këshillit 1224/2009/KE. Janë miratuar akte nënligjore për rregullat e grumbullimit dhe përdorimit të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit, si edhe për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det. Kuadri ligjor duhet të zbatohet siç duhet.

Në fushën e **inspektimit dhe kontrollit**, janë miratuar akte nënligjore për parandalimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar si edhe vendosjen e një skeme certifikimi të zënieve, si edhe për një sistem kontrolli që garanton respektim të rregullave të politikës së menaxhimit të peshkimit. Pavarësisht ndryshimeve të fundit në Ligjin e Peshkimit, përmes të cilit janë caktuar vëzhgues që të ndihmojnë inspektorët në kryerjen e detyrave, mbeten të kufizuara kapacitetet e Drejtorisë së Peshkimit për grumbullimin e informacionit rreth sasisë së peshkut të zbarkuar, kapacitete këto që janë të nevojshme për përgatitjen e planeve menaxhuese shumëvjeçare për peshkimin si edhe për përmbushjen e detyrimeve të raportimit në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Speciet e ndaluara vazhdojnë të hidhen në treg, bashkë me peshq të përmasave më të vogla sesa lejohet. Sistemi i Monitorimit të Anijeve të Peshkimit është inaktiv që në gusht 2012 dhe duhet aktivizuar.

Për sa i përket **marrëveshjeve ndërkombëtare**, Shqipëria ka marrë pjesë në Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe ka rivendosur bashkëpunimin me Komisionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Tonit të Atlantikut (ICCAT)

## *Përfundim*

Shumë pak përparim është bërë në fushën e peshkimit, kryesisht me miratimin e legjislacionit të ri në fushën e grumbullimit të të dhënave dhe parandalimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar zbatimin e kuadrin ligjor, për të qartësuar përgjegjësitë administrative dhe për të forcuar kapacitetet, sidomos në hartim politikash dhe inspektim. *Në tërësi*, përgatitjet nuk janë shumë të avancuara.

### **4.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit**

Për sa i përket **transportit rrugor**, në dhjetor u miratua Ligji për Transportin e Mallrave të Rrezikshme që synon përafrimin me *acquis*. Përafrimi legjislativ me *acquis* në fushën e lejimit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor dhe aksesin në tregun e transportit rrugor nuk ka avancuar. Vlerësimet përkatëse të ndikimit si edhe konsultimet publike nuk janë realizuar sistematikisht. Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me gatishmërinë teknike të automjeteve për qarkullim, lejet e drejtimit, inspektimet e automjeteve si edhe futjen e kufizuesve të shpejtësisë. Miratimi i standardeve të reja teknike për transportin rrugor është ende pezull. Nuk ka pasur përmirësime në lidhje me sigurinë rrugore; numri i aksidenteve rrugore dhe vdekjeve mbetet i lartë, ku këmbësorët përbëjnë numrin më të madh të viktimave. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2011-2020 për Sigurinë Rrugore është në fazë fillestare. Nuk janë zhvilluar fushata efektive për sigurinë në rrugë.

Në fushën e **transportit hekurudhor**, Marrëveshja e kalimit të kufirit me Malin e Zi u ratifikua në dhjetor. Deklarata e rrjetit hekurudhor u finalizua dhe u publikua në mars. Ligji i ri për Hekurudhat ende nuk është miratuar. Nuk është bërë përparim për ngritjen e institucioneve të pavarura hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës dhe operatorët hekurudhorë. Burimet e caktuara për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë jashtëzakonisht të ulëta, duke çuar në përkeqësim të mëtejshëm të rrjetit.

Për sa i përket **transportit ajror**, janë bërë hapa të mëtejshëm në përmbushjen e kriterëve të fazës së parë kalimtare të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Janë miratuar akte nënligjore që synojnë përafrimin e mëtejshëm me *acquis* në lidhje me operacionet e shërbimit ajror, detyrimet e transportuesve ajrorë, orët e punës për punonjësit e lëvizshëm në aviacionin civil dhe rregullore për sigurimin. Një licencë e kufizuar vetëshërbimi për operacionet në tokë kontribuoi deri diku në liberalizimin e tarifave aeroportuale, që gjithsesi mbeten të shtrenjta. Legjislacioni për alokimin e hapësirave në aeroporte nuk është përmirësuar. Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror është certifikuar në nëntor. Trajnimet kanë përmirësuar kualifikimet e stafit të Autoritetit të Aviacionit Civil. Siguria është përmirësuar ndjeshëm, por mungojnë evidencat e trajnimit në vazhdim të Inspektorëve të Operacioneve të Fluturimit. Vazhdon varësia e tepruar ndaj ekspertëve të jashtëm në lidhje me detyrat e mbikëqyrjes së sigurisë. Kapacitetet administrative dhe teknike në sektorin e transportit ajror kanë nevojë për forcim të mëtejshëm.

Në fushën e **transportit detar**, koha e qëndrimit e mjeteve të lundrimit që mbajnë flamur shqiptar është përmirësuar me daljen nga shërbimi të një numri mjedesh lundrimi, por gjithsesi mbetet e lartë. Në shtator, u miratua ligji i ri për aderimin e Shqipërisë në Protokollin për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme (OPRC-HNS). Shqipëria ende nuk merr pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit për Kontrollin Shtetëror Portual dhe mbetet në listën e zezë të kësaj organizate.

#### *Përfundim*

Është bërë pak përparim në politikën e transportit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit me *acquis* dhe për forcimin e kapaciteteve administrative në të gjitha format e transportit. Siguria rrugore mbetet një shqetësim serioz dhe duhet të adresohet urgjentisht. Kapacitet e mbikëqyrjes së sigurisë ajrore janë përmirësuar, por ende varen së tepërmi nga ekspertët e jashtëm. Në *tërësi, përgatitjet* në fushën e transportit nuk kanë avancuar shumë.

#### **4.15. Kapitulli 15: Energjia**

Ligji i ri për sektorin energjetik është ende në proces hartimi.

Në lidhje me **sigurinë e furnizimit me energji**, kapacitetet gjeneruese janë rritur me vënien në funksionim që në shtator të hidrocentralit të ri të Ashtës. Qeveria miratoi një VKM për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentrale.

Marrëveshja ndërqeveritare me Italinë dhe Greqinë për projektin e gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) dhe Marrëveshja me Qeverinë e Vendit Pritës ndërmjet konsorciumit TAP dhe Shqipërisë, u ratifikuan përkatësisht në mars dhe prill. Në qershor, Projekti TAP u përzgjedh për ta çuar gazin azerbajxhanas të fushës Shah Deniz 2 nga kufiri turk përmes Greqisë dhe Shqipërisë drejt Italisë. Ky gazsjellës do t'i mundësojë Shqipërisë akses në burime gazi natyror. Shqipëria ka miratuar një plan kombëtar sektorial për zhvillimin e projektit TAP dhe ka nënshkruar një marrëveshje të përbashkët me organet rregullatore të energjetikës në Itali dhe Greqi. Shqipëria mbetet tejet e varur ndaj energjisë hidrike dhe është vulnerabël ndaj kushteve hidrologjike. Nuk është shënuar përparim në forcimin e kapaciteteve monitoruese për të siguruar respektim të detyrimit ligjor nga ana e operatorëve ekonomikë për mbajtjen rezervës së sigurisë.

Në fushën e **tregut të brendshëm energjetik**, miratimi i Ligjit për Sektorin e Energjisë ka mbetur pezull. Për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të sektorit, nevojitet urgjent përshtatja substanciale e modelit të tregut, përfshi çmimvënien me bazë koston dhe miratimi i një kuadri ligjor të qartë.. Duhet të qartësohen rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në tregun e energjisë elektrike, si edhe të forcohet llogaridhënia e tyre. Nuk janë bërë përparime në ndarjen e operacioneve të prodhimit dhe furnizimit me shumicë të ndërmarrjes shtetërore KESH. Vështirësitë financiare të KESH-it gjatë 2012 minuan aftësinë e tij për të importuar energji elektrike dhe për të paguar prodhuesit e vegjël vendas, duke krijuar kështu nevojë në rritje për hua tregtare

për të cilat shteti u detyrua të hynte garant. Situata u përmirësua gjatë gjysmës së parë të 2013 falë reshjeve të dendura, duke i mundësuar Shqipërisë të rriste eksportin e energjisë elektrike. Megjithatë, likuiditeti i dobët financiar i të gjithë sektorit të energjisë elektrike mbetet shqetësues. Humbjet dhe norma e arkëtimeve mbeten në nivele të paqëndrueshme. Mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë shpërndarëse CEZ (CEZ Shpërndarje) dhe KESH rezultuan në revokimin e licencës së shpërndarjes të CEZ Sh nga ana e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) si edhe në kalimin e saj nën administrim publik për një vit. Pas kësaj, CEZ Shpërndarje filloi një procedurë arbitrazhi ndërkombëtar. Tarifat e reja të energjisë elektrike të miratuara nga ERE në maj po zbatohen. Kapacitetet administrative dhe pavarësia operationale e ERE-s mbeten të dobëta.

Ndryshime e miratuara në Ligjin për Gazin Natyror synojnë ta përafrojnë më tej këtë ligj me *acquis*. Për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit, ERE i dha licenca shoqërisë shqiptare të naftës dhe gazit, Albpetrol. Albpetroli ende nuk ka përmbushur kërkesat ligjore si operator i sistemit të transmetimit.

Ligji për **energjinë e rinovueshme** u miratua për të rritur përafrimin me *acquis*, por mbeten për t'u miratuar aktet nënligjore. Hartimi i Planit kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme ka hasur në vonesa. Rregullat për aksesin në rrjetin e instalimeve të energjisë së rinovueshme duhet të përfshihen në Ligjin e ri për Sektorin e Energjisë. Nuk janë pakësuar barrierat administrative për licencimin dhe autorizimin e investimeve në energjinë e rinovueshme, si edhe për lidhjen e prodhuesve të energjisë së rinovueshme me rrjetin. Ligji për hidrokarburet mbetet për t'u ndryshuar, me qëllim që të përafrohet me *acquis* në lidhje me përdorimin e energjisë së rinovueshme në transport.

Janë organizuar trajnime për audituesit në fushën e **efiçencës së energjisë** në ndërtesa. Ligji për Efiçencën e Energjisë ende nuk është miratuar. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë po pengohet nga mungesa e vullnetit politik, kapaciteteve administrative dhe burimeve financiare. Përgatitja e planit të dytë kombëtar për efiçencën e energjisë po has vonesa.

Në fushat e **energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimet**, Shqipëria miratoi në prill ndryshimet në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore. Janë miratuar ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jo-jonizues, si edhe aktet nënligjore për standardet e sigurisë së publikut ndaj ekspozimit në rrezatim jo-jonizues. Janë miratuar rregullore për procedurat e njohjes së fizikanëve mjekësorë prej Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet i forcoi kapacitetet me punësimin e dy punonjësve.

### *Përfundim*

Përparim i pakët është bërë në fushën e energjetikës. Janë bërë disa përparime në lidhje me furnizimin me energji, por diversifikimi i burimeve të energjisë elektrike ende mungon. Kushtet për një treg konkurrues energjie elektrike ende nuk ekzistojnë. Niveli i lartë i humbjeve dhe

normat e ulëta të arkëtimeve duhet të adresohen urgjentisht. Në tërësi, përgatitjet nuk janë shumë të avancuara.

#### 4.16. Kapitulli 16: Tatimet

Në fushën e **tatimit të tërthortë** ka pasur një trend pozitiv në rritje të numrit të rimbursimeve të TVSH-së të përpunuara si edhe të kërkesave të miratuara për rimbursim TVSH-je. Zbatimi i legjislacionit tatimor ende kërkon përmirësime të rëndësishme, me theks të veçantë në procedurat e rimbursimit të TVSH-së, meqenëse vonesat vazhdojnë. Legjislacioni i miratuar që përjashton nga TVSH-ja disa importe për qëllime investimi nuk është në përputhje me *acquis*. Duhet të miratohet një ligj i TVSH-së që të përputhet më mirë me *acquis*.

Shqipëria filloi zbatimin e legjislacionit të ri të *akcizës* (2012). Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përputhur strukturën dhe normat e akcizës me *acquis*. Vazhdojnë vështirësitë teknike për përdorimin e pullave të akcizës.

Në fushën e **tatimit të drejtpërdrejtë**, numri i deklaratave të të ardhurave personale për herë-të-parë është rritur (PID). Përpjekje të mëtejshme nevojiten për harmonizimin legjislativ. Projektligji për bashkimet dhe kursimet nuk është miratuar ende dhe praktikrat e transferimit të çmimit nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të BE-së.

Për sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë**, Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Kosovën për tatimet dhe për të luftuar evazionin tatimor dhe një marrëveshje me Mbretërinë e Bashkuar për të shmangur taksimin e dyfishtë. Ajo gjithashtu ka ratifikuar Konventën për asistencë të ndërsjellë administrative për çështjet e taksave, dhe një marrëveshje shumëpalëshe të zhvilluar bashkërisht nga Këshilli i Evropës dhe OECD.

Për sa i përket fushës së **kapaciteteve operacionale dhe të kompjuterizimit**, është miratuar në dhjetor një strukturë e re e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), që përfshin edhe Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Njësinë për Transferimin e Çmimeve, me synimin për të përmirësuar grumbullimin e taksave dhe luftën kundër evazionit tatimor.

Departamenti i Hetimeve Tatimore (DHT) ka shtuar përpjekjet e tij në luftimin e evazionit tatimor si edhe numrin e rasteve të dërguara në prokurori. Dënimet për evazion tatimor janë rritur. Rritja e bashkëpunimit të brendshëm në fushën e auditimit të brendshëm dhe luftimin e korrupsionit ka rezultuar në më shumë propozime për veprime disiplinore dhe në më shumë raste të dërguara në prokurori. Megjithatë, korrupsioni në administratën tatimore dhe evazoni tatimor mbeten një shqetësim.

Akademia e Tatimeve dhe Doganave ka filluar punën në muajin maj. DHT ka marrë trajnime për zbulimin e evazionit tatimor dhe për hetimin e krimeve tatimore. Duhet të rriten më tej burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional për monitorimin e dosjeve PID. Përfshirja e komunitetit të biznesit në proceset e hartimit të politikave dhe legjislacionit mbetet e ulët.

Për sa i përket kompjuterizimit, janë prezantuar sisteme elektronike për deklarimin e të ardhurave

tatimore personale, duke i dhënë akses tatimpaguesve në të dhënat përmes pajisjeve të lëvizshme, edhe pse niveli i pagesave elektronike të taksave mbetet i ulët. Kanë filluar përgatitjet për përmirësimin e sistemit të TI, përfshi një sistem të analizës së riskut.

#### *Përfundim*

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e tatimeve. Lufta kundër korrupsionit dhe evazionit tatimor duhet të forcohet, edhe pse disa masa janë marrë, këto çështje mbeten shqetësim. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për harmonizimin legjislativ me *acquis*, hetimin tatimor, përfshi shkëmbimin e informacionit me vendet e BE-së, rimbursimet e TVSH-së dhe TI. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### **4.17. Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare**

Në përgjithësi, **politika monetare** ka qenë e kujdesshme në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve duke e mbajtur inflacionin brenda objektivit prej 2-4% të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, politika monetare është e kufizuar nga shkalla relativisht e lartë e euroizimit të sistemit financiar. Menaxhimi efektiv i politikës monetare nga banka duhet të ruhet, dhe Ligji për Bankën e Shqipërisë duhet të përafrohet më tej me *acquis* për të rritur pavarësinë e bankës.

Për sa i përket **politikës ekonomike**, Shqipëria e miratoi në janar Programin e saj Ekonomik dhe Fiskal (PEF) për periudhën 2013-15. Ajo është bazuar në Ligjin e Buxhetit 2013 të miratuar në dhjetor dhe në programimin makroekonomik dhe fiskal për 2013-15 i cili u miratua në janar. Objektivat kryesore fiskale për vitet 2013-15 kanë të bëjnë në përgjithësi me një ulje të huamarrjes neto si përqindje të PBB-së nga 3.5% në 2013-2,2% në vitin 2015, duke ruajtur në çdo vit nivelin e shpenzimeve kapitale të jo më pak se deficiti i përgjithshëm fiskal. Në dhjetor, Shqipëria shfuqizoi tavanin zyrtar prej 60% të PBB-së për borxhin publik, i cili vlerësohet nga PEF aktuale për të arritur 63.8% në vitin 2013, duke mos arritur të përmbushë një prej objektivave të PEF për periudhën 2012-14. Të dhënat fiskale nuk përputhen me standardet e sistemit evropian të llogarive ESA95.

Kornizat makroekonomike dhe fiskale duken disi optimiste dhe projeksionet makroekonomike nuk janë të plotësuara me skenare alternative nga pikëpamja e pasigurisë. Pothuajse të gjitha të dhënat relevante janë të mbuluara në përputhje me metodologjinë e PEF, por dobësitë vazhdojnë, sidomos në lidhje me tregun e punës dhe statistikat e pagave. Lidhjet mes skenarit makroekonomik dhe reformave strukturore nuk janë mjaftueshëm të qarta. Korniza për reformat strukturore nuk është koherente dhe gjithëpërfshirëse dhe i mungojnë afatet kohore të qarta dhe shtigjet buxhetore për zbatimin. Kapaciteti për koordinimin dhe zbatimin e politikave ekonomike mbetet i pamjaftueshëm.

#### *Përfundim*

Ka pasur pak përparim në lidhje me përmirësimin e cilësisë së përgatitjes së dokumenteve të politikave ekonomike. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me planifikimin e politikave dhe procesin e zbatimit. Duhet të rriten kapacitetet e hartimit të politikave të institucioneve të përfshira në përgatitjen e PEF. Në tërësi, përgatitjet ende nuk janë të mjaftueshme.



#### 4.18. Kapitulli 18: Statistikat

Për sa i përket **infrastrukturës statistikore**, struktura e re e Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT) është miratuar në dhjetor. Ajo përfshin dy drejtoritë e reja për Integrimin Evropian dhe Statistikat Bujqësore, që pasqyrojnë transferimin e fushave statistikore nga Ministria e Bujqësisë. Kapaciteti i INSTAT-it është rritur me rekrutimin e 36 të punësuarve, ndërsa zyrat rajonale janë zvogëluar nga 36 në 12 për ta bërë INSTAT-in më funksional. Programi për statistikat zyrtare për periudhën 2012-15 u miratua në shkurt. Ligji mbi statistikat u ndryshua në shkurt, duke prezantuar rolin e INSTAT-it si koordinues i sistemit kombëtar të statistikave, duke siguruar në këtë mënyrë përfaqësim më të gjerë në Këshillin e Statistikave dhe duke vendosur procedurën për rekrutimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it, për lejimin e dy mandateve pesë-vjeçare.

Mandati i këtij të fundit u rikonfirmua në qershor. Duhet të sigurohet zbatimi i duhur i këtij ligji. Kërkohej përpjekje të mëtejshme për të rritur pavarësinë profesionale të INSTAT. Bashkëpunimi ndërinstucional në nivel kombëtar në shumë fusha statistikore mbetet i dobët.

Për sa i përket **klasifikimeve dhe regjistrave**, puna për regjistrin statistikor të bujqësisë është duke përparuar, përfshi testet mbi bazat e të dhënave.

Në fushën e **statistikave sektoriale**, INSTAT ka përmirësuar llogaritë kombëtare dhe metodologjitë e tyre. Është bërë përparim në përgatitjen e statistikave tremujore të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar aksesin në mikro-datat dhe datasets, si dhe për të zhvilluar një inventar të proceseve dhe të dhënave sistematike.

INSTAT ka kryer censusin e popullsisë dhe banesave në tetor të vitit 2012. Rezultatet paraprake u publikuan në mars dhe rezultatet përfundimtare priten në dhjetor të vitit 2013. INSTAT publikoi rezultatet përfundimtare të censusit të popullsisë dhe banesave të 2011 në nivel kombëtar në dhjetor dhe në nivel rajonal dhe vendor në muajin maj. Të dhënat për punësimin, papunësinë dhe profesionin ende nuk janë botuar.

Nevojiten përpjekje për të përmirësuar disa fusha të statistikave sektoriale, sidomos ato bujqësore, sociale, të punës, turizmit dhe statistikave makroekonomike, si dhe për të siguruar që të dhënat statistikore janë në dispozicion për publikun e gjerë.

#### *Përfundim*

Përparim është bërë në fushën e statistikave. Zbatimi i amendamenteve të ligjit mbi statistikat është i rëndësishëm. Duhet të garantohet besueshmëria dhe pavarësia e INSTAT-it. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### 4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe Punësimi

Për sa i përket **ligjit të punës**, ndryshimet në Kodin e Punës janë ende në pritje të miratimit. Puna e fëmijëve mbetet një sfidë e rëndësishme. Sondazhi i parë kombëtar i punës së fëmijëve i kryer në muajin maj 2010 (publikuar në maj 2013) vlerëson se 7.7% e të gjithë fëmijëve shqiptarë të moshës 5-17 punojnë. Shpërndarja statistikore e fëmijëve punëtorë për grup moshe ka nevojë të

përmirësohet duke marrë në konsideratë standardet dhe dispozitat ndërkombëtare të Kodit të Punës për moshën minimale për të punuar.

Për sa i përket **shëndetit dhe sigurisë në punë**, janë kryer disa fushata ndërgjegjësimi për informimin e punonjësve në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, parandalimin e rreziqeve dhe kushtet e punës së punonjësve. Numri i aksidenteve në punë në vitin 2012 ishte më i ulët se në vitin 2011, por numri i aksidenteve që rezultojnë në vdekje ende ngre shqetësime. Në përgjithësi, kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë mbeten të dobëta. Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP) është riorganizuar dhe funksionon në nivele qendrore dhe rajonale. Inspektorët janë trajnuar gjithashtu, veçanërisht për legjislacionin e BE-së në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë. Ndikimi i riorganizimit të kapaciteteve administrative duhet të monitorohet me kujdes.

Në lidhje me **dialogun social**, mandati i Këshillit Kombëtar të Punës (KKP) ka skaduar në fund të marsit. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSHB) ka propozuar një kompozim të ri të Këshillit, pjesërisht në përputhje me kriteret e përfaqësimit të përcaktuara nga standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), i cili është ende duke u diskutuar nga partnerët socialë. Dialogu social dypalësh mbetet shumë i dobët, veçanërisht në sektorin privat.

Në lidhje me **politikën e punësimit**, është duke u hartuar një strategji punësimi për 2014-20 dhe është në pritje të miratimit. Niveli zyrtar i papunësisë ra pak në 2012 në 13%, por papunësia afatgjatë (51% e të papunëve në vitin 2012) dhe papunësia e të rinjve janë shumë të larta. Numri i punonjësve të regjistruar në 2012 tregon një rritje të lehtë prej 0.6% në krahasim me 2011. Megjithatë, pjesëmarrja e tregut të punës dhe shkalla e punësimit mbetet e ulët, sidomos për gratë, ndërsa ekonomia informale mbetet një ofrues i rëndësishëm i vendeve të punës. Statistikat kanë nevojë të përmirësohen.

Pagesa e sigurimit të papunësisë mbetet e ulët, në rreth 6% të numrit të përgjithshëm të papunëve të regjistruar. Gjithsej 969 të papunë punëkërkues ishin të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit, nga të cilët rreth 70% ishin gra punëkërkuese. Fondet Kombëtare në dispozicion për programet e punësimit kanë rënë edhe më tej dhe janë kryesisht të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat e grupeve më të rrezikuara në mesin e të papunëve. Një Qendër e re e Formimit Profesional është hapur në Kukës në muajin mars. MPÇSHB ka vënë në punë një e-portal i cili mbulon 12 zyra rajonale të punësimit dhe 24 zyra lokale të punësimit dhe shërben si një platformë edhe për punëkërkuesit edhe punëdhënësit për të shkëmbyer informacion në tregun e punës. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për modernizimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në veçanti me synimin për të rritur atraktivitetin e saj dhe nivelet e performancës. Janë bërë përpjekje për të luftuar *punën e padëklaruar*.

Nuk ka pasur zhvillime për sa i përket përgatitjeve për **Fondin Social Evropian**.

Për sa i përket **përfshirjes sociale**, drafti i ri i strategjisë për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen sociale 2013-2020 është hartuar dhe konsultuar gjerësisht. Strategjia përfshin një qasje të re të komunitetit të gjerë ku anti-diskriminimi është një drejtues i rëndësishëm në arritjen e përfshirjes sociale. LSMS-ja e fundit (Anketa e matjes së nivelit të jetesës së familjes) tregon se nivelet e varfërisë janë rritur në 2012, duke ndryshuar trendin e rënies së 2002-2008. Sipas parametrave të studimit, varfëria u rrit nga 12.4% në 2008 në 14.3% në vitin 2012. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka miratuar kuota për regjistrimin e studentëve romë dhe egjiptianë në Universitetet

publike në vitin akademik 2012-13. Pranimi dhe mbajtja në sistemin arsimor mbetet sfidues për fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Zbatimi i politikave të përfshirjes sociale që shënjestron romët mbetet i ngadaltë.

Për sa i përket *personave me aftësi të kufizuara*, u ratifikua Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe u botua Plani Kombëtar i Veprimit 2012-2021 në nëntor 2012. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka miratuar tre udhëzime për rregullimin e pagesës për aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të kujdestarisë me normën e inflacionit (indeksi i rritur i çmimeve të konsumit). Zyrat e punësimit dhe qendrat e formimit profesional janë trajnuar në Ligjin për nxitjen e punësimit, përfshi kuotën për personat me aftësi të kufizuara. Janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese mbi nevojën për të integruar gjuhën e shenjave në shkolla. Projektligji kuadër për përfshirjen dhe aksesibilitetin e personave me aftësi të kufizuara nuk ishte finalizuar.

Në fushën e **mbrojtjes sociale** nuk janë marrë masa specifike për të trajtuar vonesat në pagesat për aftësi të kufizuara dhe pensionet. Në korrik hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave për rritjen e pagave dhe pensioneve. Reforma e pensioneve nuk po ecën përpara për shkak të mungesës së vullnetit politik. Niveli i kontributeve për pension të pleqërisë u rrit me 60% në vitin 2012 për shkak të numrit më të lartë të kontribuuesve të sektorit privat. Të dhënat Institutit të Sigurimeve Shoqërore botuar në 2012 tregojnë se kanë qenë 554 102 përfitues kundrejt 651 613 kontribuuesve. Të dhënat paraprake tregojnë se numri i kontribuuesve zbriti në 561 306 në gjysmën e parë të vitit 2013.

Në fushën e **anti-diskriminimit**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit, duke dhënë rekomandime ligjore dhe duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione qeveritare qendrore/vendore dhe disa organizata të shoqërisë civile. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i ankesave të dorëzuara në KMD është rritur ashtu si edhe numri i hetimeve të nisura *ex officio*. KMD ka vendosur pesë gjopa për institucionet publike për moszbatimin e vendimeve të tij dhe ka ofruar ndihmë juridike në dy raste. Implementimi dhe zbatimi i Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi mbetet i pamjaftueshëm. Niveli i ndërgjegjësimit publik për ligjin dhe i mekanizmit të ankesës mbetet i ulët. Duhet të sillen më shumë raste në konkluzion përfundimtar, në se është e nevojshme, me ndëshkime adekuate për autorët e krimit. (*Shih gjithashtu Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore*).

Në fushën e **mundësive të barabarta** ndërmjet grave dhe burrave janë ndërmarrë disa programe të punësimit për të mbështetur aksesin e grave në punësim. Nuk janë marrë masa të veçanta për të adresuar hendekun gjinor në aspektin e pagesës, aksesit për sipërmarrjen dhe kredi. Në përputhje me strategjinë kombëtare për barazinë gjinore 2012-15, kapacitetet e administratës që kanë të bëjnë me çështjet e gjinisë në nivel shtetëror dhe komunal janë forcuar përmes trajnimit. Nevojiten burime financiare dhe njerëzore shtesë për të garantuar zbatimin e duhur të strategjisë. Përfaqësimi i grave në tregun e punës, veçanërisht në fushën e vendim-marrjes politike dhe ekonomike, mbetet i pamjaftueshëm. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të nxitur bashkëpunimin me shoqërinë civile në këtë fushë. (*Shih gjithashtu Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore*).

#### *Përfundim*

Ka pasur përparim në fushën e politikës sociale dhe punësimit. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe ndryshimet në Kodin Punës janë ende në

pritje për miratim. Institucionet e tregut të punës dhe të dhënat mbeten të dobëta. Janë bërë disa përpjekje për sa i përket anti-diskriminimit dhe të mundësive të barabarta, por nevojiten më shumë burime financiare dhe njerëzore për t'u investuar në zbatimin e politikave përkatëse në nivelin qendror dhe sidomos atë vendor. Në tërësi, përgatitjet në fushën e politikës sociale dhe punësimit nuk janë shumë të avancuara.

#### 4.20. Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale

Në lidhje me **parimet e ndërmarrjeve dhe politikave industriale**, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë aktin ligjor për biznesin e vogël (SBA). Kuadri ligjor dhe rregullator ka vazhduar të përmirësohet veçanërisht në fushat e falimentimit dhe shansit të dytë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe regjistrimit të kompanisë dhe hapjes së biznesit. Janë ndërmarrë hapa për zbatimin e reformës së inspektoratit duke miratuar amendamente në ligjet sektoriale, zbatimin e legjislacionit për organizimin dhe strukturën e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe kodit të etikës së punonjësve të tij. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-20, e cila merr në konsideratë parimet e (SBA), nuk është miratuar ende. Nuk ka pasur përparime për sa i përket harmonizimit legjislativ për pagesat e vonuara.

Në fushën e **instrumenteve të ndërmarrjeve dhe të politikave industriale**, financimi i NVM-ve ka vazhduar përmes Fondit të Garantimit të Kredive dhe Fondit Evropian për Evropën Jug-Lindore, por aksesimi në financat për NVM-të mbetet një çështje. Agjencia shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka promovuar Qendrën e Ndërmjetësimit dhe Inovacionit dhe Fondin e Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit. Duhet të rriten më tej kapacitetet e AIDA-s për të zbatuar mekanizmat e promovimit të NVM-ve.

Në kuadër të Programit të Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit 2007-13, Shqipëria iu bashkua Rrjetit Evropian të Ambasadoreve të Sipërmarrjes Femërore dhe Rrjetit Evropian të Mentorëve për Femrat Sipërmarrëse.

Për sa i përket **politikave sektoriale**, është ndryshuar ligji për turizmin, duke qartësuar statusin ligjor dhe fushën e veprimtarisë së Zyrrave të Shërbimit Turistik. Shqipëria miratoi në shkurt planin e sektorit minerar 2013. Legjislacioni për minierat është ndryshuar.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përparime në zbatimin e politikave të NVM-ve dhe konvergencën e politikave drejt standardeve dhe praktikave të BE-së, veçanërisht në lidhje me regjistrimin e kompanisë dhe hapjen e biznesit. Shqipëria duhet të vazhdojë të fokusohet në përmirësimin e mjedisit të biznesit, duke prezantuar një vlerësim të plotë të impaktit rregullator për të gjithë legjislacionin me implikime të drejtpërdrejta në operacionet e biznesit. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### 4.21. Kapitulli 21: Rrjetet transeuropiane

Në fushën e **rrjeteve të transportit**, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në Observatorin e Transportit të Evropës Jug-Lindore dhe të zbatojë memorandumun e mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit qendror të transportit Rajonal të Evropës Juglindore.

Përmirësimet kanë vazhduar në të gjithë rrjetin rrugor. Punimet për ndërtimin e by-pasit të Fierit në korridorin VIII kanë filluar; edhe ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan po ecën mirë, ndërsa segmenti Dames-Tepelenë nuk ka përfunduar ende. Në korridorin veri-jug, seksioni nga Shkodra deri në kufirin me Malin e Zi ka përfunduar, me përjashtim të unazës rrugore të Shkodrës e cila është e vonuar. Problemet e shpronësimit dhe mungesa e fondeve vazhdon të ngadalësojë disa projekte. Shpesh punimet nuk përfundohen dhe rrugët lihen pa sinjale dhe vijëzime. Vlerësimet e përgjithshme të ndikimit mjedisor nuk kryhen sistematikisht. Tenderi për dhënien me koncesion për mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë, i cili u shpall në shkurt të vitit 2012, ende nuk është finalizuar. Skema për menaxhimin e asetëve të mirëmbajtjes së rrugëve është përditësuar. Fondet e alokuara për mirëmbajtjen janë ende të pamjaftueshme. Për sa i përket infrastrukturës portuale, punimet në Durrës janë duke avancuar mirë, ndërkohë kanë filluar procedurat e prokurimit për punimet e planifikuara në Vlorë. Duhet të garantohen burimet financiare për thellimin e portit në mënyrë që të mos rrezikohen investimet. Mirëmbajtja e përgjithshme e infrastrukturës së transportit mbetet një sfidë e rëndësishme.

Për sa i përket **rrjeteve energjetike**, hidrocentrali i ri Ashta është vënë në punë. Investimet për rehabilitimin dhe modernizimin e monitorimit të nënstacioneve 220 kV në Fier, Tiranë, Elbasan dhe Burrel kanë përfunduar. Një studim i fizibilitetit për ndërtimin e një interkoneksioni 200 Kv me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është finalizuar. Përgatitjet për ndërtimin e interkoneksionit 400 kV me Kosovën u ri-shpallën në janar pas një vonese për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me rezultatin e procedurës së parë të tenderit. Në qershor projekti i TAP-it (Gazsjellësi Trans-Adriatik) u përzgjedh për të sjellë gazin azerbajxhanas nga Konsorciumi Shah Deniz 2 prej kufirit turk nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë për në Itali (Shih gjithashtu kapitullin 15 - Energjia). Është miratuar një plan kombëtar sektorial për zhvillimin e projektit TAP.

#### *Përfundim*

Janë bërë përparime në fushën e rrjeteve transevropiane. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore është duke vazhduar. Nuk ka pasur progres në zhvillimin e rrjetit hekurudhor. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit mbetet një sfidë. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e rrjeteve transevropiane nuk kanë avancuar shumë.

#### **4.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore**

Për sa i përket **kuadrit legjislativ**, janë ndërmarrë hapa për të siguruar programimin sektorial shumëvjeçar, fleksibilitetin e buxhetit dhe kapacitetet bashkë-financuese për projektet e BE-së në nivel kombëtar dhe vendor.

Për sa i përket **kornizës institucionale**, janë ngritur strukturat kombëtare të kërkuara për menaxhimin e decentralizuar të komponentit IPA I. Pas paraqitjes së paketës së akreditimit në Komision, dy misione auditimi janë ngritur për të vlerësuar gatishmërinë e strukturave. Shqipëria ka adresuar shumicën e rekomandimeve për menaxhimin e fondeve të komponentit IPA I. Në lidhje me Komponentin IPA II, marrëveshjet zbatuese dhe operacionale ndërmjet zyrtarit kombëtar të autorizuar, kreut të strukturës operuese dhe zyrtarit të autorizues të programit për komponentin II nuk janë miratuar ende. Përgatitjet për menaxhimin e decentralizuar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë në proces. *(shih gjithashtu Kapitulli 11 - Bujqësia)*.

Në fushën e **kapaciteteve administrative** për të gjitha strukturat e IPA-s, ka përfunduar në dhjetor analiza e ngarkesës së punës për organet kryesore të IPA-s dhe në shkurt është finalizuar plani i përditësuar për nevojat e mundshme të trajnimit për 2013. Hapa të mëtejshme duhet të ndërmerren për të siguruar personel të mjaftueshëm në strukturat e IPA-s.

Janë bërë përparime të moderuara në **kuadrin institucional**. Paketa e akreditimit për komponentin IPA I u finalizua dhe u dërgua për vlerësim në Komisionin Evropian në shkurt. Ndryshimet në bazën ligjore për vënien në punë të strukturave për zbatimin e komponentëve IPA II, III dhe IV (instrumentet pararendëse të Politikës së Kohezionit të BE-së) janë në pritje të miratimit. Zbatimi i marrëveshjeve ose programeve operationale do të duhet të nënshkruhet në mes të Zyrtarit Kombëtar të Autorizuar, kreu i strukturave operative dhe organeve, që formojnë strukturat operative për komponentët III dhe IV, sapo baza ligjore të jetë miratuar. Udhërrëfyesi kombëtar për transferimin e përgjegjësive të menaxhimit tek autoritetet kombëtare në lidhje me komponentët IPA II, III dhe IV është rishikuar. Në mënyrë që të veçojë programimin dhe funksionet e monitorimit, Ministria e Integritit ka rishikuar strukturën e saj të brendshme organizative dhe ka krijuar një sektor monitorimi të veçantë.

**Në lidhje me programimin, kapacitetet administrative duhet të forcohen në mënyrë të konsiderueshme** për të qenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë politika dhe strategji sektoriale realiste. Zhvillimi i projekteve prioritare mbetet një çështje e rëndësishme për t'u trajtuar, veçanërisht në lidhje me të ardhmen e asistencës së BE-së në kuadër të IPA 2. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI) për periudhën 2013-2020, e cila *mes të tjerash* trajton politikat rajonale, është shtyrë për tremujorin e parë të vitit 2014.

Për sa i përket **monitorimit dhe vlerësimit**, procedurat e monitorimit dhe vlerësimit janë rishikuar dhe një ndarje e funksioneve monitoruese nëpër strukturat e IPA-s është vendosur.

Në fushën e **menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit**, procedura për kërkimin e fondeve IPA nga fondi kombëtar është zhvendosur nga një bazë parashikimi në një bazë të faturës. Bordi Menaxhues i Autoritetit të Auditit (AA) është emëruar. Personeli i AA-së ka marrë trajnim për procedurat e auditimit. Kapacitetet duhet të forcohen më tej dhe numri i personelit duhet të rritet.

### *Përfundim*

Disa përparime janë bërë në fushën e politikës rajonale dhe koordinimin e strukture instrumenteve. Për shkak të akreditimit, menaxhimit dhe të sistemeve të kontrollit të IPA-s strukturat duhet të forcohen më tej për të minimizuar rrezikun e vonesave dhe anulimin e fondeve. kapacitetet programuese duhet të përmirësohen, sidomos për të zhvilluar projekte prioritare të menduara mirë dhe me cilësi. *Në tërësi*, përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar.

## **4.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore**

### *Sistemi gjyqësor*

Janë bërë disa përparime në plotësimin e kuadrit ligjor për reformën zgjedhore, që është prioritet

kyç i Opinionit. Zbatimi i Strategjisë së Reformës Gjyqësore 2011-2013. Disa masa kanë mbetur pezull dhe vlerësimi tërësor i reformës po pengohet nga mungesa e indikatorëve specifikë. Bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional, mungesa e burimeve njerëzore dhe planifikimi e alokimi i dobët buxhetor mbeten shqetësuese. Shqipëria duhet të përditësojë strategjinë e reformës gjyqësore dhe të rritë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore.

Ligji për Gjykatën e Lartë u miratua në maj, duke i hapur rrugë zbatimit të Ligjit për Gjykatat Administrative të miratuar në 2012. Në prill u miratua Ligji për Administratën Gjyqësore u miratua në prill, ndërsa në prill dhe maj u miratuan një numër i madh ndryshimesh që iu bënë Kodit Civil, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Civile. Ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i Kodit të Procedurës Penale, sidomos në lidhje me miratimin e dispozitave që synojnë racionalizimin e kompetencave dhe procedurave të Gjykatës së Lartë si edhe reduktimin e ngarkesës së punës. Nevojitet të miratohen akte ligjore të rëndësishme për reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Roli i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të shqyrtohet.

Për sa i përket **pavarësisë** dhe **paanshmërisë** së gjyqësorit, Ligji për Gjykatën e Lartë që hyri në fuqi më 1 tetor, e rrit numrin e gjyqtarëve nga 17 në 19 dhe synon, ndër të tjera, ngritjen e një seksioni administrativ për të trajtuar më me efikasitet ngarkesën e punës të Gjykatës.

Ligji përcakton edhe kritere dhe kushte më rigorozë për përzgjedhjen e gjyqtarëve si edhe redukton komponentin jogjyqësor në anëtarësinë e Gjykatës në maksimumi 1/4, duke përforcuar kështu natyrën profesionale të Gjykatës së Lartë. Përveç kësaj, Presidentit të Republikës i kërkohet të motivojë zgjedhjen e kandidatëve për çdo vend vakant në Gjykatë. Statusi i Gjykatës së Lartë dhe procesi i emërimit të gjyqtarëve në këtë Gjykatë mbeten çështje shqetësuese për shkak të politizimit të mundshëm, për sa kohë që nuk ndryshohen dispozitat kushtetuese përkatëse. Pavarësia dhe paansësia e Gjykatës së Lartë ende nuk është plotësisht e garantuar.

Vlerësimi i gjyqtarëve – që nuk ka përfunduar akoma – është kriter vendimtar për të pasur proces emërimesh, transferimesh dhe ngritjesh në detyrë të bazuar në merita dhe transparencë. Shihet një prirje e përgjithshme për t'i dhënë më shumë peshë meritave të aplikantit dhe kritereve të tjera objektive. Emërimet, transferimet dhe ngritjet në detyrë të gjyqtarëve gjatë muajit korrik tregoi se shkalla e diskrecionit që gëzon Këshilli i Lartë i Drejtësisë është ende shumë e gjerë dhe duhet reduktuar. Procedura për emërimin e gjyqtarëve administrative ende nuk është finalizuar.

Shkolla e Magjistraturës vazhdoi të ofrojë programe mësimore cilësore dhe procesi i pranimit të kandidatëve raportohet se është transparent dhe bazuar në meritë. Shkolla vazhdon të përballet me probleme për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm.

Duhet të garantohet caktimi i rastësishëm i çështjeve nëpërmjet sistemit të unifikuar të administrimit të çështjeve, i cili është shtrirë në gjykatat e Tiranës, përveç Gjykatës së Krimeve të Rënda. Regjistrimi audio që përdoret në 19 gjykata rrethi dhe apeli, duhet të shtrihet më tej.

Publikimi i vendimeve gjyqësore, që nuk është i garantuar plotësisht, duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet të ndiqen rekomandimet përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale. Nuk është bërë përparim në përditësimin e databazës elektronike në Qendrën e Dokumentacionit Gjyqësor.

Në lidhje me **llogaridhënien** në gjyqësor, memorandumit i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë për inspektimet është zbatuar normalisht. Megjithatë, rreziku i mbivendosjeve do të ekzistojë, për sa kohë nuk ndryshohet Ligji për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Një manual i praktikave të mira për inspektimin u publiku në fund të vitit 2012 dhe shërbimi i inspektimit i Këshillit të Lartë të Drejtësisë po riorganizohet, por rregullat e reja mbi inspektimin ende nuk janë hartuar. Procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve janë zbatuar vetëm në pak raste. Fuqia për të hapur dhe mbyllur një procedim disiplinor është akoma kompetencë ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë, gjë që bie ndesh me standardet e BE-së.

Përparim i kufizuar është bërë në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor. Në prill u miratua një rritje modeste e pagave të magistratëve (rreth 7% për gjyqtarët e apelit dhe 20% për gjyqtarët e shkallës së parë). Korrupsioni në sistemin gjyqësor vazhdon mbetet shqetësues. Reforma kushtetuese që nisi në 2012 për kufizimin e imunitetit të gjyqtarëve ende nuk është zbatuar. Ende nuk janë miratuar ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale që mundësojnë arrestimin e gjyqtarëve si edhe kontrollin e tyre personal dhe shtëpiak. Kodi i etikës ka shërbyer si bazë për disa procedime disiplinore ndaj gjyqtarëve, por zbatimi i tij mbetet për t'u garantuar plotësisht. Impakti i procedurës *online* që iu mundëson qytetarëve të bëjnë ankesa ndaj gjyqtarëve dhe procedimeve gjyqësore mbetet për t'u vlerësuar. Nuk ka pasur përparim në përmirësimin e hartimit të vendimeve gjyqësore, sidomos për sa i përket arsytimit. Për më tepër, vendimet gjyqësore jepen në përgjithësi pa arsytim, që në shumicën e rasteve jepet pas një vonese të konsiderueshme.

Mungesa e llogaridhënies e Prokurorisë së Përgjithshme është shqetësuese. Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç të Prokurorisë duhet të jenë transparence dhe të paanshme, ndërsa roli i Këshillit të Prokurorëve duhet të përforcohet.

Për sa i përket **efiçencës së gjyqësorit**, në nëntor Presidenti miratoi riorganizimin territorial të gjykatave dhe rialokimin e numrit të gjyqtarëve, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë dhe pëlqim të Këshillit të Lartë. Dispozitat e reja nuk janë zbatuar në shumë aspekte. Ligji i ri për administratën gjyqësore ofron kuadrin ligjor të shumëpritur që disiplinon punën e gjykatave dhe stafit gjyqësor.

Ligji nuk garanton pavarësinë e kancelarëve të gjykatës, kryesisht sepse nuk u jep statusin e nëpunësit civil. Duhet të hartohen dhe të miratohen aktet nënligjore. Nevojitet trajnim adekuat i stafit të gjykatave. Janë bërë disa përparime në kushtet e punës në gjykatave, por ka ende raste të seancave që zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve. Ende nuk ka një regjistër civil të saktë me sistem adresash. Buxheti i akorduar për gjykatat dhe stafin e gjykatave mbetet i pamjaftueshëm.

Buxheti 2013 për gjyqësorin ishte pak më i lartë sesa në 2012, konkretisht 77 milion Euro, që përbën 0.8% të PBB-së dhe 2.6% të buxhetit të shtetit.

Kodi Penal u ndryshua për të futur shkelje të reja dhe dënime më të ashpra për disa krime, duke e përafuar Kodin shqiptar me disa standarde evropiane dhe konventa ndërkombëtare, përfshi atë për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve. Kodi i Procedurës Civile i ndryshuar reformoi procedurat që aplikon Gjykata e Lartë duke ngritur një panel me vetëm tre gjyqtarë për shumicën e çështjeve. Gjithashtu, kufizon kompetencat civile të Gjykatës, duke përjashtuar apelit mbi baza procedurale. Po diskutohet nëse këto ndryshime ligjore vlejné edhe për çështjet që janë pezull në gjykatat e nivelit më të ulët; nëse ndryshimet nuk janë të zbatueshme për këto çështje, kjo do të



vonojë ndjeshëm impaktin e tyre pozitiv. Janë miratuar ndryshime në Kod për njoftimin elektronik, procesverbalin elektronik dhe standardizimin e procedurave të ekzekutimit. Në Kodin Civil u miratuan ndryshime që thjeshtojnë procedurën e trashëgimisë. Në tërësi, reformimi i Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile pritet të reduktojë çështjet e akumuluarra dhe të shpejtojë procedimet gjyqësore, duke përmirësuar kështu efikasitetin.

Zbatimi i Ligjit për Avokatinë (2012) po vazhdon; është emëruar drejtori i Shkollës së Avokatisë dhe komisioni i disiplinës ka filluar të funksionojë. Ende nuk është adresuar çështja e dhënies së kompetencës gjyqësore që të ndëshkohen me efektivitet avokatët për pengim të drejtësisë dhe për mungesat e përsëritura në seanca të çështjeve civile dhe penale. Mosefiçenca dhe zvarritja e procedimeve gjyqësore si edhe akumulimi i tyre (27 623 dhe 24 415 çështje pezull në gjykatat e rrethit dhe gjykatat e apelit në janar 2012 dhe janar 2011) mbeten shqetësuese.

Në qershor, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi një Rezolutë ku i bën thirrje Shqipërisë të përgatitë një plan veprimi për ngritjen e një mekanizimi efektiv kompensimi, në mënyrë që vendimet në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave të shtetëzuara gjatë regjimit komunist të mund të ekzekutohen. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, sidomos kur kanë të bëjnë me institucionet shtetërore, mbetet një problem serioz.

Përmbartimi privat realizon ekzekutimet në shumicën e çështjeve civile. Nuk ka informacion preciz për përqindjen e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore apo për kohën që kërkon ekzekutimi. Sistemi përmbartim i administrimit të çështjeve ende nuk është i lidhur me sistemin që përdorin gjykatat. Në lidhje me Ligjin për Ndërmjetësimin, Dhoma e Ndërmjetësuesve u ngrit në korrik. Ndryshimet në Ligjin për Arbitrazhin kanë mbetur pezull.

Në shkurt, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi dënimet e dhëna nga Gjykata e Rrethit (2012) në të ashtuquajturën çështje të Gërdecit (shpërthimi në vitin 2008 që shkaktoi 26 viktima dhe mbi 300 të lënduar), por uli më tej dënimet e dhëna për disa nga 29 të pandehurit, ndërkohë që të tjerët i nxori në lirim me kusht. Si prokuroria edhe të pandehurit paraqitën ankime në Gjykatën e Lartë. Paralelisht, akuzat ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes u rrëzuan në fund të 2012, pas një amnistie të përgjithshme të dhënë për 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Në maj, të afërmit e viktimave paraqitën një ankim kundër këtij vendimi pranë Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.

Në lidhje me vdekjen e katër demonstruesve në ngjarjet e 21 janarit 2011, në shkurt Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli të pafajshëm tre të pandehurit e akuzuar për përfshirje në incident.

Gjykata gjykoi se formulimi i akuzave nga prokuroria nuk justifikon verdiktin “vrasje me dashje”, që ishte në qendër të akuzës. Prokuroria e Përgjithshme e ankoi këtë vendim që ngjalli polemika të forta. Në shtator, Gjykata e Apelit Tiranë e shfuqizoi vendimin e pafajësisë dhe dha dënime me burg, përkatësisht një vit dhe tre vite për dy të pandehur për vrasje pa dashje, ndërsa Prokuroria kishte kërkuar përkatësisht 21 dhe 23 vjet.

Për sa i përket **aksesit në drejtësi**, Ligji për Ndihmën Juridike u ndryshua në maj, me qëllim përjashtimin e viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje nga tarifat gjyqësore, si edhe ngritjen e zyrave vendore të ndihmës juridike. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike iu kërroi avokatëve të aplikojnë që të renditen si avokatë falas të ndihmës juridike. Zbatimi i ligjit ka ecur shumë ngadalë dhe buxheti për zyrat vendore që do të ngrihen në planin afatshkurtër është i pamjaftueshëm. Pavarësisht ndryshimeve të miratuara në maj, aksesit në drejtësi është penguar

nga tarifat e larta gjyqësore. Aplikantët që kërkojnë ndihmë juridike falas duhet të dorëzojnë shumë dokumente nga institucione shtetërore të ndryshme. Pjesa më e madhe e ndihmës juridike falas jepet nga shoqëria civile.

Një grup ish të burgosurish politikë organizoi grevë urie në vjeshtën e kaluar, me pretendimin se ka pasur mangësi në zbatimin e Ligjit (2007) për kompensimin dhe të drejtën e kompensimit dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.

### *Politika antikorruption*

Zbatimi i Strategjisë Antikorruption ka avancuar. Shqipëria zbatoi të gjitha rekomandimet e raundit të tretë vlerësues të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), sidomos duke forcuar kuadrin ligjor për transparencën e financimit të partive politike.

Vihen re një vijimësi rezultatesh (track record). Gjatë 6-mujorit të parë të 2013, dënimet në gjykatat e rrethit u rritën me 21% duke arritur në 94 çështje, kundrejt të njëjtës periudhë në 2012, ndërsa dënimet në gjykatat e apelit u rritën me më shumë se dyfish, duke arritur në 56 çështje. Çështjet preknin një sërë sektorësh, si shëndetësia dhe arsimi. Në lidhje me korrupsionin në nivelin e lartë, katër të pandehur u dënuan gjatë 6-mujorit të parë të 2013. Pas ndryshimeve kushtetuese që kufizojnë imunitetin e zyrtarëve të lartë publikë dhe gjyqtarëve, Kodi i Procedurës Penale duhet të ndryshohet për të qartësuar procedurat hetimore përkatëse.

Inspektimet e kryera nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Korrupsionit (DKBA) kanë vijuar. Sidoqoftë, ekziston nevoja për ta qartësuar rolin e DKBA-së dhe të rriten kapacitetet në këtë fushë. Duhet të realizohet një vlerësim i kuadrit të të gjithë institucioneve që merren me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, përfshi rolin, funksionimin dhe impaktin e këtyre institucioneve dhe koordinimin e tyre. Nevojitet efektivitet në raportim, koordinim politikash dhe monitorim në nivel qendror.

Memorandumi i Mirëkuptimit (MiM) ndërmjet Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (ILDKP) dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka mbetur pezull. Mbetet për t'u bërë një vlerësim për zbatimin e Memorandumeve ekzistuese. Duhet të vlerësohet impakti i ndryshimeve në Ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë.

Zbatimi i marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit me Shërbimin Doganor dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor po ecën mirë. Ka përfunduar regjistri elektronik për noteritë ku aktet regjistrohen sipas një sistemi kombëtar të centralizuar. Ende nuk ka përfunduar digjitalizimi i informacionit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Numri i rasteve të korrupsionit të hetuara nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore është rritur me 28% në 2012 krahasuar me 2011, ndërsa rastet e dërguara për gjykim u shtuan me 52% në 2012. Edhe ILDKP vazhdoi të zbulojë raste deklarimesh të dyshimta të pasurisë. Megjithatë, numri i hetimeve dhe dënimeve mbetet përgjithësisht i ulët. Ekziston nevoja e përmirësimit të kapaciteteve audituese të ILDKP-së. Duhet të përforcohet koordinimi ndërmjet institucioneve dhe hetimi i mëtejshëm i këtyre rasteve. Në përgjithësi, hetimet vazhdojnë të kenë më shumë natyrë pasive sesa proaktive (kryesisht), dhe vlerësimi i riskut nga korrupsioni nuk kryhet sistematikisht.

Institucionet shtetërore që merren me luftën kundër korrupsionit janë të cenueshme ndaj presionit

dhe influencës politike. Është veçanërisht e rëndësishme të garantohen kritere transparence dhe mbi baza merite për emërimet dhe largimet nga puna. Roli i shoqërisë civile vazhdon të jetë i kufizuar, pavarësisht një rritjeje kohët e fundit të përdorimit të medias sociale si mjet për të tërhequr vëmendjen drejt ankesave dhe denoncimit të abuzimeve.

Përdorimi i sistemit të monitorimit me kamera 24 orë është shtrirë në të gjitha pikat doganore kufitare. Gjatë 2012, pati hetime disiplinore ndaj 28 punonjësve të doganës, kryesisht për mitëmarrje të vogla. Numri i hetimeve proaktive dhe vlerësimi i riskut në shërbimin doganor duhet të forcohet. Korrupsioni në shërbimin tatimor mbetet një çështje shqetësuese.

Ka filluar të ndërtohet një vijimësi rezultatesh (track record) të masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Megjithatë, nuk ka një sistem efektiv për deklarimin dhe verifikimin e pasurisë. Rreziku i korrupsionit dhe influencës së paligjshme në lidhje me transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve nuk është adresuar mjaftueshëm. Korrupsioni në gjyqësor mbetet një problem veçanërisht serioz.

Inspektimet në institucionet e arsimit të lartë kanë vazhduar. Procedurat *online* për provimet e Maturës Shtetërore u zhvilluan më tej dhe u miratua një kod etike i ri për mësuesit. Janë marrë masa kohët e fundit për të centralizuar prokurimin e medikamenteve, me qëllim adresimin e problemeve të korrupsionit në sektorin shëndetësor. Është vendosur një linjë telefoni falas për qytetarët që të denoncojnë rastet e korrupsionit në radhët e personelit mjekësor. Efektiviteti i këtyre masave mbetet të vlerësohet. Korrupsioni në sektorin shëndetësor mbetet një çështje shqetësuese.

Është rritur numri i pikave të kontaktit (numat e telefonit falas, adresat e-mail) ku qytetarët mund të japin informacion mbi rastet e korrupsionit. Lind nevoja që të vlerësohet efektiviteti i tyre dhe i masave që merren pas denoncimeve.

#### *Të drejtat themelore*

Lidhur me **instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**, Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj Opsional, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me një procedurë të komunikimit. Vonesat në zbatim dhe mos-përputhja me gjykimet e **Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**, në veçanti në lidhje me të drejtat pronësore dhe e drejta për një gjykim të drejtë, mbetën një shqetësim. Gjykata ka dorëzuar gjykimet për 6 kërkesa duke gjetur se Shqipëria kishte shkelur të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Një total prej 143 kërkesa janë dorëzuar në Gjykatë që nga shtatori i 2012, duke e çuar numrin e përgjithshëm të kërkesave në pritje në 446.

Janë marrë masa për forcimin e **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit**, një tjetër fushë kjo e mbuluar nga një prej prioriteteve kyç të Opinionit. Në 2013, Policia e Shtetit ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me një organizatë të tretë të shoqërisë civile për monitorimin e mjediseve të privimit të lirisë, përfshi edhe vizitat e pa-njoftuara. Të gjithë oficerët e policisë janë trajnuar për të drejtat e njeriut; kjo gjë nuk është shtrirë në personelin civil si p.sh. mjekët ose psikologët që punojnë brenda forcave të policisë. Protokollin e Stambollit për dokumentimin e rasteve të keq-trajtimit përdoret në të gjitha burgjet dhe është prezantuar në

drejtoritë e policisë së qarqeve. Udhëzimet dhe protokollet për menaxhimin e grevës së urisë janë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në vitin 2013.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës e rriti numrin e inspektimeve me 41%, nga 98 në 138. Numri i rekomandimeve është rritur nga 37 në 53. Avokati i Popullit ka marrë 107 ankesa ndaj Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me një rënie prej 48%. Shumica e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për keqtrajtimin është adresuar nga DP e Burgjeve dhe Policia e Shtetit.

Operacionet e mekanizmit janë penguar nga mosrespektimi i rekomandimeve nga institucionet shtetërore dhe buxheti i pamjaftueshëm, sidomos për pajtimin e ekspertizës dhe monitorimin e vizitave në mjediset e burgimit. Vetëm shtatë komisariateve të policisë përmbushin standardet e infrastrukturës së qelive. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi miratoi një vendim kundër një punonjësi të Policisë së Shtetit në gjysmën e parët të 2013.

Pas miratimit në 2012 të Ligjit për Shëndetin Mendor, Ministria e Shëndetësisë që është përgjegjëse për trajtimin e specializuar të personave të sëmurë mendorë në institucionet e vuajtjes së dënimit, nuk ka punësuar staf shtesë psikiatrik dhe psikologjik, dhe as nuk ka akorduar një buxhet për përmirësimin e kushteve të jetesës. Vazhdon të ketë shqetësime për shpërndarjen dhe mjaftueshmërinë e medikamenteve, sidomos në burgje jashtë kryeqytetit. Pak përparim është bërë në ngritjen e një institucioni të specializuar për të burgosurit e sëmurë mendorë nën trajtim të detyrueshëm. Personat e sëmurë mendorë në Institutin e Krujës vazhdojnë të mbahen në burg, që do të thotë se parandalimi i keqtrajtimit dhe trajtimit degradues nuk është garantuar.

Për sa i përket **sistemit të burgjeve**, Shërbimi i Provës u shtri edhe në katër qarqe dhe numri i stafit është rritur. Në mars, filloi një program pilot i monitorimit elektronik si një alternative ndaj burgosjes, me një kapacitet prej 300 të dënuarish. Për të burgosurit është vënë në dispozicion një sistem kartash debiti dhe një sistem menaxhimi i dënimit. Vazhdon të ketë shqetësime për privatësinë, sidomos për mjediset e vizitave me sistemin "me një stol" apo mungesa e kapuçave të privatësisë në telefonat me pagesë në burg.

Për të garantuar të drejtën për shkollim të të miturve në institucione të privimit të lirisë, është caktuar staf mësimor në këto institucione. Në burgje janë hapur qendra të reja arsimore, si dhe janë futur programe të reja për 18-21 vjeçarët si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Nevojitet më shumë buxhet dhe materiale didaktike për të garantuar shkollimin e detyruar të gjithë të miturve. Burimet njerëzore dhe financiare për organizatat e shoqërisë civile të certifikuara për të mbikëqyrur punën me të miturit duhet të shtohen, ashtu si buxheti për të garantuar efektivitetin e shërbimit të provës.

Infrastruktura e dobët dhe problemet e mirëmbajtjes të infrastrukturës së ndërtuar rishtazi mbeten shqetësuese në shumë burgje, përfshi seksionet e paraburgimit. Mbipopullimi është pakësuar, por ende vazhdon në disa seksione paraburgimi. Të burgosurit sigurojnë ushqimin, pajisjet dhe ilaçet nga familjet e tyre. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të shtojnë përdorimin e alternativave ndaj burgosjes. Të burgosurit që punojnë, edhe pse të paktë në numër, përfitojnë ulje të dënimit në vend të shpërblimit monetar. Kuadri ligjor për pagesat e skemës së punësimit duhet të përmirësohet. Përpjekjet kundër korrupsionit në burgje duhet të përforcohen.

Në fushën e **lirisë së shprehjes**, Ligji për median audiovizive u miratua në mars, duke përmirësuar ndjeshëm kuadrin normativ për median audiovizive në Shqipëri. Ligji nuk arrin të japë një

procedurë përzgjedhjeje për organet drejtuese të Rregullatorit dhe Transmetuesit Publik, që të garantojë pavarësinë e tyre. Moratoriumi për padite gjyqësore për shpifje nga zyrtarët shtetërorë është respektuar. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin e duhur të ndryshimeve ligjore për shpifjen, si edhe udhëzime për përcaktimin e një niveli të arsyeshëm të dëmit, sidomos përmes trajnimit të gjyqësorit. Nuk është ndryshuar mënyra e arkëtimit të taksës së transmetuesit publik dhe mbetet shqetësimi mbi pavarësinë e tij editoriale.

Janë raportuar disa raste dhune ndaj gazetarëve. Media vazhdon të përdoret si mjet për të promovuar interesa ekonomike politike dhe private. Reklamata publike ende nuk janë rregulluar në një mënyrë që garanton ndarje transparente dhe jodiskriminuese të fondeve. Mungesa e transparencës në financimin e medias mbetet një sfidë e rëndësishme. Nevojiten përpjekje të mëtejshme, sidomos nga Inspektorati Shtetëror i Punës, për të garantuar zbatimin e të drejtave të punës, veçanërisht të drejtën e punonjësve të medias për të pasur një kontratë pune të ligjshme. Mbrojtja nga largimi arbitrar është vendimtar për të parandaluar autocensurën. Kapacitetet e sindikatave të gazetarëve mbeten të dobëta. Standardet profesionale dhe etike në gazetari duhet të forcohen. Duhet të adresohen shqetësimet për privatësinë në raportin, përfshi rastet e të miturve dhe grupeve vulnerabël. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të garantuar trajtimin e ankesave të lexuesve/shikuesve në mënyrë efikase dhe të paanshme.

**Liria e tubimit dhe e organizimit** është respektuar në përgjithësi.

**Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit** është respektuar në përgjithësi.

Një hap pozitiv në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore u mor në maj, me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal që e cilësojnë përdhunimin dhe dhunën seksuale në martesë si një vepër penale. Mekanizmi i referimit për dhunën në familje duhet të konsolidohet më tej, koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore duhet të përmirësohet, si edhe duhet të ngrihen strukturat që mungojnë, konkretisht streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat. Disa kode dhe ligje vazhdojnë të kenë dispozita me diskriminim gjinor. Vendimet e gjykatave treguan shenja të njëanshmërie gjinore. Zbatimi i politikave në mbrojtje të grave kundër çdo forme dhune duhet të përforcohet. Plot 50% e grave që i janë drejtuar gjykatës për mbrojtje, e kanë tërhequr më vonë këtë kërkesë. Janë rritur ndjeshëm rastet e raportuara të dhunës së rëndë në familje. Duhet të vendoset një numër telefonik falas dhe një sistem për kompensimin e viktimave. Streha kombëtare për viktimat e dhunës në familje aplikon kritere pranimi që janë kufizuese dhe të panevojshme, si dhe ka pak mjedise për nevoja urgjente. As strehat e drejtuara nga OJF-të dhe as viktimat nuk marrin ndihmë financiare nga shteti. Programi i ri-integritimit për viktimat është minimal.

Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në postet publike. Në zgjedhjet e përgjithshme të 20013, tri partitë më të mëdha u gjobitën për mosrespektim të kuotës gjinore në listën e kandidatëve për deputetë. Kuota gjinore është respektuar në përbërjen e qeverisë së re me gjashtë ministre. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të siguruar zbatimin e ligjeve dhe politikave për të drejtat e grave. Disa autoritete vendore filluan përfshirjen e dimensionit gjinor në përgatitjen e strategjive të zhvillimit vendor. Në nivel qendror, katër ministri kanë bërë përpjekje për përfshirjen e dimensionit gjinor.

Në fushën e **të drejtave të fëmijëve**, ndryshimet në Kodin Penal të miratuara në maj e bënë vepër penale mbajtjen e materialeve pornografike me fëmijët dhe trafikimin e fëmijëve vepër. Në bashki

dhe komuna janë 155 njësi të mbrojtjes së fëmijëve (NjMF). Nga 155 specialistë të NjMF-ve, vetëm 25 punojnë me kohë të plotë, ndërsa të tjerët janë kryesisht punonjës socialë. Numri i NjMF-ve duhet të rritet ndjeshëm me qëllim që të garantohet mbrojtje e qenësishme e fëmijëve dhe e fëmijëve vulnerabël. Kapacitetet e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të forcohen. Sistemit të mbrojtjes së fëmijës i mungon buxheti i mjaftueshëm, qëndrueshmëria e stafit dhe standardet bazë të punës, sidomos protokollet dhe kërkesat ligjore. Linja telefonike kombëtare në ndihmë të fëmijëve që ofron shërbim emergjence dhe referimi, drejtohet nga një organizatë jofitimprurëse me financim të donatorëve. Deinstitutionalizimi nuk ka avancuar. Shtëpitë e kujdesit nuk janë zgjeruar. Mbrojtja e veçantë për fëmijët në institucione rezidenciale nuk garantohet sistematikisht. Emigrimi i të miturve të pashoqëruar, kryesisht romë, nga Shqipëria drejt BE-së vazhdon të jetë sfidë. Vazhdojnë rastet e ngujimit të fëmijëve në shtëpi nga frika e gjakmarrjes.

Strategjia dhe plani i veprimit për *drejtësinë e të miturve* nuk janë miratuar. Janë raportuar raste keqtrajtimi të të miturve në mjediset e ndalimit. Komisariatet e policisë nuk kanë dhoma të veçanta për fëmijët nën 14 vjeç që kanë kryer krime, si edhe jo gjithmonë është i pranishëm psikologu gjatë marrjeve në pyetje pasdite ose mbrëmjeve.

Përparim i kufizuar është bërë në trajtimin e të miturve në komisarate policie. Nuk janë marrë masa specifike për të adresuar mbajtjen e të miturve në paraburgim për një periudhë të gjatë. Asistenca psiko-sociale dhe programet e rehabilitimit të të miturve janë të mbështetura nga donatorët. Nuk është ngritur një sistem mbështetës për ri-integrimin e të miturve pas daljes nga institucionet shtetërore.

Në lidhje me *punën e fëmijëve*, mbetet shumë i lartë numri i fëmijëve (kryesisht romë) që punojnë ose lypin në rrugë dhe janë objekt i formave më të këqija të shfrytëzimit dhe marginalizimit ekstrem. Anketa e parë kombëtare për punën e fëmijëve, e kryer në maj 2010 (publikuar në maj 2013) vlerëson se punojnë 7.7% e të gjithë fëmijëve shqiptarë të grupmoshës 5-17 vjeç. Raporti vlerëson se mbi 5% e të gjithë fëmijëve të grupmoshës 5-17 vjeç punojnë në aktivitete ekonomike të rrezikshme, me orë shumë të tejkjatura ose nën kushte të rrezikshme. Duhet të përmirësohen statistikat mbi shpërndarjen e fëmijëve punëtorë sipas grupmoshave, duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit të Punës mbi moshën minimale për punë.

Shteti nuk ka marrë asnjë masë efektive për të adresuar punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve. Nevojitet një sistem mbrojtje për fëmijët që ofron shërbime mbështetëse të specializuara për fëmijët në rrezik abuzimi apo shfrytëzimi, duke mbështetur më fuqishëm familjet në vështirësi dhe shërbimet me bazë komuniteti. Nuk janë marrë masa adekuate që fëmijët e abuzuar seksualisht të kenë shërbime të specializuara.

Duhet të ngrihen mekanizma zbatimi dhe monitorimi, me qëllim që të garantohet **mbrojtja e personave vulnerabël dhe/ose personave me aftësi të kufizuara**. Nevojat e personave me aftësi të kufizuara nuk janë marrë në konsideratë në programet dhe planet buxhetore të ministrive të linjës. Vazhdon të ketë status të diferencuar për disa aftësi të kufizuara. Janë raportuar vonesa në pagesën e ndihmës së invaliditetit. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi për të pasur akses në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale apo vendimmarrje. Në zgjedhjet e qershorit nuk është garantuar akses i plotë dhe fshehtësia e votës për personat me aftësi të kufizuara

Shqipëria ka bërë një sërë hapash të rëndësishëm në fushën e **politikave anti-diskriminim**. Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit ka trajtuar një sërë çështjesh dhe në qershor, Gjykata e Rrethit Fier dha të parin vendim gjyqësor për një çështje diskriminimi, duke vendosur në favor të një punonjëseje që ishte trajtuar në mënyrë diskriminuese në vendin e punës. Sensibilizimi publik mbi Ligjin për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit dhe për mekanizmat ankimes mbetet i ulët. Zbatimi i ligjit duhet të forcohet më tej; në këtë kontekst, viktimat e diskriminimit duhet të inkurajohen që të denoncojnë dhe kështu të krijohet një praktikë gjyqësore solide. Nevojiten një qartësim i roleve të Avokatit të Popullit si edhe të Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, me qëllim që të dy zyrat të bëhen më efektive. Vazhdon të ketë diskriminim ndaj minoritet rom dhe grupeve të tjera vulnerabël.

Në dhjetor, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta prezantoi planin e veprimit për të drejtat e personave **lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI)**. Ndryshimet në Kodin Penal ashpërsojnë dënimet për shkeljet me bazë gjinie, race, etnie, identiteti gjinor, orientimi seksual, besimi fetar, feje, statusi shëndetësor, predispozite gjenetike apo aftësie të kufizuar. Në maj, kryeministri Berisha dhe kryetari i opozitës i atëhershëm, Rama u takuan me përfaqësues të komunitetit LGBTI, duke dhënë një shembull të pagabueshëm për qëndrimin anti-diskriminues në shoqërinë shqiptare. Janë bërë hapat e parë për të rishikuar librat shkollorë me qëllim që të eliminohen stereotipet që nxitin diskriminimin. Ka pasur raste deklaratash homofobe pa ndjekje gjyqësore. Duhet të ngrihet një grup pune ndërministror për të garantuar zbatimin e planit të veprimit për të drejtat e personave LGBTI.

**Të drejtat e punës dhe të bashkimit në sindikata** janë respektuar në përgjithësi. Ndryshimet në Kodin e Punës pritet janë në pritje të miratimit. Dialogu social trepalësh është ndërprerë prej përfundimit të mandatit të Këshillit Kombëtar të Punës në mars 2013. Dialogu social dypalësh mbetet i dobët, sidomos në sektorin privat.

Për sa i përket të **drejtave të pronësisë**, prioritet kyç i Opinionit, strategjia e reformës së pronësisë e miratuar në vitin 2012 është në fazë zbatimi, megjithatë, shumë pak përparim është bërë në lidhje me zbatimin e objektivave strategjike kyçe si finalizimi i regjistrimit të pronës, kthimi i pronës, kompensimit edhe legalizimi. Plani i Veprimit duhet të rishikohet në mënyrë që të jetë realist dhe i qëndrueshëm, për sa i përket objektivave dhe burimeve të financimit. Qeveria krijoi tre struktura monitorimi dhe konsultimi për zbatimin e tij. Bashkëpunimi midis institucioneve vazhdon të jetë shumë i dobët. Regjistrimi fillestar i pronës ka pasur përparim të kufizuar. Nuk ka pasur përparim në integrimin e databazave elektronike të të territorit dhe pronave. Përpjekje të shumta janë bërë për dixhitalizimin e informacionit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), por nuk ka pasur koordinim me databazat e institucioneve të tjera publike. Qeveria ka ndërmarrë disa masa normative për të përshpejtuar procesin e legalizimit të ndërtesave, por legalizimi nuk ka avancuar në praktikë. Është miratuar një metodologji e re për vlerësimin e tokës dhe një hartë e vlerës së tokës për secilin qark. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) ka nisur procesin e kompensimit financiar të pronarëve të shpronësimi për shkak të procesit të legalizimit. Qeveria ka miratuar disa vendime në lidhje me kriteret dhe procedurat për transferimin e pronësisë së tokës bujqësore dhe të tokës bujqësore të ish-kooperativave bujqësore. Është miratuar një akt normativ për lirimin e banesave dhe kthimin e tyre ish-pronarëve, i cili është zbatuar pa marrë në konsideratë të drejtën e strehimit për personat vulnerabël. Kërkesat e ish-pronarëve për kompensimin dhe kthimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist mbeten të pazgjidhura. Qeveria ende nuk ka shpallur një plan veprimi të qartë

dhe një kalendar për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtën e pronësisë.

Për sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së **minoriteteve**, marrëdhëniet ndëretnike kanë qëndruar të mira në përgjithësi. Duhet të merren masa për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut, integritimin dhe përfshirjen sociale në praktikë, si p.sh. përkufizimi i qartë i minoriteteve në legjislacionin shqiptar. Mandati i Komitetit Shtetëror për Minoritetet nuk është forcuar. Miratimi i legjislacionit gjithëpërfshirës për minoritetet, pas një procesi të gjatë konsultimi dhe duke pasqyruar rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (KKMMK), do të ndihmonte në identifikimin e boshllëqeve ligjore dhe qartësimin e politikave shtetërore për minoritetet. Duhet të merren masa afatshkurtra që sigurojnë akses të barabartë në praktikë për personat që u përkasin të gjitha minoriteteve në Shqipëri, duke mënjanuar çfarëdo bazash për trajtim të diferencuar ndërmjet kategorive të minoriteteve kombëtare dhe etno-gjuhësore, si edhe të forcohet roli përfaqësues dhe konsultues të Komitetit Shtetëror për Minoritetet. Rezultatet e Censurit për Popullsinë dhe Banesat u kundërshtuan nga përfaqësuesit e minoriteteve, përfshi disa shoqata Rome dhe Egjiptiane, të cilat pretendojnë se të dhënat nuk pasqyrojnë realitetin në terren. Të dhënat e mbledhura nga ky Census nuk duhet të jenë burimi i vetëm i informacionit për plotësimin e kuadrit ligjor dhe politik për minoritetet. Për sa i përket të **drejtave kulturore**, me mbështetjen ndërpartiake parlamentare është rivendosur emri tradicional minoritar i një bashkie, por duhet të përmirësohet përdorimi i gjuhëve minoritare. Shqipëria nuk ka miratuar Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare. E drejta e arsimit publik në gjuhën e minoritetit nuk është ende e disponueshme për të gjitha grupet minoritare.

Për sa i përket përfshirjes së **Romëve**, vazhdon të jetë i pamjaftueshëm zbatimi i politikave si edhe i përfundimeve operacionale të seminarit në dhjetor 2011 për përfshirjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane në kuadrin e integritimit evropian. Romët edhe egjiptianët ende përballen me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim të vazhdueshëm, veçanërisht për sa i përket aksesit në arsim, mbrojtje sociale, shëndetësi, punësim dhe strehim.

Në zbatim të Planit kombëtar të Veprimit, Shqipëria duhet të përmirësojë shpejt kushtet e jetesës të komunitetit Rom; në këtë kuadër, është thelbësor koordinimi i administratës publike në nivel qendror dhe vendor. Dëbimi i familjeve rome nga vendbanimet e tyre në gusht 2013 ka qenë një çështje veçanërisht shqetësuese. Duhet të përmirësohet sa më shpejt aksesit në shkollim dhe integrimi i fëmijëve rom tyre në sistemin shkollor, nga nivel parashkollor deri në arsimin e lartë. Mekanizmat shtetërorë për mbrojtjen e fëmijëve romë janë të pamjaftueshëm.

Udhëzime të reja janë miratuar në fushën e **mbrojtjes së të dhënave personale**. Vazhdon të mos merret mendimi i Komisionerit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale gjatë hartimit të akteve normative të reja. Përfshirja e tij në proces është rritur në praktikë. Komisioneri ka bërë rekomandime të shumta për masa korrigjuese. Është rritur numri i inspektimeve dhe i veprimtarive sensibilizuese. Është vënë në dispozicion një numër pa pagesë për ankesat e qytetarëve.

### *Përfundim*

*Në tërësi*, Shqipëria ka bërë disa përmirësime në reformën gjyqësore falë miratimit të disa politikave për përmbushjen e prioritetëve kyçe. Vazhdon të ketë hendek të thellë mes kuadrit



ligjor dhe zbatimit të legjislacionit. Nevojitet reformim i mëtejshëm kushtetues.

Përparim është bërë edhe në luftën kundër korrupsionit. Bashkëpunimi midis institucioneve dhe shkëmbimi i informacionit është përmirësuar. Shqipëria i ka përmbushur të gjitha rekomandimet e raundit të tretë të vlerësimit të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), kryesisht duke forcuar kuadrin normativ për transparencën e fondeve të partive politike. Vijimësia e rezultateve (track record) përfshin disa fusha dhe nivele të ndryshme, si p.sh. rastet e korrupsionit në nivelet e larta, duke dëshmuar për rritje të dënimeve. Duhet të bëhet një vlerësim i kuadrit institucional në tërësi, përfshirë rolin dhe veprimtarinë e institucioneve më të rëndësishme dhe koordinimin e tyre. Duhet të forcohen institucionet e pavarura. Duhet të rishikohet alokimi i burimeve dhe të përforcohet efikasiteti edhe kapaciteti veprues i institucioneve ligjzbatuese. Gjithashtu, duhet të krijohet një vijimësi rezultatesh i ndjekjeve penale në të gjitha nivelet. Në disa fusha të të drejtave themelore, kuadri normativ është përmirësuar dhe janë ndërmarrë disa nisma konkrete. Zbatimi mbetet pas në përgjithësi, sidomos në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrezik abuzimi apo shfrytëzimi dhe komuniteti Rom. Janë të nevojshme përpjeke të qëndrueshme në fushën e të drejtës së pronësisë përmes masave koherente dhe të besueshme. Shqipëria duhet të miratojë dhe të shpallë një plan të besueshëm për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtën e pronës. Pjesa më e madhe e rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbi keqtrajtimet janë adresuar nga institucionet e burgosjes dhe Policia e Shtetit; prioriteti kyç për trajtimin e të burgosurve është përmbushur.

#### 4.24. Kapitulli 24. Drejtësia, liria dhe siguria

Në fushën e politikës së **migracionit**, ka vazhduar përparimi me mbledhjen dhe publikimin e informacionit analitik mbi migracion e ligjshëm dhe të jashtëligjshëm. Zbatimi i marrëveshjes së ripranimit ka vazhduar. Në 2012-ën u regjistruan 10 129 raste kthimi, duke vazhduar kurbën në rënie që filloi me hyrjen në fuqi të liberalizimit të vizave. Megjithatë, duhet të forcohen burimet teknike dhe financiare të Policisë Kufitare dhe Migracionit (PKM) në mënyrë që të jetë në gjendje të kontrollojë flukset e migracionit klandestin në Puna për përgatitjen e strategjisë kombëtare për migracionin ende nuk ka filluar. Strategjia dhe plani i veprimit për emigrantët e kthyer duhet të zbatohet dhe institucionet përkatëse duhet të mbështeten. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazë të hershme.

Është hartuar ligji i ri për **azilit**. Deri në maj 2013, Shqipëria u ka dhënë dha azil 89 individëve, me 150 aplikime të tjera në pritje. Refugjatët dhe personat me mbrojtje plotësuese nuk janë pajisur ende me dokumente identifikimi. Duhet të forcohet kontrolli paraprak në kufi, nisur nga rritja e flukseve migratore, si edhe azilkërkuesve u duhet siguruar mbrojtje ndërkombëtare efektive. Përgatitjet kanë përparuar në masë të moderuar.

Në fushën e **politikave për vizat**, në mars është miratuar ligji i ri “Për të huajt” që synon përafrimin me *acquis* në lidhje me politikën e vizave afatshkurtra. Megjithatë, Shqipëria ka përafruar vetëm pjesërisht legjislacionin me listat pozitive dhe negative të BE-së që përmban Rregullorja 539/2001. Zbatimi i regjimit pa viza me BE-në vazhdoi normalisht në përgjithësi. Edhe pse shumica e udhëtarëve në zonën Shengen janë me *bona fide*, disa kanë abuzuar me regjimin pa viza duke bërë kërkesa të pabazuara për azil. Ashtu si në periudhat e mëparshme, vazhdoi rritja sezonale e kërkesave për azil. Kjo konfirmon se duhen masa të shënjestruara dhe intensive si sensibilizimi publik, hetimi i ndërmjetësve, politika afatgjata për përmirësimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të kategorive vulnerabël më të prekura nga fenomeni i emigracionit, përfshi

komunitetin Rom. Në këtë fushë nevojiten përpjekje të mëtejshme sistematike dhe me financimin e duhur. Komisioni do t'ia paraqesë raportin monitorues Parlamentit Evropian dhe Këshillit në fund të 2013-ës. Përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar.

Në fushën e **kufijve të jashtëm dhe Shengen-it**, në prill u nënshkruan me Kosovën tri marrëveshje për kontrollin e përbashkët kufitar. Qendra e Përbashkët për Bashkëpunim Policor u ngrit dhe filloi funksionimin në pikën kufitare të Morinës në qershor. PKM kryen patrullime periodike dhe të sinkronizuara me Kosovën. Janë zgjidhur problemet nga mungesa e shkëmbimit të informacionit midis sistemeve IT të Policisë Kufitare kosovare (BMS) dhe shqiptare (TIMS). Në nëntor është nënshkruar një marrëveshje me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për krijimin e një pike të re kontrolli të përbashkët kufitar. Moratoriumit të skafeve i mbaroi afati në mars. Janë rritur kapacitetet e vlerësimit të rrezikut në Policinë Kufitare dhe të Migracionit, në nivel qendror dhe vendor. Në fushën e menaxhimit të kufijve dhe sigurisë, është forcuar bashkëpunimi praktik me Frontex, sidomos në trajnimet dhe veprimtaritë e përbashkëta me Rrjetin e Analizës së Riskut për Ballkanin Perëndimor (ËBRAN). Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve të përfshira në menaxhimin e kufirit blu. Duhet të garantohet qëndrueshmëria financiare e mekanizmave të mbikëqyrjes. Për hartohet Strategjia e re për menaxhimin e kufijve 2014-2020 si edhe plani i veprimit përkatës. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD-së) është tashmë lidhur me sistemin e menaxhimit të informacionit kriminal MEMEX. Të forcohet koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve që bëjnë pjesë në QNOD-së, dhe kapacitet veprues duhet të garantohet me financim të përshtatshëm. Vlerësimi i rrezikut i QNOD-së duhet të marrë parasysh skadimin e moratoriumit për motoskaftët. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë.

Në fushën e **bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale**, ka nisur zbatimi i Protokollit të Tretë Shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Austrinë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Përgatitjet për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust-in nuk kanë përparuar, por legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale është në fazë rishikimi. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e 23 nëntorit 2007 "Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes", e cila hyri në fuqi më 1 janar 2013. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazë të hershme.

Përparim është bërë në fushën e **bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar**, një nga prioritetet kyçe të Opinionit të KE-së. Bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë ka vazhduar të japë rezultate të mira për sa i përket operacioneve policore, arrestimeve dhe bashkëpunimit në hetime, përfshi bashkëpunimin kundër pasurisë së krimit. Policia shqiptare dhe Prokuroria e kanë rritur bashkëpunimin, edhe në lidhje me shërbimet e inteligjencës penale.

Në janar është nënshkruar një memorandum për bashkëpunimin më të gjerë midis institucioneve të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit. Numri i hetimeve dhe çështjeve që i janë paraqitur Prokurorisë është rritur. Janë zhvilluar trajnime të përbashkëta për oficerët e policisë dhe të prokurorisë, përfshi trajnime për konfiskimin e pasurive kriminale dhe krimin kibernetik. Është përmirësuar bashkëpunimi midis Njësisë Hetimore Financiare (NjHF) dhe Policisë. Në korrik janë miratuar strategjia e re për krimin e organizuar 2013-2020 dhe Plani i Veprimit 2013-2016. Megjithatë, krimi i organizuar vazhdon të jetë shqetësim serioz në Shqipëri. Vazhdojnë problemet në zbatim të ligjit "Antimafia", sidomos në lidhje me konfiskimin e pasurisë. Duhet të shtohen hetimet kryesisht (proaktive) ndaj pasurive me origjinë nga veprimtari

kriminale jashtë shtetit, por që investohen në Shqipëri. Duhet të përmirësohet bashkëpunimi midis Policisë dhe Prokurorisë, si dhe duhet përforcuar kapacitetet e policisë që t'i përgjigjet siç duhet dhe në kohë kërkesave të prokurorisë për përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit. Duhet të shtohet numri i gjykatësve në Gjykatën e Krimeve të Rënda si edhe të forcohen aftësitë teknike në fusha të specializuara si krimi kibernetik dhe hetimi financiar. Të përmirësohet harmonizimi i statistikave institucionale në lidhje me vijimësinë e rezultateve të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve. Të rritet kapaciteti i punës i laboratorit të kriminalistikës, sidomos për interpretimin e ADN-së databazën e ADN-në. Duhet të përmirësohen kapacitetet për të marrë provat më të mira të mundshme për procedimet gjyqësore, duke përmirësuar kapacitetet e policisë dhe të organeve ligjzbatuese në hartimin e raporteve cilësore.

Në maj është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me CEPOL-in. Në selinë e Europol-it është caktuar një oficer ndërlidhës shqiptar përgjegjës për mbajtjen e kontakteve ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Europol-it me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit. Marrëveshja operacionale me Europolin është në pritje të nënshkrimit.

Kuadri i përgjithshëm i shërbimit të mbrojtjes së dëshmitarit është forcuar ndjeshëm përmes ngritjes së një njësie operacionale fleksibël, riorganizimit dhe rregullimit më rigoroz të programeve të mbrojtjes, si edhe masave që garantojnë autonomi financiare dhe konfidencialitet të operacioneve. Është realizuar një program trajnimi gjithëpërfshirës.

Për sa i përket **luftës kundër pastrimit të parave**, rekomandimet e raundit të fundit vlerësues të Moneyval janë zbatuar siç duhet dhe ka filluar procedura e "forcimit të respektimit". Është publikuar një manual teknik se si kryhet hetimi për pastrimin e parave, që iu është përcjellë të gjitha organeve të përfshira në ciklin e hetimit. Numri i konstatimit të rasteve të pastrimit të parave është rritur. Gjatë 6-mujorit të parë të 2013-ës, dënimet janë dyfishuar duke shkuar në 12, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2012-ës. Gjykatat e shkallës së parë dhanë 5 dënime, kundrejt 3 të tilla në të njëjtën periudhë të 2012-ës. Megjithatë, numri i dënimeve për pastrim parash vazhdon të jetë i ulët. Zbatimi i legjislacionit kundër pastrimit të parave është ende i dobët dhe ende nuk ekziston një vijimësi rezultatesh (track record) me çështje të nivelit të lartë.

Për sa i përket **luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore**, ndryshimet e fundit në Kodin Penal për trafikimin e brendshëm, e parashikojnë si vepër penale përfitimin nga shërbimet e viktimave. Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafikim (ZKKA) është angazhuar në brendësi të grupit të përbashkët të punës të ngritur midis Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë për të shqyrtuar rastet konkrete të trafikimit me synimin për të përmirësuar hetimet dhe proceset gjyqësore. Është i nevojshëm përforcimi i mëtejshëm i ZKKA-së. Hetimet e forcave të policisë dhe përdorimi i mjeteve speciale të hetimit kundër trafikimit të të rriturve dhe të miturve ka dëshmuar një ecuri pozitive. Gjithsesi, Shqipëria mbetet burim trafikimi i qenieve njerëzore, përfshi edhe lypjen e detyruar nga të miturit. Vazhdon të jetë problematik trafikimi i brendshëm, gjë që kërkon forcim të hetime kryesisht. Duhet të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse dhe shumëdisiplinore për trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe duhet të përmirësohet identifikimi i tyre. Autoritetet shqiptare duhet të përforcojnë mekanizmin e koordinimit dhe referimit dhe t'u garantojnë viktimave akses të plotë në asistencë, mbështetje dhe mbrojtje, përfshi ri-integrimin mbas kthimit.

Është thelbësore që të përforcohet parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore. Duhet përfunduar procesi i transpozimit të konventave ndërkombëtare në fushën e luftës kundër

trafikimit të qenieve njerëzore.

Për sa i përket luftës kundër **krimin kibernetik**, në janar u ngrit Agjencia Kombëtare të Sigurimit Kibernetik. Në Policinë e Shtetit u ngrit edhe një njësi kundër krimin kibernetik. Megjithatë, nuk ka një strategji për sigurinë kibernetike dhe është i nevojshëm trajnimi dhe specializimi i forcave të policisë dhe prokurorisë në këtë fushë. Numri i procedimeve penale për krime kibernetike u rrit në 2012, por vazhdon të jetë i ulët.

Për sa i përket burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit, balanca gjinore ka vazhduar të përmirësohet përmes rekrutimit në rritje të oficerëve femra. Duhet të përmirësohet më tej menaxhimi i burimeve njerëzore bazuar në kritere transparente dhe mbi bazë merite. Duhet të forcohen standardet e kontrollit të brendshëm në luftën kundër korrupsionit dhe keqadministrimit.

Shqipëria ka vazhduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe planin e veprimit të **luftës kundër terrorizmit**. Shqipëria duhet të adresojë rekomandimet e Task Forcës së Aksionit Financiar (FATF) mbi pasuritë e terrorizmit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me financimin e terrorizmit.

Në fushën e **bashkëpunimit në luftën kundër drogës**, Shqipëria ka vazhduar bashkëpunimin me EMCDDA-në dhe ka marrë pjesë aktive në trajnime të ndryshme. Sekuestrimet dhe ndjekjet penale janë rritur falë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të reja, analizës efektive të riskut dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Gjatë periudhës shtator 2012 - maj 2013, operacione e suksesshme policore çuan në kapjen e 70 kg. heroinë, 2.27 kg. kokainë dhe 20674 kg. kanabis (kundrejt 58 kg. heroinë, 4.5 kg. kokainë dhe 11 685 kg. kanabis në periudhën shtator 2011 - gusht 2012). Është përmirësuar kontrolli i kufijve blu dhe të gjelbër, duke rezultuar në disa sekuestrime dhe arrestime të nivelit të lartë. Këto përpjekje duhet të intensifikohen, duke forcuar vlerësimin e kërcënimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Në mars është miratuar një plan kombëtar veprimi dhe një plan pune që adreson në veçanti kultivimin e bimëve narkotike, përfshi kanabisin. Këto duhet të zbatohen plotësisht, për të arritur rezultate të qëndrueshme në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabis, që mbetet një kërcënim serioz.

Për sa i përket **bashkëpunimit doganor**, është instaluar dhe funksionon sistemi dixhital i monitorimit me kamera 24 orë. Numri i hetimeve ndaj punonjësve të doganës është rritur në krahasim me vitet e kaluar (*shih Kapitulli 29 – Bashkimi doganor*).

Për hollësi mbi masat kundër **falsifikimit të euros**, *shih Kapitulli 32 - Kontrolli financiar*.

### *Përfundim*

Shqipëria ka bërë përparim të mëtjshëm në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, veçanërisht në menaxhimin e kufijve dhe në luftën kundër krimin të organizuar, pastrimit të parave dhe trafikeve të drogës. Përpjekje të mëtjshme nevojiten në koordinimin ndërmjet institucioneve ligjzbatuese si dhe për të arritur një vijimësi rezultatesh bindëse me hetime penale dhe financiare, ndjekje penale dhe dënime. Planet dhe alokimet e përshtatshme buxhetore janë vendimtare për të mbështetur institucionet e përfshira në kontrollin e kufijve dhe në luftën kundër krimin të organizuar. Ende nuk është miratuar një strategji për migracionin. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë po avancojnë.

#### 4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi

Për sa i përket **politikave të kërkimit dhe novacionit**, janë marrë disa masa për stimulimin e novacionit dhe për përforcimin e burimeve njerëzore. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ka shtuar përpjekjet për promovimin e pjesëmarrjes në programet e BE-së për kërkimin, por shkalla e suksesit në përgjithësi është ende shumë e ulët. Buxheti kombëtar për kërkim është rritur lehtë, por niveli i investimeve në kërkim dhe zhvillim teknologjik është ende shumë i ulët. Nevojiten më shumë burime financiare, sidomos për forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e infrastrukturës.

Për sa i përket pjesëmarrjes së Shqipërisë në **Programin e Shtatë Kuadër** të BE-së (FP7), AKTI ka rritur përpjekjet dhe mbështetjen për komunitetin shkencor, por niveli i pjesëmarrjes dhe shkalla e suksesit (13%) janë ende shumë të ulëta. Për shkak të shtrëngimeve buxhetore, pjesëmarrja e AKTI-t në eventet e BE-së për krijimin e rrjeteve ka pësuar rënie. AKTI është angazhuar në marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Slloveninë dhe Turqinë. Për herë të parë është organizuar dita e informimit në Tiranë për Qendrën e Përbashkët Kërkimore. AKTI ka filluar përgatitjet për pjesëmarrjen në programin kuadër të BE-së për kërkimin, "Horizon 2020".

Për sa i përket integritimit në **Hapësirën Evropiane të Kërkimit** (ERA), janë marrë disa masa për të rritur kapitalin njerëzor, kryesisht duke rritur Fondin e Ekselencës dhe duke zgjeruar programin "Brain Gain" në bashkëpunim me UNDP-në. AKTI po realizon me sukses portalin Euraxess. Financimi i kërkimit shkencor për historinë dhe gjuhën shqiptare është njohur si çështje prioritare. Për shkak të mungesës së statistikave të besueshme, është e vështirë të përcaktohet niveli i investimeve si përqindje e PBB-së, por vlerësohet rreth 0.35%. Kontributi i sektorit privat dhe NVM-ve në kërkim dhe zhvillim teknologjik në veçanti, është shumë e kufizuar. Për sa i përket Unionit të Novacionit, Qendra Shqiptare e Biznesit dhe Inovacionit në Agjencinë Shqiptare për Investime dhe Zhvillim (AIDA) vazhdoi të nxitë novacionin nga sipërmarrësit, duke rritur auditet e teknologjisë dhe masat me fokus NVM-të.

#### *Përfundim*

Shumë pak përparim është bërë në fushën e shkencës dhe kërkimit. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme dhe investime në kërkim për të siguruar integritimin në Zonën Evropiane të Kërkimit dhe për të kontribuar në Unionin e Inovacionit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për pjesëmarrje të suksesshme në programin kuadër të BE-së për kërkimin, "Horizon 2020". Në tërësi, përgatitjet nuk kanë avancuar mjaftueshëm.

#### 4.26. Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura

Në fushën e **arsimit, formimit profesional dhe rinisë**, aktet nënligjore të Ligjit "Për arsimin parauniversitar" ende nuk janë miratuar. Mësuesit janë trajnuar më tej dhe Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar ka vazhduar të kryejë inspektime në kopshte dhe shkolla fillore e të mesme. Në arsimin e mesëm janë futur standarde dhe programe mësimore të reja, ndërsa procedura e Maturës Shtetërore është bërë më transparente.

Duhet të miratohet strategjia për arsimim profesional dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës. Numri i studentëve të regjistruar në kurset e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) u rrit me 23% gjatë

2012-2013, krahasuar me vitin pararendës. Shkollat ekzistuese AFP nuk kanë mirëmbajtjen e duhur, për shkak të mungesës së burimeve financiare. Pjesëmarrja e sektorit privat, që është vendimtare për reformën e suksesshme AFP, është ende e mjaftueshme. Regjistrimi i ulët në shkollat AFP bie ndesh me kërkesën e tregut për punonjës të kualifikuar.

Agjencia e Akreditimit vazhdon të vlerësojë dhe të inspektojë institutet dhe programet e arsimit të lartë. Edhe pse niveli i regjistrimit të arsimit të lartë është rritur në dekadën e fundit, kualifikimi i ofruar nuk përputhet me kërkesat e tregut; nevojitet një studim mbi kualifikimet e dëshiruara. Nuk ka pasur përparim në reformën e arsimit të lartë, skemën e performancës dhe renditjes, si edhe zhvillimin e Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve. Harmonizimi në këtë fushë nuk është i njëtrajtshëm.

Nevojiten përmirësime të arsimit në të gjitha nivelet dhe duhet të përmbushë kërkesat e tregut të punës. Siç dëshmojnë rezultatet e PISA-s, sistemi arsimor duhet të reformohet, përfshi formimin e mësuesve, masat për sigurimin e cilësisë, transparenca, përvojat praktike të të mësuarit dhe lidhja me sektorin e biznesit.

Në korrik 2013, Shqipëria nënshkroi një memorandum mirëkuptimi për pjesëmarrjen - në vitin buxhetor 2013 - në Aksionet e Centralizuara të Programit të BE-së për Të Nxëniet për Gjithë Jetës.

Në fushën e **kulturës**, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka promovuar “Programin e Kulturës”, sidomos me seanca informimi publike. Është rritur pjesëmarrja programin “Europa për Qytetarët”. Janë realizuar rehabilitime të qendrave të rëndësishme kulturore në Shkodër, Elbasan, Berat dhe Korçë. Strategjia e re për trashëgiminë kulturore 2012 - 2020 ende nuk është miratuar.

#### *Përfundim*

Pak përparim është bërë në fushën e arsimit dhe kulturës, veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen në programet e BE-së. *Në tërësi*, përgatitjet kanë përparuar në masë të moderuar. Duhet të synohet përmirësimi i cilësisë së përgjithshme dhe relevancës së arsimit.

#### **4.27. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike**

Për sa i përket **mjedisit**, në fushën e *legjislacionit horizontal*, qeveria përgatiti një Strategji të re ndërsektoriale për mjedisin 2013 – 2017; për zbatimin e saj nevojitet një buxhetor i qëndrueshëm. Në shkurt u miratua ligji “Për vlerësimin strategjik mjedisor” që synon përafrimin me Direktivën BE për vlerësimin strategjik mjedisor. Ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe ligji “Për lejet mjedisore” nuk janë përafruar me Direktivën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Mospërafrimi i legjislacionit mjedisor vazhdon të jetë një problem i madh. Vlerësimet e ndikimit në mjedis nuk kryhen sistematikisht ose nuk bëhen para shpalljes së projekteve infrastrukturore. Aksesit publik në informacion dhe pjesëmarrja publike në vendimmarrje nuk garantohen siç duhet.

Projektligji për *cilësinë e ajrit* dhe aktet nënligjore për kriteret dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit për ndotës të caktuar ende nuk janë miratuar. Ndryshimi në ligjin “Për taksat kombëtare” i miratuar në prill 2013, që ul nivelin e taksimit për makinat e përdorura, nuk është në përputhje me *acquis* për mbrojtjen e mjedisit. Ende nuk ka një program të besueshëm të monitorimit të ajrit, me përjashtim të Tiranës. Mirëmbajtja e stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetet e tjera nuk është e garantuar plotësisht. Duhet të miratohet plani i menaxhimit të ajrit për Tiranën.

Janë miratuar aktet nënligjore për **menaxhimin e mbetjeve**, dhe janë përgatitur plane menaxhimi për Tiranën, Lezhën dhe Shkodrën. Menaxhimi i mbetjeve vazhdon të jetë shqetësim serioz për Shqipërinë. Ndarja e mbetjeve nuk ka filluar ende, me disa përjashtime, dhe niveli i riciklimit vazhdon të jetë shumë i ulët. Industria e riciklimit është në fazë fillestare dhe duhet të importojë pjesën më të madhe të lëndës së parë nga jashtë shtetit. Bashkitë kanë kapacitete shumë të dobëta për menaxhimin e mbetjeve, përfshi në destinacionin përfundimtar. Pjesa më e madhe e mbetjeve vazhdon të hidhet në mënyrë të pasigurt në vendgrumbullime të ligjshme ose të paligjshme, ose digjet. Aktualisht ekzistojnë vetëm dy *landfille* që përmbushin standardet e BE-së. Ka nisur ndërtimi i një *landfilli* në Korçë. Ende mungojnë facilitetet për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe nuk ka procedurë të qartë për menaxhimin dhe kontrollin e *landfilleve*. Investimet e reja në këtë fushë duhet të përqendrohen më tepër në ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve.

Në fushën e **cilësisë së ujit**, në nëntor u miratua ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe në prill u finalizua masterplani i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Përafrimi me *acquis* është në fazë fillestare. Grumbullimi i centralizuar i ujërave të ndotura realizohet vetëm në qytetet e mëdha. Funkcionojnë katër impiante trajtimi të ujërave të zeza, tre të tjerë kanë përfunduar por nuk janë vënë në punë, ndërsa dy janë në ndërtim. Investimet aktuale financiare dhe burimet njerëzore nuk janë të mjaftueshme për të siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e duhur të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Është i dobët edhe kapaciteti i kompanive publike për të administruar shërbimet bazë për furnizimin me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza. Zhvillimi i planeve të administrimit të baseneve lumore, përfshi nivelin rajonal, është ende në fazë fillestare.

Në fushën e **mbrojtjes së natyrës**, sipërfaqja e territorit të mbrojtur është rritur me 0.75%, duke arritur në 15.83%. Sidoqoftë, duhet të garantohet mbrojtja e kësaj sipërfaqeje. Në qershor u shpall një zonë e re e mbrojtur. Rregullat e miratuara në 2011 për ngritjen e zonave të mbrojtjes së veçantë në kuadrin e Natura 2000 ende nuk janë zbatuar. Janë marrë pak masa pas pranimit nga Konventa e Bernës në 2011 të zonave kandidate të propozuara nga Shqipëria për Rrjetin e Smeraldit. Veprimtaritë e paligjshme si gjuetia, prerja e drurëve dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura janë të shpeshta dhe kapacitetet administrative të inspektoratit për goditjen e këtyre fenomeneve mbeten të dobëta.

Për sa i përket **kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut**, në shtator 2012 Shqipëria ratifikoi Protokollin për Përgatitjen, Luftën dhe Bashkëpunimin kundër Rasteve të Ndotjes me Lëndë të Rrezikshme dhe të Dëmshme (OPRC-HNS).

Për sa i përket **politikave për zhurmën në mjedis**, është ngritur një task forcë për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare, por zbatimi i vendimeve të tij mbetet sfidë. Nuk ka pasur përparim në fushat e mbrojtjes civile dhe të kimikateve.

Për sa i përket **ndryshimeve klimatike**, mungon një strategji dhe politikë gjithëpërfshirëse për klimën. Shqipëria është pozicionuar rregullisht krahas qëndrimeve të BE-së në kontekstin ndërkombëtar. Edhe pse është pozicionuar pro Marrëveshjes së Kopenhagenit, Shqipëria ende nuk ka dorëzuar një raport angazhimi për 2020. Shqipëria duhet të konsiderojë marrjen e angazhimeve në pajtim me ato të BE-së dhe Shteteve Anëtare, me qëllim arritjen në vitin 2015 të marrëveshjes së klimës së pas-2020-ës. Në bazë të Kartës së Gjelbër të BE-së “Kuadri 2030 për politikën e klimës

dhe energjetikës”, Shqipëria duhet të fillojë të reflektojë rreth kuadrit të saj për klimën dhe energjetikën për 2030-ën.

Për sa i përket harmonizimit me *acquis* për klimën, janë miratuar disa akte ligjore në fushën e cilësisë së karburanteve. Janë identifikuar 13 instalime të palëvizshme me qëllim zbatimin në të ardhmen të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve. Duhet bërë përpjekje të ndjeshme për të rritur kapacitetet monitoruese, raportuese dhe verifikuese të vendit. Shqipëria mori pjesë rregullisht në komponentin e klimës të Rrjetit Mjedisor Rajonal për Aderim (RENA). Sensibilizimi në të gjitha nivelet mbetet i ulët dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjithë grupeve të interesuara duhet të forcohet.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative** në sektorin e mjedisit, numri i personelit është rritur në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit. Ministria e Mjedisit vazhdon të ketë kapacitete të dobëta programuese dhe zbatuese. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar imponimin e ligjit, përfshi trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë për çështjet mjedisore. Autoriteteve vendore i kanë të pakta burimet njerëzore dhe financiare për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme. Burimet e kufizuara të shërbimit të inspektimit nuk japin garanci të besueshme se shkeljet monitorohen në terren dhe ndëshkohen siç duhet. Buxheti i shtetit nuk parashikon fonde të mjaftueshme dhe koordinimi ndërmjet ministrive dhe pushtetit vendor është i dobët. Për sa i përket ndryshimeve klimatike, kapacitetet e kufizuara administrative dhe bashkëpunimi i dobët institucional po vonojnë përgatitjen dhe zbatimin e një politike për klimën në linjë me *acquis*. Kuadri administrativ për ndryshimet klimatike ka nevojë për forcim të ndjeshëm, me qëllim që të përmbushë nevojat e qenësishme për kapacitete, bashkëpunim dhe koordinim.

#### *Përfundim*

Është bërë pak përparim në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Përafrimi me *acquis* ka avancuar, por nevojiten urgjentisht përpjekje të mëtejshme për të garantuar zbatim dhe imponim të ligjit. Burimet ngelen të kufizuara dhe nevojiten investime të mëdha. Duhet të forcohet konsultimi publik për investimet publike si edhe pjesëmarrja publike në nismat normative. Nevojiten përpjekje thelbësore dhe vullnet politik për të krijuar një përjasje më strategjike për vendin, si edhe për të forcuar kapacitetet administrative dhe bashkëpunimin ndërinstucional. Përgatitjet në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë në fazë të hershme.

#### **4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit**

Në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit**, lidhur me *aspektet horizontale*, Strategjia për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2013-2020 është në pritje të miratimit. Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK) ka zhvilluar takime periodike dhe ka trajtuar ankesa në fushën e arsimit universitar, sektorit elektroenergjetik dhe telekomunikacioneve. Është finalizuar një analizë e boshllëqeve ligjore lidhur me përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, përfshi komponentë për mbrojtjen e shëndetit. KMK dhe Sektori për Mbrojtjen e Konsumatorit kanë vijuar fushatat e tyre sensibilizuese për konsumatorin. Sistemi online i ankesave nuk ka gjeneruar ankesa efikase, për shkak të informimit të dobët ofruar përdoruesve. Informacioni në faqen e internetit të KMK-së nuk përditësohet rregullisht.



Në fushën e **sigurisë së produkteve**, në mars u ndryshuan disa ligje me qëllim përafrimin e legjislacionit me dispozitat e reja të Ligjit për Inspektimet, përfshi dispozitat për sigurinë e produkteve joushqimore, tregtimin, mbikëqyrjen e tregut dhe metrologjinë. Janë përgatitur akte nënligjore që rregullojnë organizimin e Inspektoratit. Janë miratuar rregullore teknike me qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis* në fushën e çakmakëve rezistentë ndaj fëmijëve dhe çakmakëve risi. Janë bërë përpjekje gjithashtu për përafrimin me *acquis* në fushën e imitimeve të rrezikshme. Ende nuk është krijuar inspektorati i tregut.

Nuk ka pasur zhvillime në *çështjet që nuk lidhen me sigurinë*.

Përparimi në fushën e **shëndetit publik** është ngadalësuar nga mungesa e kapaciteteve në administrimin e kujdesit shëndetësor, shpenzimet e ulëta publike dhe korrupsioni. Kujdesi parësor shëndetësor ka mungesë fondesh dhe burimesh njerëzore. Mbulimi i kujdesit me sigurime mbetet ende shumë i ulët. Sektori i spitaleve publike mbetet i pazhvilluar, ndërkohë që sektori privat po rritet pa disiplinimin e duhur. Ministria e Shëndetësisë firmosi në janar një kontratë për ngritjen e Regjistrimit Kombëtar Elektronik të Shëndetësisë, por mbeten ende për t'u siguruar burimet financiare. Projekt-strategjia për shëndetësinë elektronike ende nuk është miratuar.

Në fushën e **kontrollit të duhanit**, në shkurt u ndryshua ligji për mbrojtjen e shëndetit ndaj produkteve të duhanit, që synon të fuqizojë në mënyrë më efikase ndalimin e duhanit në mjedise publike. Një fushatë kombëtare anti-duhan u realizua nëpër shkolla. Inspektorati Shtetëror i Higjienës vijoi të kryejë inspektime në vend. Por ndalimi i duhanit në mjediset dhe institucionet publike nuk respektohet, ndërkohë që produktet e duhanit vazhdojnë të shiten në rrugë, veçanërisht nga të miturit.

Në lidhje me **sëmundjet ngjitëse**, projektligji për kontrollin e sëmundjeve ngjitëse ende nuk është miratuar dhe udhëzimet kombëtare për rezistencën antimikrobale po hartohen. Në nivel kombëtar, mbulimi i raportuar i imunizimit për vitin 2012 ishte mbi 98%. Ministria e Shëndetësisë ngriti një komision kombëtar dhe një sekretariat për reaksionet pas vaksinimit. Janë organizuar aktivitete sensibilizimi, kryesisht me fokus Romët. Ende nuk janë miratuar aktet nënligjore që garantojnë të drejtën e kujdesit shëndetësor për personat dhe fëmijët me HIV/AIDS dhe për njerëzit në rrezik. Kapacitetet laboratorike duhet të përmirësohen.

Në fushën e **gjakut, indeve, qelizave dhe organeve**, në shtator 2012 u miratua rregullorja për funksionimin e bankave të indeve, qelizave dhe organeve, përfshi aktivitetet e prokurimit, përzgjedhjes, testimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së substancave me origjinë njerëzore për trajtim mjekësor. Në 2013 filloi projekti i ri dyvjeçar "Parandalimi i transmetimit të infeksioneve përmes gjakut dhe komponentëve më të sigurt".

Në shkurt u miratua strategjia kombëtare dhe plani i veprimit 2013-2022 për zhvillimin e **shërbimeve të sëmundjeve mendore**. Mungesa e doktorëve të specializuar në trajtimin e personave më paafësi intelektive mbetet ende sfidë. Nuk ka pasur përparime në ngritjen e shërbimeve të shëndetit mendor me bazë komunitare.

Në lidhje me **parandalimin e abuzimit me drogën**, po përgatitet një plan veprimi për kontrollin e drogës si edhe një sistem të dhënash për raportimin në lidhje me drogën. Qendra Kombëtare e Informimit për Drogat ka përfunduar një ekspozitë kombëtare mbi drogën, bazuar në standardet e Qendrës Evropiane të Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA). Instituti i

Shëndetit Publik nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me njësitë relevante të trajtimit të drogës.

Janë ndërmarrë disa hapa për të zvogëluar **pabarazitë shëndetësore**, me infermieri kujdestarie për fëmijët romë dhe vizita te shtëpitë e Romëve. Aksesimi në kujdesin shëndetësor është përmirësuar me regjistrimin e fëmijëve dhe grave romë, si edhe me miratimin e një plani të përbashkët veprimi mes Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Në zonat rurale nuk është i garantuar aksesimi i barabartë në kujdes shëndetësor, veçanërisht për grupet vulnerabel. Kanë nisur programet e edukimit për **ushqyerjen** dhe janë promovuar modelet e shëndetshme të ushqyerjes së fëmijëve; gjithsesi, kequshqyerja e fëmijëve mbetet një shqetësim serioz. Janë bërë hapa për të ulur **dëmin e shkaktuar nga alkooli**, me miratimin e Ligjit për Shërbimet e Medias Audiovizive, që disiplinon transmetimin e reklamave për pijet alkoolike. Në fushën e **kontrollit të kancerit**, janë organizuar disa fushata ndërgjegjësuëse dhe trajnime për stafin e sektorit të shëndetësisë, si dhe janë miratuar udhëzime për ngritjen e *shërbimeve të kujdesit paliativ*. Kanë nisur përgatitjet për krijimin e monitorimit të *kancerit cervikal*. Për të garantuar zbatimin e duhur, nevojitet një forcim i qenësishëm i kapaciteteve administrative.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përparime në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit. Është vonuar krijimi i një sistemi të përshtatshëm të mbikëqyrjes së tregut. Sektori shëndetësor mbetet thellësisht me mungesë financimi dhe mungesë personeli, duke vështirësuar zbatimin e duhur të legjislacionit dhe politikave, veçanërisht në fushën e kujdesit parësor. *Në tërësi*, përgatitjet kanë nisur.

#### **4.29. Kapitulli 29: Bashkimi doganor**

Në fushën e **legjislacionit doganor**, Shqipëria përditësoi nomenklaturën e mallrave në linjë me versionin 2013 të Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së. Shqipëria ratifikoi Konventën Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Med dhe zbatoi Konventën ATA për Importimin e Përkohshëm. Duhet të forcohen kapacitetet zbatuese si edhe sensibilizimi i përgjithshëm rreth procedurave të Konventës së ATA-s. Norma e përdorimit të vlerës së transaksionit u rrit por sërish mbetet e ulët sipas standardeve të BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në futjen e procedurave të thjeshtuara, masave të sigurisë dhe konceptit të operatorit të autorizuar ekonomik. Duhet zbatuar procedura unifikuese në të gjithë vendin me qëllim që nëpunësit doganorë të kenë më pak hapësira interpretimi. Kodi i ri Doganor ende nuk është miratuar.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative dhe operacionale**, Shqipëria ka nisur pjesëmarrjen në programin e BE-së për Doganat 2013. Akademia e Tatimeve dhe Doganave filloi punën në maj me strategjinë e trajnimit të doganave, si pjesë të programit të saj. Terminali doganor i Tiranës u përrua dhe infrastruktura e pikave të kalimit kufitar po përmirësohet. Është rritur kapaciteti dhe efikasiteti i laboratorit doganor. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave (DPD) e ka shtuar bashkëpunimin me institucionet e tjera, përfshi mbi zbulimin e materialeve radioaktive.

Është miratuar një rregullore e brendshme për politikën e sigurisë në sistemin TIK doganor. Funkcionon sistemi për pagesat elektronike të detyrimeve dhe tarifave doganore si dhe deklarimi *online* të akcizës. Është bërë funksional shkëmbimi elektronik i të dhënave me doganat kosovare. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur ndërfunksionimin *online* të DPD-së me sistemin doganor

dhe të akcizës së BE-së, mes të tjerash. Strategjia e TIK-ut nuk është e harmonizuar me Strategjinë për Biznesin.

DPD miratoi strategjinë e brendshme për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe rriti përpjekjet e saj për të parandaluar hyrjen e produkteve të falsifikuara në Shqipëri (*Shih kapitullin 7 – Pronësia intelektuale*). Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorrupsion e shtoi veprimtarinë e saj dhe raportoi në komisionin e disiplinës shkelje të kodit të etikës nga zyrtarët e doganave. Është zgjeruar sistemi i monitorimit me kamera 24 orë në pikat e kalimit kufitar.

#### *Përfundim*

Ka pasur disa përparime një zhvillim në fushën e bashkimit doganor, sidomos në lidhje me tarifat, origjinën dhe importimin e përkohshëm. Administrata e doganave i ka forcuar hetimet e brendshme dhe ka përmirësuar sistemin TIK. Nevojiten përpjekje më të mëdha në lidhje me përputhshmërisë e sistemit TIK me procedurat e BE-së, me lehtësimin e tregtisë dhe thjeshtimin e procedurave. Duhet përsheptuar miratimi i Kodit të ri Doganor. Duhet përdorur më gjerë vlera transaksionit në linjë me standardet e BE-së. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### **4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë**

Në fushën e **politikës së përbashkët tregtare**, Shqipëria ka vijuar koordinimin e politikave të saj me qëndrimet e Bashkimit Evropian kundrejt vendeve të treta, kryesisht në lidhje me OBT-në dhe gjatë negociatave të Agjendës së Dohas për Zhvillim.

Janë rritur kapacitetet administrative që merren me politikat tregtare. Është miratuar një analizë e boshllëqeve ligjore dhe janë kryer trajnime për institucionet e linjës. Janë finalizuar kurrikula trajnimi mbi çështjet e tregtisë, politikën e përbashkët tregtare të BE-së, OBT-në dhe të drejtën ndërkombëtare, të cilat janë përfshirë në programin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar koordinimin ndërmjet institucioneve shtetërore që merren me çështjet e politikave tregtare.

Në fushën e **marrëveshjeve dypalëshe me vendet e treta**, Shqipëria mori kryesimin e CEFTA gjatë vitit 2012. U firmosën marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim ekonomik me Azerbajxhanin dhe Bullgarinë. Shqipëria miratoi një marrëveshje për lehtësimin e tregtisë me Kosovën.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përparime për sa i përket trajnimeve mbi politikën e përbashkët tregtare të BE-së, kryesisht në lidhje me kapacitetet administrative dhe koordinimin ndërinstitucional mbi politikat tregtare. Shqipëria ka ruajtur bashkëpunimin e mirë me OBT-në dhe CEFTA-n. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### **4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, sigurisë dhe e mbrojtjes**

Shqipëria ka vijuar **dialogun e rregullt politik** me BE-në për çështjet e politikave të sigurisë së jashtme. (*Për sa i përket marrëdhënieve me vendet e tjera të zgjerimit dhe Shtetet Anëtare, shih Kriteri Politik 2.3 - Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.*)

Për sa i përket **politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë** (PBJs), Shqipëria ishte në linjë me të gjitha deklaratat relevante të BE-së dhe vendimet e Këshillit (në linjë 100%). Gjithashtu, Shqipëria ishte në linjë edhe me pozicionet e BE-së dhe OKB-së, si edhe me rezolutat e BE-së. (Për sa i përket *Gjykatës Ndërkombëtare Penale, shih Kriterin Politik 2.3 - Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare.*)

Shqipëria ka zbatuar **masat kufizuese të BE-së** për vendet e treta, të paraqitura në Vendimet e Këshillit.

Në fushën e **mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe çarmatimit**, Shqipëria ka vijuar zbatimin e planit të veprimit për shkatërrimin e tepricës së armatimit dhe ka miratuar një deklaratë të përbashkët BE-Ballkan Perëndimor për rritjen e luftës kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municionit në Ballkanin Perëndimor. Në mars u miratua një ligj i ri për armët, që synon përafrimin me *acquis*. Regjistri *online* i armëve dhe municionit nën administrimin e Policisë së Shtetit nuk është ende funksional. Në qershor, Shqipëria nënshkroi Traktatin e OKB-së për Tregtinë e Armëve.

Shqipëria është angazhuar në **bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare** (OKB, OSBE, Këshilli i Evropës, etj.) Gjatë maj-tetor 2012, Shqipëria mbajti kryesimin e radhës të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Shqipëria u zgjodh anëtare e Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB për periudhën 2013-2015.

Për sa i përket **masave të sigurisë**, ende nuk është firmosur marrëveshja e sigurisë me BE-në për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë në *operacionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake*, nën **politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes**. Marrëveshja kuadër për pjesëmarrjen e Shqipërisë në operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave hyri në fuqi më 1 shkurt. Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë në misionet EUFOR Althea në Bosnje-Hercegovinë (një anëtar i shtabit të përgjithshëm). Në maj u konfirmua pjesëmarrja e Shqipërisë në Misionin Trajnues të BE-së të Trajnimit në Ugandë.

#### *Përfundim*

Shqipëria ka vazhduar të përafrojë legjislacionin me *acquis* në fushën e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes. Duhet ende përpjekje për të finalizuar regjistrin *online* për armët dhe armatimin nën administrimin e Policisë së Shtetit. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë janë në rrugë të duhur.

#### **4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar**

Në fushën e **kontrollit financiar publik të brendshëm** (KFPB), Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) i ka trajnuar më tej përdoruesit e buxhetit mbi zbatimin e MFK-së në përputhje me kërkesat ligjore. Reformimi i sistemit informatik financiar të qeverisë dhe krijimi i një roli drejtori finance po vazhdon mbi baza pilot. Megjithatë, delegimi nga zyrtarët e lartë është i pakët dhe, rrjedhimisht, përdoruesit e buxhetit vazhdojnë të kenë botëkuptim të ngushtë për llogaridhënien menaxheriale dhe për parimet si menaxhimi i riskut. Ende nuk janë miratuar procedurat për inspektimin financiar. Drejtoria e Inspektimit Financiar

Publik në Ministrinë e Financave siguron personel mbi baza nevojë dhe inspektorët duhet të trajnohen më tej. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditin e Brendshëm (NjQH/AB) ka vazhduar të fokusohet në zbatimin e programit të certifikimit të auditit të brendshëm. Në lidhje me trajnimet për Auditin e Brendshëm, NjQH/AB duhet të mbikëqyrë dhe të drejtojë politikën e trajnimeve, si edhe të garantojë sigurimin e cilësisë, në vend që të veprojë si ofruese trajnimesh.

Në fushën e **auditimit të jashtëm**, janë ndërmarrë ndryshime organizative dhe procedurat e reja për të rritur efikasitetin e Kontrollit të Lartë i Shtetit (KLSH). Janë shtruar trajnimet dhe aktivitetet e marrëdhënieve me publikun, si dhe është forcuar bashkëpunimi dypalësh me vendet e tjera. Puna me auditin e performancës ka rifilluar. Plani strategjik i zhvillimit 2013-2017 është në proces hartimi. Megjithatë, ndryshimet në ligjin për KLSH-në janë duke u shqyrtuar në parlament që në vitin 2012 dhe mbetet të miratohen me shumicë 3/4. Aktualisht, nuk ka ndjekje sistematike parlamentare të raporteve të KLSH-së.

Në fushën e **mbrojtjes së interesave financiare të BE-së**, nuk është finalizuar punësimi i stafit në Drejtorinë e Inspektimit Publik Financiar që shërben si pikë kontakti për bashkëpunimin me Komisionin Evropian, Kapacitetet administrative duhet të zhvillohen.

Për sa i përket **mbrojtjes së euros nga falsifikimi**, Banka e Shqipërisë ka miratuar një rregullore mbi sigurinë e autenticitetit të kartëmonedhave shqiptare dhe ka ngritur një laborator që të ekzaminojë të gjitha kartëmonedhat e dyshuara si false, përfshi kartëmonedhat në euro.

#### *Përfundim*

Janë bërë disa përpertime në fushën e kontrollit financiar. Kuadri ligjor për KFPB është miratuar, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet zbatuese. Në fushën e auditimit të jashtëm, nevojitet miratimi i ndryshimeve në Ligjin për KLSH-në. *Në tërësi*, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

#### **4.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore**

Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me **burimet vetjake tradicionale, burimin e të Ardhurave Kombëtare Bruto (GNI) dhe burimet e TVSH-së**. (*Për përpbatimin në fushat përkatëse, shih kapitujt 16 - Tatimet, 18 - Statistikat, 29 - Bashkimi Doganor dhe 32 - Kontrolli Financiar*).

Për sa i përket **infrastrukturës administrative**, Shqipëria e ka infrastrukturën kryesore për sektorët kryesorë që ndikojnë tërthorazi në sistemin e burimeve vetjake. Megjithatë, ende nuk janë ngritur institucionet dhe organi koordinues që merren me përgatitjet e kushteve administrative për aplikimin e rregullave të burimeve vetjake dhe do të duhet të ngrihen në momentin e përshtatshëm. Gjithashtu, instrumentet efektive në luftën kundër evazionit tatimor dhe mashtrimit duhet të zhvillohen më tej dhe ekonomia informale duhet të tkurret.

#### *Përfundim*

Në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore, në momentin e përshtatshëm duhet të ngrihet një organ koordinues që të drejtojë përgatitjet e para-anëtarësimit në fushën e burimeve vetjake. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore janë në fazë të hershme.



## Shtojca Statistikore

### TË DHËNA STATISTIKORE

#### Shqipëria

Të dhëna bazë	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Popullsia (në mijë)	1)	3068e	2927e	2898e	2870e	2843e	2816e
Sipërfaqja totale e vendit (km <sup>2</sup> )		28750	28750	28750	28750	28750	28750

Llogaritë Kombëtare	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion ALL)	2)	583369	1089 293	1148 082	1222 462	1282 255p	1302 799ep
PBB (milion euro)		4541	8870	8694	8872	9137	9370ep
PBB (euro për frymë)	3)	1482	3045	3014	3106p	3229	3344ep
PBB (sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse (PPS))		:	6980e	7154e	7385e	7584e	:
PBB për frymë sipas PPS (BE-27 = 100)		:	26	28	30pb	:	:
Norma e rritjes reale të PBB-së (norma e rritjes së vëllimit të PBB-së, ALL, % ndryshim nga viti pararendës)	4)	7.9	7.5	3.3	3.7p	3.1p	1.6ep
Rritja e Punësimit (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti pararendës)		:	:	:	:	:	:
Rritja e Produktivitetit të Punës: rritja e PBB-së për person të punësuar (ndryshim në % nga viti pararendës)		30.3	-19.0	4.4		:	:
Rritja reale e koston për njësi pune (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti pararendës)		:	:	:	:	:	:
Produktiviteti i Punës (PBB sipas PPS-së për person të punësuar, BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto e sektorëve kryesorë (%)							
Bujqësia dhe peshkimi		23.6	18.7	18.7	19.3	19.5	20.6
Industria		7.3	9.8	10.1	11.7	12.0	11.3
Ndërtimi		10.4	14.9	14.2	11.0	10.7	8.6
Shërbimet		58.6	56.6	57.0	58.0	57.8	59.5
Shpenzimet e konsumit final, si përqindje e PBB-së (%)		80.9	89.5ep	90.1ep	86.1ep	85.7ep	:
Formimi bruto i kapitalit fiks, si përqindje e PBB-së (%)		38.4	40.9ep	37.9ep	31.2ep	31.2ep	:
Ndryshimet në inventar, si përqindje e PBB-së (%)		1.3	-3.8ep	-2.9ep	3.5ep	6.2ep	:

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)		18.4	29.4	28.4	32.9p	34.5p	33.9p
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)		39.0	56.0	53.6	53.8p	57.6p	53.2p

<b>Industria</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2000=100)	5)	:	135.2	152.8	182.2	212.5	218.7

<b>Norma e Inflacionit</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), % ndryshim nga viti paraardhës		3.5	2.2	2.3	3.6	3.4	1.9

<b>Bilanci i pagesave</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Bilanci i pagesave: totali i llogarive korrente (milion euro)		-316	-1381	-1330	-1019	-1185	-1021
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion euro)		-1149	-2431	-2304	-2083	-2242	-1999
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)		100	69	174	232	135	195
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: të ardhura neto (milion euro)		150	44	-138	-90	23	-89
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: transferta korrente neto (milion euro)		583	937	938	922	899	872
nga të cilat transferta qeveritare (milion euro)		31	31	27	45	21	25
Investime të Huaja Direkte (IHD) (milion euro)		231	610	689	788	715	727
Investime të Huaja Direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)		0	-55	-28	-5	-30	-18
nga të cilat IHD të ekonomisë shqiptare në vendet e BE-27 (milion euro)		:	:	:	:	:	:
Investimet të Huaja Direkte (IHD) në ekonominë shqiptare (milion euro)		231	665	717	793	745	745
nga të cilat IHD të BE-27 në ekonominë shqiptare (milion euro)		:	:	:	:	:	:

<b>Financat Publike</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Deficiti/suficiti buxhetor, në raport me PBB-në (%)		-6.9	-5.0	-4.9	-3.1	-3.5	-3.4e
Borxhi publik, në raport me PBB-në (%)		58.5	54.7	59.5	58.5	60.2	63.5



<b>Treguesit Financiarë</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Borxhi i huaj bruto i të gjithë ekonomisë, në raport me PBB-në (%)	6)	17.2	37.6	41.3	46.2	52.5	56.5
Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, në raport me vëllimin total të eksporteve (%)	7)	93.1	128.0	142.4	140.2	151.2	166.5
Oferta e parasë: M1 (kartëmonedha, monedhat, depozitat 1-ditore, (milion euro)		1113	2303	2154	1999	1973	2023
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri 2 vjet, milion euro)		2376	4520	4378	4387	4611	4816
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion euro)		3069	6643	6599	7114	7626	8080
Kreditimi total i institucioneve financiare monetare për banorët rezidentë (konsoliduar) (milion euro)		217	3227	3335	3506	3862	3990
Normat e interesit: norma ditore e parasë, për vit (%)		:	:	:	:	:	:
Normat e interesit të huadhënies (një vit), për vit (%)	8)	11.9	11.8	12.5	11.3	11.2	10.3
Normat e interesit të depozitave (një vit), për vit (%)	9)	7.8	6.9	6.8	6.4	5.9	5.4
Kursi i këmbimit të EUR: mesatarja e periudhës – 1 euro = ... lek		128.470	122.800	132.060	137.790	140.331	139.040
Indeksi efektiv i kursit të këmbimit (2000=100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e aktiveve rezervë (përfshi arin) (milion euro)		834	1694	1650	1905	1912	1972

<b>Tregtia e jashtme</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		1 486	3 790	3 259	3 328	3 867	3 797
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		340	684	780	1 169	1 400	1 531
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		-1 145	-3 106	-2 479	-2 160	-2 467	-2 267
Termet tregtarë (indeksi i çmimeve të eksportit/importit)		101.5	96.0	97.6	98.4	108.3	105.8
Përqindja e eksportit me BE-27 në vlerën e eksporteve totale (%)		91.2	75.8	79.2	70.2	72.7	75.4
Përqindja e importit nga BE-27 në vlerën e importeve totale (%)		80.3	63.0	64.3	64.9	64.0	61.9

<b>Demografia</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Norma e rritjes natyrale: ndryshimi natyral (lindjet minus vdekjet për 1000 banorë)		11.1e	4.3e	4.7e	4.9e	5.0e	5.1e
Norma e vdekshmërisë foshnjore: vdekjet e fëmijëve nën 1 vjeç për 1000 lindje të gjalla)		17.4e	11.1e	10.3e	9.6e	8.7e	8.8e
Jetëgjatësia e pritshme në lindje: meshkuj (vite)		:	73.0e	73.7e	74.6e	75.1e	75.3e
Jetëgjatësia e pritshme në lindje: femra (vite)		:	78.4e	78.7e	79.0e	79.7e	79.6e

<b>Tregu i Punës</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Norma e aktivitetit ekonomik (20-64): përqindja e popullsisë e moshës 20-64 që është ekonomikisht aktive (%)	10)	72.3	69.3e	69.6e	69.7e	75.6e	73.2e
Norma e punësimit (20-64): përqindja e popullsisë e moshës 20-64 e punësuar (%)	10)	55.5	60.8e	60.4e	60.3e	64.9e	63.4e
Norma e punësimit e meshkujve (20-64) (%)	10)	70.6	72.1e	73.2e	71.5e	84.0e	83.3e
Norma e punësimit e femrave (20-64) (%)	10)	40.6	51.0e	48.9e	49.8e	67.3e	63.3e
Norma e punësimit e punonjësve më të vjetër në moshë (55-64): përqindja e popullsisë 55-64 vjeç e punësuar (%)	10)	27.5	44.0e	48.9e	48.3e	54.7e	57.7e
Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%)							
Bujqësia	10) 11)	50.6	44.6e	44.1e	41.8e	45.4e	51.1e
Industria	11)	7.1	9.3e	10.0e	11.0e	10.6e	10.9e
Ndërtimi	11)	6.6	8.5e	9.9e	9.9e	8.2e	6.5e
Shërbimet	10) 11)	35.7	37.6e	36.0e	37.3e	35.8e	31.6e
Shkalla e papunësisë: përqindja e fuqisë punëtore e papunë (%)	10)	22.8	13.0e	13.8e	14.0e	13.9e	13.9e
Përqindja e fuqisë punëtore meshkuj të papunë (%)	10)	18.8	12.5e	12.2e	12.6e	13.8e	15.0e
Përqindja e fuqisë punëtore femra të papuna (%)	10)	28.4	13.5e	15.9e	15.9e	14.1e	12.5e
Shkalla e papunësisë e personave < 25 vjeç: përqindja e fuqisë punëtore <25 e papunë (%)	10)	35.5	27.2e	27.2e	30.5e	23.6e	27.9e
Shkalla e papunësisë afatgjatë: Përqindja e fuqisë punëtore e papunësuar për 12 muaj a më shumë (%)	10)	:	8.5e	9.1e	10.6e	10.2e	10.8e

<b>Kohezioni Social</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Pagat dhe rrogat mesatare mujore nominale (lek)		17 218.0	36 537.0	40 874.0	44 375.0	46 665.0	50 093.0
Indeksi i pagave reale (indeksi i pagave nominale pjesëtuar me IÇK/IHÇK) (2000=100)		11.6	91.7	109.8	116.1	123.5	138.2
Braktisja e hershme e shkollës - pjesa e popullatës e moshës 18-24 vjeç që maksimumi kanë arsim të mesëm të ulët (9-vjeçar) dhe që aktualisht nuk merr arsimim ose formim profesional (%)		:	39.0e	35.5e	31.9e	35.2e	31.6e

<b>Standardi i jetesës</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Numri i automjeteve për 1000 banorë		43.5e	83.3	88.2	104.4	106.3p	106.6
Numri i abonimeve në shërbimin celular për 1000 banorë		120.6e	1 013.0e	1 444.0e	1 584.4	1 841.8	:

<b>Infrastruktura</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksionim, për 1000 km <sup>2</sup> )		14,3	13,9	13,9	13,9	13,9	13,9
Gjatësia e rrugëve interurbane (mijëra km)		:	:	:	:	:	:

<b>Novacioni dhe kërkimi shkencor</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Shpenzimet për burime njerëzore (shpenzimet publike për arsimin, në raport me PBB-në (%))		3.3	3.5	3.4	3.5	3.3	:
* Shpenzimet e brendshme bruto për kërkim-zhvillimin, në raport me PBB-në (%))		:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë akses në internet në shtëpi (%)		:	3.4	:	:	:	:

<b>Mjedisi</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
* Totali i shkarkimeve të gazeve serë, CO <sub>2</sub> ekuivalent (ton, 1990=100)		:	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg ekuivalent naftë për 1000 euro PBB)		386.5	:	:	:	:	:
Energjia e rinovueshme si përqindje e konsumimit bruto të energjisë elektrike (%)		:	:	:	:	:	:
Transporti rrugor i mallrave si përqindje e transportit të brendshëm të mallrave (% ton-km)		:	:	:	:	:	:

<b>Energjia</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Prodhimi parësor i të gjitha produkteve energjetike (mijë ton naftë ekuivalent) (TOE)		933	1 159	1 263	1 643	1 494	1 676
Prodhimi parësor i naftës bruto (mijë ton naftë ekuivalent) (TOE)		335	578	577	744	895	1 031
Prodhimi parësor i antracitit dhe linjitit (mijë ton naftë ekuivalent) (TOE)		15	20	3	3	2	2
Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë ton naftë ekuivalent) (TOE)		8	8	8	13	15	15
Importet neto të të gjitha produkteve energjetike (mijë ton naftë ekuivalent) (TOE)		1 001	1 033	895	552	668	320
Konsumi i brendshëm bruto i energjisë (mijë ton naftë ekuivalent) (TOE)		1 934	2 119	2 104	2 106	2 162	2 014
Prodhimi i energjisë elektrike (mijë GËh)		3.7	3.9	5.2	7.7	4.1	4.3

<b>Bujqësia</b>	Shënim	2001	2008	2009	2010	2011	2012
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit, viti pararendës =100)		:	107.4	102.0	107.3	3.9	:
Sipërfaqja totale bujqësore e përdorur (mijëra hektarë)		1 139	1 121	1 138	1 201	1 201	1 201

Blegtori: gjedh (mijëra kokë, fundi i periudhës)		708	541	494	493	492	498
Blegtori: derra (mijëra kokë, fundi i periudhës)		106	161	160	164	163	159
Blegtori: të imta (mijëra kokë, fundi i periudhës)		2 933	2 620	2 540	2 581	2 517	2 619
Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në ferma (qumësht i paskremuar, mijëra ton)		984	1 040	1 045	1 070	1 101	1 105
Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshi orizin) (mijëra ton, prodhim i korrur)		503	608	630	662	701	:
Prodhimi i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijëra ton, prodhim i korrur)		39	:z	:z	:z	:z	:
Prodhimi i të mbjellave: perimet (mijëra ton, prodhim i korrur)	12)	677	715	730	860	890	:

: = nuk ka

-z = e paaplikueshme

e = vlera e llogaritur

p = provizore

\* = tregues "Europe 2020"

Për IHD-në janë përdorur konvencionet e bilancit të pagesave. Për IHD-në jashtë shtetit, shenja minus do të thotë se investimi i bërë jashtë shtetit nga ekonomia raportuese e tejkaloj investimin e larguar në këtë periudhë, kurse një shifër pa shenjë do të thotë se largimi i investimeve tejkaloj investimet. Për IHD-në në ekonominë raportuese, një shifër pa shenjë do të thotë që investimet në ekonominë mbi të cilën raportohet tejkalojnë investimin larguar, ndërsa një shenjë minus tregon që investimi i larguar tejkaloj investimet.

Fundshënime:

- 1) Shifrat e popullsisë bazohen në llogaritjen e parashikimeve retro që ka bërë INSTAT.
- 2) 2011, vlerësim vjetor, PBB me çmimet e tregut; 2012, bazuar në vlerësimet tremujore.
- 3) Vlerësimi i PBB për frymë bazohet në popullsinë mesatare vjetore llogaritur nga INSTAT (1402/Y1001-A).
- 4) 2012, bazuar në vlerësimet tremujore të GVA, me çmime bazë (2005=100).
- 5) Viti bazë është 2005; sipas Nace Rev 1.1
- 6) Të dhënat për GED nga 2003 janë shpërndarë nga Banka e Shqipërisë.
- 7) 2001, Disbursimi i Borxhit të Vonuar/pa paguar (DOD) rezervat kumulative përfshin borxhin publik të jashtëm dhe borxhin me garanci publike, por që nuk përfshin kreditë nga FMN-ja. Eksportet totale janë llogaritur sipas koncepteve të llogarive kombëtare.
- 8) 2001 - 2009, norma mesatare e ponderuar për huatë e reja 12-mujore në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 9) 2001 - 2009, norma e interesit të depozitave përfaqëson normën e ponderuar mesatare për depozitat e pranuar në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 10) 2001, bazuar në të dhënat e censusit 2001, 2008-2012 bazuar në të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore.
- 11) Të dhënat janë paraqitur sipas Nace Rev 1.1.
- 12) Përfshi shalqirin.

